



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Parku Kombëtar Sharri



Plani i menaxhimit

Strategjia 10-vjeçare e menaxhimit 2014-2023

Plani operativ 5-vjeçar 2014-2018

Prill 2014



Përgatitur me përkrahje nga *Projekti për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Përdorimit të Tokës dhe Ruajtjen e Biodiversitetit në Komunën e Dragashit*

Përmbajtja

Shkurtesat e shfrytëzuara në tekst.....	4
1 Hyrja	5
1.1 Sfondi dhe mirënjohjet	5
1.2 Përmbledhje.....	6
2 Konteksti.....	9
2.1 Baza ligjore.....	9
2.2 Plani hapësinor për parkun Kombëtar Sharri.....	12
2.3 Planet dhe strategjitë tjera me ndikim në Parkun kombëtar.....	12
3 Përshkrim i Parkut Kombëtar Sharri	14
3.1 Lokacioni, gjeografia dhe kufijtë	14
3.2 Gjeomorfologjia, gjeologjia dhe tokat	15
3.3 Klima	15
3.4 Hidrologjia.....	16
3.5 Natyra	16
3.6 Çështjet e ndërlidhura me tokat (pronësia, të drejtat).....	18
3.7 Palët me interes	19
3.8 Vendbanimet dhe popullata	20
3.9 Përdorimi i tokave dhe resurseve	21
3.10 Menaxhimi aktual i Parkut Kombëtar Sharri.....	26
4 Vlerësimi (Statusi aktual dhe gjendja e synuar)	28
4.1 Tiparet dhe vlerat natyrore (speciet, habitatet, ekosistemet, peizazhet)	28
4.2 Karakteristikat dhe vlerat e komunitetit dhe kulturore.....	33
4.3 Karakteristikat, vlerat dhe mundësitë turistike dhe rekreative	35
4.4 Vlerat dhe mundësitë ekonomike dhe zhvillimore.....	38
5 Analizë e çështjeve dhe problemeve.....	41
5.1 Rreziqet dhe presionet.....	41
5.2 Vlerësimi i aftësive të menaxhimit.....	47
6 Korniza strategjike (Vizioni, synimet dhe objektivat për dhjetë vite).....	49
6.1 Vizioni i përgjithshëm.....	49
6.2 Objektivat e përgjithshme të menaxhimit dhe gjendja e dëshiruar e veçorive të synuara	49
7 Zonimi (zonat, përshkrimi dhe kufizimet e përdorimit të pranueshëm)	57
7.1 Zonat e mbrojtjes strikte (zona mbrojtëse e nivelit të parë)	57
7.2 Zona e menaxhimit aktiv.....	58
7.3 Zona e përdorimit të qëndrueshëm.....	59
7.4 Zona e ndikimit (bufer)	60
8 Masat e menaxhimit.....	61

Programi 1 Biodiversiteti, mjedisi dhe peizazhi.....	62
Programi 2: Komunitetet, vlerat kulturore dhe përdorimi i qëndrueshëm.....	666
Programi 3. Turizmi dhe rekreacioni	69
Programi 4 Edukimi dhe vetëdijesimi	722
Programi 5 Qeverisja, administrimi, menaxhimi dhe financimi	744
9 Aranzhimet për zbatim	777
9.1 Stafi	777
9.2 Qeverisja	788
9.3 Pajisjet dhe infrastruktura	788
9.4 Monitorimi	799
9.5 Planifikimi dhe raportimi	811
10 Plani i biznesit.....	84
11 Hartat	84
11.1 Kufijtë.....	85
11.2 Gjeologjia dhe burimet minerale	86
11.3 Dheu	87
11.4 Veçoritë Hidrologjike	88
11.5 Vegjetacioni	89
11.6 Mbulesa e tokës.....	90
11.7 Përdorimi i tokës.....	91
11.8 Turizmi	92
11.9 Kullotjet.....	93
11.10 Zonat e rëndësishme për faunën	94

SHKURTESAT E SHFRYTËZUARA NË TEKST

Imd	Lartësi mbidetare
BAU	Veprimtari e rëndomtë
CR	Në rrezik kritik (kategoria e kërcënimit sipas IUCN)
DAQ	Departamenti i Administratës Qendrore
DP	Departamenti i Pylltarisë
VNM	Vlerësimi i ndikimit mjedisor
EN	I rrezikuar (kategoria e kërcënimit sipas IUCN)
BE	Bashkimi Evropian
FSSC	Lista vlerësuese e qëndrueshmërisë financiare
GIS	Sistemi i informatave gjeografike
GPS	Sistemi global i pozicionimit
ha	Hektar(ë)
HCVF	Pyll me vlerë të lartë të konservimit
IBA	Zonë e rëndësishme për shpezët
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Resurseve Natyrore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjensioni i Pyjeve të Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
km	kilometër
m	metër
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
METT	Vegla për Përcjelljen e Efektivitetit të Menaxhimit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
NTFP	Produktet pyjore që nuk shfrytëzohen si lëndë druri
ZM	Zonë e Mbrojtur
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
SDA	Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SEM	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Ekosistemit
PKSH	Parku Kombëtar Sharri
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
SWOT	Analiza e përparësive, mangësive, mundësive dhe rreziqeve
UNDP	Programi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi Mjedisor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VU	I cenueshëm (kategoria e kërcënimit sipas IUCN)

1.1 SFONDI DHE MIRËNJOHJET

Ky Plan i Menaxhimit është përgatitur gjatë vitit 2013, me përkrahje nga projekti i UNDP për "Menaxhim të Qëndrueshëm të Shfrytëzimit të Tokave dhe Konservim të Biodiversitetit në Komunë". Ky projekt ka mundësuar zgjerimin e Parkut Kombëtar të Malit të Sharrit për të përfshirë edhe komunën e Dragashit, dhe me qëllim të përkrahjes së këtij procesi, është arritur pajtimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) që të përgatitet një plan i menaxhimit për parkun e gjeruar kombëtar. Format i planit është bazuar (me disa ndryshime) në udhëzimet e përcaktuara në planin për menaxhimin e zonës së mbrojtur në vitin 2012 nga Projekti i Binjakëzimit të BE-së 'Përkrahje për menaxhimin e qëndrueshëm të pylltarisë', të zbatuar përmes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Lokal dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.¹

Plani është përpiluar në emër të UNDP dhe MMPH nga:

Michael R Appleton (konsulent ndërkombëtar),

Qazim Kukalaj (konsulent vendor) dhe

Nail Kryeziu (konsulent vendor).

Ai u përgatit përmes një procesi që ngërthente takime teknike, konsultime, debate publike dhe punëtori, të cilat u organizuan mes majit dhe nëntorit të vitit 2013.

Procesi i planifikimit u udhëhoq nga Grupi punues i themeluar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të përbërë nga anëtarët në vijim.

Hazer Dana, Drejtor i Drejtorisë së Pakut Kombëtar Sharri

Luan Nushi, Drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH)

Ismajl Hetemaj, Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje të Natyrës

Rizah Murseli, Hulumtues profesional (IPH)

Fadil Bajraktari, Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtje të Natyrës (IKMN)

Qenan Maxhuni, Zyrtar për biodiversitet në IKMN

Xhezair Selimi, Zyrtar për botë shtazore dhe gjueti në Parkun Kombëtar Sharri

Sami Behrami, Zyrtar në IKMN

Hazir Çadraku, Udhëheqës i Divizionit për Politika Ujore, dhe

Avdullah Berisha, Udhëheqës i Divizionit të Financave në Departamentin e Administratës Qendrore (DAQ)

Plani Afarist që përcjell këtë plan të menaxhimit është përpiluar nga Marlon Flores (konsulent ndërkombëtare) dhe Enis Selimi (konsulent vendor).

Në UNDP, përpilimi i planit të menaxhimit është mbikëqyrur nga dy menaxherët e projektit, Maria Elena Zuniga Barrientos dhe Halil Ibrahim, me përkrahje nga Ismail Gagica dhe znj. Rreze Duli. Përkrahje në fushën e GIS është ofruar nga Ergin Hajredini. Integrimi i planit të menaxhimit me zhvillimin e Atlasit për Zhvillim të Qëndrueshëm është koordinuar nga Peter Bank dhe Florian Bemmerlein-Lux. Përkrahja në përkthim u dha nga Avdullah Berisha dhe Bashkim Susuri.

Në MMPH, përpilimi i planit të menaxhimit është mbikëqyrur nga Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i AMMK.

MMPH i falenderon organizatat qeveritare dhe joqeveritare, ekspertet dhe individet që në çfarë do mënyrë kanë kontribuar në zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Sharri.

¹Projekti i Binjakëzimit i BE-së. Udhëzime për Planin e Menaxhimit të Parqeve Kombëtare të Kosovës. Projekti i Binjakëzimit i BE-së (KS09IBEN02). Përkrahje e mëtejme për menaxhim të qëndrueshëm të pylltarisë. Prishtinë.

1.2 PËRMBLEDHJE

Ky plan i menaxhimit ofron një kornizë strategjike të arsyetuar për menaxhimin afatgjatë të Parkut Kombëtar Sharri, si dhe një plan të detajuar të veprimit për menaxhimin e Parkut Kombëtar gjatë pesë viteve në vijim. Ai përbëhet nga kaptinat në vijim:

Pjesa 1 ofron të dhëna të përgjithshme dhe një përmbledhje.

Pjesa 2, 'Konteksti' përshkruan statusin aktual juridik dhe administrativ të Parkut Kombëtar.

Pjesa 3, 'Përshkrimi' ofron informata mbi aspektet mjedisore, ekologjike, kulturore dhe socioekonomike të Parkut Kombëtar

Pjesët 4 dhe 5, 'Vlerësimi' dhe 'Analiza e çështjeve' qartësojnë vlerat kryesore të Zonës së Mbrojtur dhe identifikojnë kërcënimet me të cilat ajo përballlet. Këto pjesë gjithashtu vejnë në spikamë disa nga çështjet kryesore që ndikojnë në menaxhimin, administrimin dhe financimin e Parkut Kombëtar. Ky vlerësim është përmbledhur në tabelën 1.

Tabela 1 Përmbledhje e kaptinës së vlerësimit

Vlerat dhe pasuritë	Kërcënimet dhe çështjet që duhet menaxhuar
<p>Vlerat natyrore: Parku Kombëtar i Malit të Sharrit përfshin një varg ekosistemesh në gjendje të mirë në substrakte të ndryshme, nga malet e larta deri tek kodrinat. Me to ndërlidhet një florë dhe faunë pothuajse e paprekur që përbëhet nga shumë specie të rralla dhe endemike.</p> <p>Vlerat kulturore: Parku Kombëtar i Sharrit ngërthen trashëgimi të rëndësishme kulturore sa u përket strukturave fizike, traditave, besimeve dhe njohurive.</p> <p>Vlerat turistike dhe rekreative: PKSHE ka potencial të konsiderueshëm për kënaqësi të publikut, turizëm formal dhe joformal dhe gjenerim të të hyrave për bizneset dhe popullatën lokale si dhe për autoritetet lokale dhe qendrore.</p> <p>Vlerat ekonomike dhe zhvillimore: Parku Kombëtar i Sharrit ofron një sërë shërbimesh të rëndësishme për ekonominë lokale dhe kombëtare. Këto shërbime përkrahin mijëra njerëz dhe vlejnë gjithsej mbi 170 milionë euro në vit. Me zhvillim dhe menaxhim më të mirë dhe më racional, vlera e këtyre shërbimeve mund të ruhet dhe të rritet dukshëm</p>	<p>Vlerësimi ka identifikuar kërcënimet në vijim si kërcënimet kryesore për vlerat e PKSHE:</p> <ul style="list-style-type: none">• Ndërtimi dhe ndryshimi i destinimit të tokave.• Zhvillimi i fermave për blegtori, kullosave, etj.• Gjuetia dhe gjuetia e egër.• Grumbullimi i bimëve dhe produkteve tjera të egra.• Prerja e druve dhe grumbullimi i druve.• Ndërhyrja dhe pengesat njerëzore.• Zjarret.• Pendat dhe menaxhimi i ujërave.• Speciet dhe llojet invazive dhe problematike.• Ndotja: kanalizimi dhe ujërat e zeza, mbeturinat e ngurta.• Erozioni dhe degradimi i tokave.• Ndryshimet klimatike dhe moti ekstrem.
Çështjet që ndërlidhen me menaxhimin dhe qeverisjen	
<p>Edhe pse drejtorja e parkut kombëtar punëson staf me përvojë, ajo ka mungesë të personelit dhe resurseve fizike të nevojshme për menaxhim efektiv të përgjithshëm. Mungesa e autoritetit të qartë mbi zonën e parkut dhe e një sistemi efektiv të qeverisjes kufizon aftësitë e Drejtorisë për të përmbushur funksionet e veta dhe për t'iu përgjigjur nevojave në mënyrë adekuate për të minimizuar kërcënimet në mënyrë adekuate. Nota e marrë aktualisht (35%) sipas Veglës Ndërkombëtar për Përcjelljen e Menaxhimit Efektiv është tepër e ulët.</p>	

Financat

Financimi i qëndrueshëm i PKSHE mbetet sfida kryesore për arritjen e caqeve lidhur me konservimin e tij në të ardhmen. Nga këndvështrimi historik, PKSHE ka qenë tejet i varur nga financimi qeveritar që ka qenë i kufizuar, dhe nuk ka gëzuar përkrahje nga fondet e trusteve apo projekteve ndërkombëtare. Sfidat kryesore për financim të qëndrueshëm të PKSHE janë kapaciteti i pamjaftueshëm në terren për të vlerësuar në mënyrë reale nevojat dhe boshllëqet e financimit, për të zhvilluar dhe zbatuar plane financiare kosto-eficiente dhe strategji për gjenerim të shumëllojshëm të të hyrave. Financimi aktual i PKSHE siguron atij rreth 35% të mjeteve të nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta themelore lidhur me menaxhimin.

Pjesa 6, 'Korniza strategjike' ofron një skicë të qasjeve të përgjithshme të nevojshme për të rikthyer baraspeshën ekologjike në lokacion, për të ruajtur vlerat e tij dhe për të adresuar kërcënimet, me pjesëmarrje dhe përkrahje të të gjitha grupeve të interesit.

Kjo pjesë përcakton për Parkun Kombëtar Sharri vizionin në vijim:

Parku Kombëtar Sharri

- Një Park i menaxhuar me kujdes për gjeneratat e ardhshme, një Park me diversitet biologjik, peizazhe speciale, jetesë dhe vendbanime tradicionale, që çmohen, mbrohen dhe zhvillohen.
- Një Park në të cilin përfitimet ekonomike u shërbejnë interesave të mbrojtjes së mjedisit dhe komuniteteve lokale.
- Një Park i qashtë, që u ofron vizitorëve të vet mundësi të argëtimit me aktivitete rekreative, sportive, kulturore dhe të hulumtimeve shkencore.

Më pas identifikohen pesë programe të menaxhimit, secili me qëllime që do t'i kontribuojnë arritjes së vizionit. Brenda planit, çdo program ndahet në objektiva të veçanta. Këto programe kyçe të menaxhimit dhe caqet e tyre të përgjithshme përmbledhen në tabelën 2.

Pjesa 7, 'Zonimi' ofron detaje mbi zonat funksionale të Parkut Kombëtar.

Pjesa 8, 'Masat e menaxhimit' përfshin plane të detajuara të veprimit që nevojiten për të realizuar të gjitha programet dhe nënprogramet për pesë vitet e para të zbatimit. Veprimet specifike janë të përshkruara dhe priorizuara, indikatorët e arritjes janë identifikuar dhe orari i zbatimit është përfshirë për të gjitha veprimet, duke përcaktuar edhe entitetet përgjegjëse për kryerjen e të gjitha veprimeve gjegjëse.

Pjesa 9: Marrëveshjet e implementimit përbëhet nga pesë kaptina:

- **Punësimi** identifikon nevojat për punonjësit që do ta zbatojnë planin e menaxhimit.
- **Qeverisja** përshkruan kornizën kryesore të nevojshme për operacionalizimin e administrimit të parkut kombëtar të zgjeruar.
- **Pajisjet e infrastruktura** skicojnë investimet e nevojshme në kuptim të burimeve materiale.
- **Monitorimi** ofron informata mbi programin kryesor të monitorimit të zonave të mbrojtura.
- **Planifikimi dhe raportimi** definojnë strukturat e planeve vjetore të punës dhe raporteve të ndërlidhura me planin e menaxhimit.

Pjesa 10. Për zbatimin e planit të menaxhimit është përgatitur një **Plan i veçantë i Biznesit**.

Pjesa 11. Ngërthen **Hartat** të cilave u referohet në tekst.

Shtojcat

Shtojcat me informatat themelore të publikuara ndaras.

Tabela 2 Përmbledhje e programeve dhe nënprogrameve të menaxhimit

Programi 1 Biodiversiteti, mjedisi dhe peizazhi	Programi 2 Komunitetet, kultura dhe përdorimi i qëndrueshëm	Programi 3 Turizmi dhe rekreacioni	Programi 4 Informimi, edukimi dhe vetëdijesimi	Programi 5 Qeverisja, menaxhimi, administrata dhe financat
CAQET				
Të ruhet një peizazh i ekosistemeve të ndërlidhura brenda dhe përtej Parkut Kombëtar Sharri dhe për të siguruar konservim të specieve që jetojnë në këto ekosisteme	Të mirëmbahen vlerat kulturore të parkut kombëtar, si pjesë e trashëgimisë kombëtare të Kosovës dhe si mundësi për ndërtimin e krenarisë së komunitetit dhe për shtimin e turizmit dhe rekreacionit.	Të zhvillohen një sërë mundësish për argëtim publik në Parkun Kombëtar Sharri që ruan vlerat e veta natyrore dhe kulturore dhe siguron përkrahje për menaxhimin e vet	Të shtohet vetëdija, të kuptuarit dhe përkrahja në të gjitha nivelet për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar Sharri.	Të themelohet një sistem qeverisës dhe administrativ efektiv, me pjesëmarrje dhe resurse adekuata, për Parkun Kombëtar Sharri.
OBJEKTIVAT SPECIFIKE				
<p>1.1 Të sigurohet mbrojtja e specieve dhe ekosistemeve kryesore.</p> <p>1.2 Të sigurohet qasja në ekosistemet, florën dhe faunën kyçe dhe monitorimi i tyre.</p> <p>1.3 Të sigurohet se të gjitha zhvillohet në PKSH kalojnë nëpër kontroll mjedisor.</p> <p>1.4 Të mbrohen dhe ruhen burimet e ujit në PKSH.</p> <p>1.5 Të krijohet një sistem për menaxhim të mbeturinave të ngurta në PKSH.</p> <p>1.6 Të krijohet një sistem efektiv i parandalimit, kontrollit dhe menaxhimit të zjarrit në tërë PKSH.</p>	<p>2.1 Të ruhen vlerat kulturore të PKSH.</p> <p>2.2 Të ruhen kullosat e rregulluara në zona të caktuara të PKSH.</p> <p>2.3. Të rregullohet korrja e boronicave dhe bimëve mjekësore.</p> <p>2.4 Të sigurohet furnizimi i qëndrueshëm me dru për djegie për komunitetet lokale.</p> <p>2.5 Të inkurajohen ndërmarrje të qëndrueshme të përkrahin PKSH dhe tu sjellin përfitime akterëve lokalë.</p>	<p>3.1 Të krijohet infrastruktura themelore për vizita dhe aktivitete në natyrë në PKSH.</p> <p>3.2 Të zhvillohet një gamë e shërbimeve për vizitues dhe të ofrohen mundësi të turizmit të qëndrueshëm në PKSH.</p> <p>3.3 Të ofrohen përvoja të sigurta, cilësore dhe të kujdesshme për mjedisin për vizituesit.</p> <p>3.4 T'i bëhet marketing PKSH-së si destinacion i turizmit dhe rekreacionit në natyrë.</p>	<p>4.1 Të sajohen materiale vetëdijësuese për PKSH.</p> <p>4.2 Të ngritet vetëdija në komunitet, të kuptuarit dhe përkrahja për PKSH.</p> <p>4.3 Të shtohet të kuptuarit dhe të mobilizohet përkrahja e nivelit të lartë për investime në konservim dhe menaxhim të qëndrueshëm të PKSH-së.</p>	<p>5.1 Të fillohet me menaxhim bashkëpunues në PKSH.</p> <p>5.2 Të krijohet një bazë kadrovike e përhershme, e trajnuar dhe profesionale, e përkrahur nga partnerët dhe vullnetarët në zbatimin e planit të menaxhimit.</p> <p>5.3 Të sigurohen resurset fizike të nevojshme për menaxhimin e PKSH dhe zbatimin e planit të menaxhimit.</p> <p>5.4 Të krijohen mekanizma për financim dhe menaxhim të qëndrueshëm e transparent të financave për implementimin e planit të menaxhimit.</p> <p>5.5 Të sigurohet implementimi, monitorimi dhe adaptimi i planit të menaxhimit.</p>

2.1 BAZA LIGJORE

2.1.1 THEMELIMI I PARKUT KOMBËTAR MALET E SHARRIT

Në vijim janë ligjet kryesore për themelimin e Parkut Kombëtar Sharri:

- **Ligji për mbrojtjen e natyrës, Nr. 03/L-233, i datës 09 nëntor 2010**

I cili ofron kornizën ligjore themelore për zonat natyrore të mbrojtura në Kosovë.

- **Ligji për Parkun Kombëtar Sharri, Nr. 04/L- 087, i datës 13 dhjetor 2012**

Sipas nenit 1 të këtij Ligji: *‘Pjesa e territorit të maleve të Sharrit si tërësi hapësinore që veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me pyje të ruajtura, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe me vlera shkencore, kulturore, historike, peizazhore, sportive, rekreative – turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kriterëve mjedisore , shpallet park kombëtar me emërtim: Parku Kombëtar “Sharri”.*

- **Vendimi ministror për themelimin e Parkut Kombëtar "Sharri", Nr. 03/2013, i datës 11/02/2013.**

2.1.2 KUFIJTË DHE ZONAT

Neni 2 i Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri (2012) përcakton kufijtë e Parkut Kombëtar Sharri (shih shtojcat e këtij dokumenti).

Neni 3 i Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri (2012) specifikon kushtet për zonat vijuese funksionale të Parkut.

Zona e mbrojtjes strikte: përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes së rreptë;

Zona e menaxhimit aktiv: përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes;

Zona e shfrytëzimit të qëndrueshëm: përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Shari” ku mund të bëhet: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Parkut Kombëtar si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar.

Zona e ndikimit: përfshin hapësirën prej pesëdhjetë (50)metra nga kufiri i Parkut Kombëtar “Sharri” që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në Park.

Plani Hapësinor i përkufizon këto zona funksionale dhe i përshkruan ato në mënyrë të detajuar (shih Shtojcat e këtij dokumenti)

2.1.3 RREGULLIMI I PARQEVE KOMBËTARE

Rregullorja e MMPH Nr. 21/2013 për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare përshkruan mbrojtjen, avancimin, promovimin dhe shfrytëzimin e parqeve kombëtare dhe i përkufizon masat për papajtueshmëri me dispozitat e saj. Teksti i kësaj rregulloreje është përfshirë në shtojcat e këtij dokumenti.

2.1.4 FUNKSIONET E PKSH SIPAS LIGJEVE EKZISTUESE

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010), Park Kombëtar është territori natyror me funksionet në vijim:

- a) mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- b) përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
- c) sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit.

Neni 1 i Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri (2012) përkufizon parkun kombëtar si pjesa e territorit të maleve të Sharrit si tërësi hapësinore që veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me pyje të ruajtura, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe me vlera shkencore, kulturore, historike, peizazhore, sportive, rekreative – turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kriterëve mjedisore.’

Në bazë të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri, funksionet kryesore të parkut janë përkufizuar si në vijim:

- a) Mbrojtja, ruajtja, ripërtëritja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i natyrës dhe burimeve natyrore të ripërtëritshme;
- b) Rivitalizimi i territoreve natyrore të dëmtuara apo pjesëve të tyre, dhe kompensimi për përgjegjësi të tilla;
- c) Ruajtja dhe rikthimi i balancave ekologjike të natyrës;
- d) Themelimi i një sistemi të planifikimit, menaxhimit, inventarit, informatave dhe financimit të mbrojtjes së natyrës;
- e) Implementimi i detyrave të përkufizuara me politikat e mbrojtjes së natyrës;
- f) Zvogëlimi i përdorimit të parregullt dhe rrezikimit të specieve të florës dhe faunës, në veçanti të specieve të rëndësishme të rralla dhe të rrezikuara dhe habitateve të tyre;
- g) Përcaktimi i të drejtës për informim dhe pjesëmarrje të publikut në mbrojtjen e natyrës;
- h) Përcaktimi i të drejtës së qytetarëve për një mjedis të sigurt dhe rekreacion në natyrë;
- i) Ruajtja e biodiversitetit, duke i ruajtur habitatet e rëndësishme natyrore dhe speciet e rëndësishme të florës dhe faunës në kuptim të regjimeve të mbrojtjes.

2.1.5 ADMINISTRIMI I PARKUT KOMBËTAR SHARRI

Neni 77 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010), përcakton se:

1. Me zonat e mbrojtura administrojnë drejtoritë.
2. Drejtoritë për administrimin me parkun kombëtar, parkun e natyrës, monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë me vendim i themelon Ministria.
3. Drejtoritë për administrimin me zonat tjera të mbrojtura ose vlerat tjera të mbrojtura të natyrës i themelojnë kuvendet e komunave me pëlqim të Ministrisë.
4. Zonat e mbrojtura të shpallura nga Qeveria, që shtrihen në territorin e parkut kombëtar ose parkun e natyrës, kufizohen me to ose gjenden drejtpërdrejt afër kufirit të tyre i administron drejtorja e cila administron me parkun kombëtar ose parkun e natyrës.

Neni 78 i po të njëjtit ligj rregullon:

1. Drejtoritë nga neni 77 i këtij ligji kryejnë veprimtarinë e mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe përparimit të zonës së mbrojtur me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes të natyrës burimore, sigurimit e papenguar të proceseve natyrore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të mirave të natyrës si dhe mbikëqyrin zbatimin e kushteve dhe masave të mbrojtjes të natyrës në zonën të cilin e administrojnë.
2. Drejtoritë të cilat administrojnë me parqet e natyrës mbikëqyrin edhe mënyrën e kryerjes së veprimtarive të lejuara ekonomike me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të mirave të natyrës.
3. Drejtorja mundet të kryejë edhe veprimtari të tjera të përcaktuara me aktin për themelim kur ato shërbejnë për kryerjen e veprimtarive nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni.

Sipas nenit 4 të Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri (2012):

“Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me vendim themelon Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” në afat prej tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

2.1.6. FINANCIMI I PARKUT KOMBËTAR SHARRI

Neni 79 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010) i përcakton burimet e financimit të Drejtorisë së PK “Sharri”:

1. Mjetet për punë të drejtorisë dhe kryerjen e veprimtarive nga neni 78 të këtij ligji sigurohen nga:
 - 1.1. buxheti i Republikës së Kosovës ose buxheti i komunës;
 - 1.2. të hyrat nga shfrytëzimi i vlerave të mbrojtura të natyrës;
 - 1.3. të hyrat nga kompensimi;
 - 1.4. të hyrat tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat e veçanta.

2.1.7. MBIKËQYRJA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR “SHARRI”

Neni 80 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010) e përcakton mbikëqyrjen e administrimit të PKSË:

1. *Mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës dhe akteve nënligjore të drejtorisë që administrojnë me zonat e mbrojtura të cilat i themelon Kuvendi ose Qeveria e Republikës së Kosovës e kryen Ministria.*
2. *Mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës dhe akteve nënligjore të drejtorive të cilat administrojnë me zonat e mbrojtura të cilat i themelojnë komunat e kryejnë organet kompetente të komunës.*
3. *Mbikëqyrjen e punës profesionale të drejtorive nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni e kryen Ministria.*

2.1.8 MENAXHIMI I KUSHTEVE TË PLANIFIKIMIT

Neni 81 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010) parasheh nevojën për një plan të menaxhimit, duke përcaktuar:

1. *Menaxhimi me rezervatin strikt, parkun kombëtar, parkun e natyrës, zonën e veçantë, peizazhin e mbrojtur kryhet në bazë të planit të menaxhimit.*
2. *Plani i menaxhimit nxirret në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vjetësh.*
3. *Plani i menaxhimit përcakton kahet e zhvillimit, mënyrën e kryerjes të mbrojtjes, shfrytëzimit dhe menaxhimit me zonën e mbrojtur, dhe kahet më të përafërta për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës në zonën e mbrojtur duke pas në konsideratë nevojat e komunitetit lokal.*
4. *Personat juridik dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtarinë e mbrojtjes të zonës së mbrojtur janë të detyruar t'i përmbahen planit të menaxhimit.*
5. *Pas kalimit të periudhës prej pesë (5) vjetësh, bëhet analiza e zbatimit të planit të menaxhimit dhe rezultatet e arritura dhe sipas nevojës bëhet revidimi i planit të menaxhimit sipas mënyrës dhe procedurës të përcaktuara për nxjerrjen e tij.*

Neni 82 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010) përkufizon komponentët kryesorë të planit për menaxhimin e zonës së mbrojtur, zbatimin e planit dhe shikimin publik:

1. *Plani i menaxhimit i zonës së mbrojtur nga neni 81 paragrafi 1. i këtij ligji përmban:*
2. *Plani i menaxhimit zbatohet sipas programit vjetor të mbrojtjes, ruajtjes, shfrytëzimit dhe përparimit të zonës së mbrojtur.*
3. *Propozimin e planit të menaxhimit, drejtorja është e detyruar ta japë në shikim publik në pajtim me nenin 151 të këtij ligji.*

2.1.9 MENAXHIMI I EKOSISTEMEVE PYJORE TË PARKUT KOMBËTAR “SHARRI”

Neni 47 (paragrafet 4 dhe 5) i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010) e përcakton menaxhimin (mbrojtjen dhe zhvillimin) e ekosistemeve pyjore të PKSË:

4. *Për zonat e mbrojtura në të cilat nuk lejohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës, në bazë të përcjelljes së gjendjes, nxirret programi i mbrojtjes të ekosistemeve pyjore i cili përmban masat e mbrojtjes dhe përparimit të tyre.*
5. *Programin e mbrojtjes së ekosistemeve pyjore nga paragrafi 4. i këtij neni e harton dhe zbaton Drejtorja e cila administrojnë me zonën e mbrojtur, dhe nxirret në pajtim me dispozitat e veçanta për rregullimin e pyjeve, me pëlqimin e Ministrisë.*

Menaxhimi i pyjeve të PKSË definohet edhe me nenet 13 dhe 14 të Rregullores së MMPH Nr. 21/2013 për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare:

Neni 13.

Prerjet sanitare dhe punët tjera pyjore kryhen në kohën e përcaktuar me Planin Menaxhues dhe Planin vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve.

Neni 14.

Në bazë të Planit Menaxhues të Parkut Kombëtar, drejtorja e parkut është e detyruar që çdo vit në muajin mars të përgatis dhe dorëzojë për aprovim Planin Vjetor detal lidhur me aktivitetet e parapara me këtë Rregullore.

2.1.10 KONTRIBUTI NGA SUBJEKTET E NDRYSHME NË PARKUN KOMBËTAR

Menaxhimi i Parkut Kombëtar është përgjegjësi e Drejtorisë së themeluar nga MMPH. Kjo Drejtori për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të vlerave natyrore, kulturore dhe turistike të Parkut Kombëtar mund të konsultohet me subjekte të ndryshme përkatëse qeveritare dhe joqeveritare.

2.1.11 AKTET TJERA RELEVANTE LIGJORE

Ligjet tjera që ndërlidhen me administrimin, menaxhimin dhe monitorimin e menaxhimit të resurseve natyrore dhe artificiale brenda parkut janë si në vijim:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Nr. 03/L-025, 26 shkurt 2009;
- Ligji Nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, 3 korrik 2003;
- Ligji Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor, 25 nëntor 2011;
- Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit mjedisor, 29 tetor 2010;
- Ligji Nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura, 20 shkurt 2008;
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri, Nr. 04/L-012, 10 gusht 2011;
- Kodi penal i Republikës së Kosovës nr. 04/l-082

2.2 PLANI HAPËSINOR PËR PARKUN KOMBËTAR SHARRI

Neni 12 i Ligjit Nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor, kërkon përgatitjen e Planeve Hapësinore për të gjitha 'zonat e veçanta' përfshirë parqet kombëtare. Draft-plani hapësinor për Parkun Kombëtar Sharri është përgatitur në vitin 2013 dhe pas nënshkrimit të Ministrit iu nënshtrua një procesi të konsultimeve dymujore para se t'i dorëzohej Qeverisë për miratim paraprak e më pas Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar.

Draft Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar Sharri përkufizon qëllimet dhe funksionet e planit hapësinor si në vijim:

Hartimi i Planit duhet të shërbejë si udhëzues:

- për të identifikuar lokacionet me potenciale të zhvillimit hapësinor të parkut;
- për të aprovuar politikat lidhur me vendosjen e zhvillimeve të mundshme në territorin e parkut që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve të nevojshme gjithnjë duke ruajtur në maksimum trashëgiminë dhe vlerat natyrore dhe kulturore;
- për të identifikuar rolin e vendbanimeve (fshatrave) përreth, si dhe rolin e qyteteve të mëdha që ndodhën në afërsi të parkut, si dhe
- për të identifikuar rolin e infrastrukturës së rëndësishme dhe të lidhjeve me territorin e Parkut

Plani hapësinor i Parkut Kombëtar "Mali Sharr" është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Me vendimet të cilat do të miratohen, plani hapësinor duhet të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e Qeverisë në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për shfrytëzimin sa më të drejtë të kësaj pasurie natyrore;
- Përcaktojë kategorizimin e hapësirave të cilat: do të nënshtrohen mbrojtjes nga çdo zhvillim, lokacionet me shkallë të caktuar të zhvillimit, lokacionet për zhvillim si dhe lokacionet me regjim të caktuar të shfrytëzimit;

2.3 PLANET DHE STRATEGJITË TJERA QË NDËRLIDHËN ME PARKUN KOMBËTAR

2.2.1. PLANET DHE STRATEGJITË ZHVILLIMORE TË KOMUNAVE

Komunat territoret e së cilave bien nën Parkun Kombëtar kanë strategjitë e tyre për zhvillim ekonomik, si dhe plane tjera të ndryshme për territorin jashtë Parkut Kombëtar, përfshirë planet e përgatitura nën projektin e përkrahjes së UNDP-së për Dragashin. Këto strategji dhe plane janë listuar në shtojcat e këtij dokumenti.

2.2.2. PËRCAKTIMET NDËRKOMBËTARE ME NDIKIM NË PARKUN KOMBËTAR

Një pjesë e territorit të Parkut Kombëtar Sharri është Zonë e Rëndësishme për Zogj YU024 (Mali i Sharrit).

Në Parkun Kombëtar Sharri zbatohet legjislacioni mjedisor ndërkombëtar, në veçanti:


- Direktiva Europiane për llojet e rrezikuara EC/2724/2000
- Direktiva Europiane për ruajtjen e habitateve natyrore të faunës dhe florës së egër 92/43/EEC;
- Direktiva Europiane për ruajtjen e zogjve të egër 79/409/EEC, 2009/147/EC;
- Direktiva SEA 2001/42/EC;
- Rrjeti Ekologjik Evropian Natura 2000.

3. PËRSHKRIM I PARKUT KOMBËTAR SHARRI

3.1. LOKACIONI, GJEOGRAFIA DHE KUFIJTË

Parku Kombëtar Sharri ndodhet në juglindje, jug dhe jugperëndim të Kosovës (harta 1). Ligji për Parkun Kombëtar Sharri (2012) përkufizon për këtë qëllim një zonë prej 53,469 hektarësh që bie në territorin e pesë komunave: Kaçanik, Shtërpcë, Suharekë, Prizren dhe Dragash (harta 3). Përshkrimi i plotë i kufijve mund të gjendet në shtojcat e këtij dokumenti.

Harta 1 Lokacioni i Parkut Kombëtar Sharri në Kosovë



KALIMET KUFITARE

Aktualisht, ekziston një kalim kufitar mes Shqipërisë dhe Kosovës që ndodhet në veri të maleve të Sharrit dhe Koritnikut, në luginën e lumit Drini i Bardhë, pranë fshatit të Vërmicës, e që është rruga kryesore që lidhë qytetet e Kukësit dhe Prizrenit që ofron komunikim të rregullt me autobus publik.

Ekzistojnë dy pika të kalimit kufitar mes Kosovës dhe Maqedonisë, një në luginën e lumit Lepenc, që ndan malet e Sharrit nga vargmali i Karadakut, që përbën një korridor të transportit ndërkombëtar (E65) që lidhë Prishtinën me Shkupin dhe ka qarkullim të theksuar. Tjetri ndodhet në rrëpirat më lindore të maleve të Sharrit (Jazhincë) në afërsi të Gllloboçicës, në një rrugë të asfaltuar lokale malore që lidhë Kosovën me Tetovën në Maqedoni, e në të cilën trafiku nuk është edhe aq i shpeshtë.

Një tjetër kalim kufitar (i mbyllur që nga viti 2001) ndodhet në Lukovo Pole, mes vargmaleve të Sharrit dhe Korabit, në një rrugë të paasfaltuar që lidhë regjionin e Gorna Rekës në Maqedoni, përmes kalimit malor (rreth 1500m lartësi mbidetare) me fshatin e Restelicës në komunitetin e Dragashit.

Gjatë vitëve të fundit është hapur kalimi kufitar në afërsi të fshatit Krushevë të komunës së Dragashit mes Kosovës dhe Shqipërisë.

3.2. GJEOMORFOLOGJIA, GJELOGJIA DHE TOKAT²

3.2.1. GJELOGJIA

Gjeologjia e maleve të Sharrit përbëhet nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve, me struktura dhe mosha të ndryshme. Formacioni më i përhapur është ai i paleozoikut; të pranishëm janë edhe shkëmbinj të mermerit dhe serpentinës, si dhe formacionet e diabazës. Formacionet më të reja ngërthejnë sedimente të liqeneve të neocenit dhe zonat aluviale. Formacionet paleozoike dallojnë malet e Sharrit nga zonat tjera malore të Kosovës. Këto formacione, që përbëhen nga guriçkat dhe shistat, shtrihen në një shirit të ngushtë nga Bistra (2640m), duke vazhduar kësaj përgjatë kufirit Kosovë-Maqedoni. Formacionet mesozoike, kretanet dhe dolomitët në zonën e Shtërpcës shfaqen në lindje të majës së Lubotenit. Në afërsi të Brezovicës janë akumuluar materiale morene nga proceset glaciale, që përbëhen nga shkëmbinj të magmatik, shkëmbinj të metamorfik, gurët rërorë, kuarçitet dhe gurët gëlqerorë (Harta 4).

3.2.2. GJEOMORFOLOGJIA

Formacionet e tokës në Parkun Kombëtar parimisht janë rezultat i lëvizjeve tektonike, të cilat kanë krijuar ansamblet kryesore gjeomorfologjike, të cilat më pas janë ndikuar nga faktorë të jashtëm si akullnajat, rrjedhat e ujit, etj. Pjesët më të larta të maleve, në veçanti në anën jugore, përfshijnë një numër të madh të zbrazëtirave apo baseneve glaciale, valëve dhe masave të mëdha të morenave (materialeve të akullnajave). Ato shfaqen në Bistra, Livadica, Cuka e Liqeneve dhe janë më të dukshmet në majën e Piribregut (2,522m), e cila gjithashtu njihet si Vrima e Berevcit. Më tej, zgavrat qarkore vërehen edhe tek Çuka a Liqeneve dhe Livadica. Formacioni më i shquar valor është Demir Kapija, që fillon nga zgavra glaciale që sot përbën Liqenin e Livadicës. Vala ka një dysheme të gjerë, anë të rrëpirëta dhe përbën mbetjen më të shquar fosilore të ultësirave të Sharrit, me gjatësi prej rreth 1.5km. Ndikimi më i madh në të ka qenë ai i ujit; e tërë zona e Sharrit përshkohet nga shumë luginat lumenjsh dhe përroskash, të cilat kryesisht derdhen në lumenjtë Lumbardh dhe Lepenc.

Në zonat jugore të Parkut Kombëtar, në fakt në rrjedhën e sipërme të luginave të lumenjve Muzhica, Bollonjska, Bllateshtica, Suva, etj. luginat janë të ngushta, të thella dhe të rrëpirëta, që formojnë kanjone dhe ngushtica. Këto tipare janë të pranishme në të gjitha luginat që ndodhen në lartësi mbidetare mes 1200 dhe 1400m.

3.2.3. TOKA

Toka në Parkun Kombëtar mund të klasifikohet në katër grupe kryesore:

- Toka me fertilitet të lartë në rrafshet aluviale të luginave të ulëta të lumenjve (tokat fluviale, tokat aluviale-diluviale). Disa prej këtyre tokave nuk janë të përshtatshme për prodhimtari intensive bujqësore (*humo-gley, hypo-gley*).
- Tarracat lumore glaciale janë zhvilluar në disa nivele dhe kanë vlera bujqësore. Ato përfshijnë stagnosol dhe luvisol në tarracat më të ulëta dhe *cambisols* në tarracat më të larta.
- Malet në lartësi mbidetare mes 800 dhe 1800 m kanë llojllojshmërinë më të madhe të tokave. Këtu paraqiten tokat brunete-podzolike, rendzina dhe tokat gelqerore.
- Tokat litomorfike në lartësi më të mëdha (*litosol dhe sirozem*).

Shih hartën 5.

3.3. KLIMA

Sipas klasifikimit klimatik të Kosovës, Parku Kombëtar Sharri dominohet nga një klimë alpine dhe kontinentale, ndonjëherë e ndikuar edhe nga klima kontinentale mediane. Brenda zonës së Parkut Kombëtar, ekziston vetëm një stacion meteorologjik (i pranishëm që nga 1949), i vendosur në Brezovicë, në 860m lmd. Stacioni më i afërt i radhës ai në Jazhincë (950m lmd) në Republikën e Maqedonisë, që posedon të dhënat meteorologjike në periudhën 1949 - 1991. Nga analiza e bazës së të dhënave të stacionit meteorologjik të IHMK-së, temperatura mesatare shumëvjeçare në këto dy

²Burimi: Plani Zhvillimor i Komunës, Shtërpcë

stacione (pika të matjes) është 8.4°C. Muaji më i ftohtë është janari me 1.8 dhe -1.3 gradë celsius, ndërsa vlerat më ekstreme të matura në këto dy lokacione janë në vitin 1963, kur temperaturat shënonin -33 dhe -34°C, ndërsa temperatura mesatare ditore lëvizë mes 18–20°C. Lagështia relative e ajrit është rreth 67-70% për të dy stacionet. Erërat fryjnë me shpejtësi prej 1-16m/s, ndërsa dominojnë ato jugu, jugperëndimi dhe juglindja. Norma e të reshurave, e shprehur në vlera mesatare, është mes 670 dhe 1200 mm. Shkurti dhe marsi shpesh mund të regjistrojnë ortekë. Çdo vit ka mes 220 dhe 280 ditë me diell.

Numri i ulët i stacioneve të matjes mbi 1000m lmd rezulton me shifra jo të sakta për reshjet në zonat malore në anën lindore. Nivelet e borës në rajon kanë arritur deri në 3 metra në vitin 1956. Numri më i madh i ditëve me borë, dhe nivelet më të larta të borës, janë shënuar në vitin 1981, kur në Jazhincë kishte 117 ditë me borë, ndërsa në Shtërpçë 108 sish.

3.4. HIDROLOGJIA

Parku Kombëtar Sharri karakterizohet me sasi të mëdha të të reshurave. lumenjtë dhe përroskat, ujëvarat dhe rrjedhat malore presin territorin në të gjitha drejtimet. Mali i Sharrit gjithashtu karakterizohet me disa liqene glaciale. Pothuajse tërë territori i Parkut Kombëtar ndërlidhet me dy lumenjtë më të mëdhenj: Lepencin dhe Lumbardhin. Lepenci është më atraktiv dhe kalon nëpër pjesët më pitoreske dhe përkrah shumë shtigjeve të skijimit të Malit të Sharrit. Lepenci buron në liqenet Cereva dhe Jezerci. Ai rrjedh përmes Parkut Kombëtar dhe në të derdhen disa rrjedha tjera. Rrjedhat nga ana e djathtë janë më të rëndësishme, për shembull Lumi i Thatë, Murzhica dhe degët e tyre, Përroska e Dulës, Bllateshtica, Bolonjska dhe Kalugjerica. Këta lumenj kullojnë malet më të larta në pjesën më jugore të Parkut Kombëtar dhe kanë rrjedha të shpejta me një sërë ujëvarash dhe rrjedhash. Ndërsa Lepenci zë pjesën më të madhe verilindore të Parkut Kombëtar, Lumbardhi i Prizrenit mbulon pjesën jugperëndimore të Parkut. Pjesë e rëndësishme e këtij shtrati lumor janë rrjedhat kontribuese të tij nga ana e majtë, që rrjedhin nga malet e larta të Majës së Zezë, Kobilicat dhe Karanikolës. Këto rrjedha të sipërme të ujit janë të shpejta dhe joshëse. Dega e Përroskës së Lubimit është veçanërisht e rëndësishme në këtë drejtim. Shih hartën 6.

3.5. NATYRA

3.5.1. VEGJETACIONI

Harta 7 paraqet llojet e përgjithshme të vegjetacionit në Parkun Kombëtar Sharri. Harta 8 paraqet mbulesën e përgjithshme të tokës në Park.

ASOCIACIONET KRYESORE PYJORE

Në përgjithësi, asociacionet pyjore të parkut përcaktohen nga zonat e lartësisë.

Lartësia më e ulët. Në kodrina dhe në zonën pyjore të komunës së Kaçanikut, pjesë të masivit të gurëve gëlqerorë, paraqitet ndikimi i klimës mesdhetare. Asociacionet kryesore të bimëve janë pyjet e ulëta termofile gjetherënëse, shkurret dhe therrat, pyjet e shkozës, lajthisë, panjës, murrizave, dardhave të egra, trëndafilave të egër, lisave, etj.

Lartësi e ulët. Llojet dominuese të pyjeve në lartësi të ulëta janë asociacionet e lisave, kryesisht *Quercus pubescens*, *Quercus cerris* dhe *Quercus frainetto*.

Lartësi e ulët deri në të mesme. Në lartësi paksa më të mëdha, në zonat e lagështa apo në anët veriore të luginave, asociacionet pyjore termofile zëvendësohen me pyje të *Quercus petraea* dhe me specie tjera të druve dhe shkurreve.

Lartësia e mesme deri në të lartë (subalpine). Në lartësi më të larta, asociacionet e *Quercus petraea* fillojnë të zëvendësohen me pyje të ahut, të cilat janë të shtrira në lartësi mes 700 dhe 1,800m lmd. Përveç ahut, specie tjera janë edhe shkoza e bardhë, lisi, panja, bliri i argjendtë, bliri i rëndomtë, dëllinja, panja dhe elmi. Përmbi asociacionet e pyjeve ahore fillojnë asociacionet e pyjeve të përziera të ahut dhe fierit, me disa lloje tjera individuale si: elmi, bredhi, panja dhe panja pyjore. Niveli më i lartë i pyjeve të ahut në Malin e Sharrit përfshin një sërë komunitetesh të përziera gjetherënëse dhe gjethembajtëse, në të cilat gjenden ahu, panja, *Pinus heldreichii*, *Pinus peuce*, *Picea abies*, *Abies alba*.

Lartësi të mëdha (alpine). Mbi shiritin natyror të asociacioneve të pyjeve të ahut në toka silikoze, ekziston një shirit gjethembajtës që dominohet nga pyje të *Pinus heldreichii* dhe *Pinus peuce*. Zona transitorie mes këtij shiriti të sipërm të shkurreve të larta pyjore dhe vegjetacionit barishtor është e mbulua me asociacione të *Pinus mugho*.

Mbulesa e vegjetacionit është mirë e zhvilluar në zonat me gur gëlqeror dhe zonat serpentine, por edhe në vargmalin kryesor, në veçanti në toka të rralla të gurit gëlqeror, në lartësi mes 1,800 dhe 2,200m lmd. Shiriti i vegjetacionit të shkurreve alpine që ndodhen në shiritin e sipërm të pyllit përbëhet nga shumë asociacione të shkurreve me specie siç janë dëllinja siberike, boronica, thana, trëndafili i egër dhe brukentalia e pyllit.

Mbulesa e Parkut me llojet kryesore të pyjeve është paraqitur në tabelën 3.

Tabela 3 Shpërndarja e llojeve të pyjeve në Parkun Kombëtar Sharri

Lloji i pyllit	Zona	Përqindja e territorit të PKSH
- Pyll ahu (<i>Fagion moesiacaе illyricum</i>)	3067.09 ha	68 %
- Pyll i përzier ahu dhe pishë	98.80 ha	2.2 %
- Pyll i përzier ahu, pishë dhe fieri	95.30 ha	2%
- Pyll pishë (<i>Pinetum heldreichi</i>)	450.52 ha	10 %
- Pyll fieri (<i>Abietum alba</i>)	30.70 ha	0.7 %
- Pyll bredhi (<i>Picetum excelsae</i>)	5.80 ha	0.1 %
- Pyll i përzier gjethembajtëse: pishë, bredh, fier, etj.	32.80 ha	0.7 %
- Plantacione të pishës së bardhë dhe të zezë	132.62 ha	3 %
- Plantacione të bredhit	6.65 ha	0.1 %
- Pyll dhe shkurre të shkozës dhe frashërit (<i>Orno-Ostryetum carpinifoliae</i>)	499.15 ha	: 11 %
- Vegjetacion me dredhak (<i>Pinetum mughii</i>)	73.10 ha	1.6 %
- Shkurre të verit dhe lajthive:	28.96 ha	0.6 %
Gjithsej	4521.49 ha	100 %

3.5.2. FLORA

Deri tani janë shënuar 1558 lloje të bimëve të larta në Parkun Kombëtar Sharri (baza e të dhënave mbi diversitetin në Kosovë, Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave Politike, Prishtinë). Tabela 4 paraqet speciet më të rëndësishme të Parkut, sipas kritereve të ndryshme.

Tabela 4 Përmbledhje e specieve të rëndësishme të florës në Parkun Kombëtar Sharri

Statusi në Listën e Kuqe të Kosovës (i sugjeruar).	107
Statusi në Listën e Kuqe Globale të IUCN	EN- 1, VU – 1
Endemi kosovare.	12
Endemi regjionale (ballkanike).	80
Relikte terciare.	4
Relikte glaciale.	1
Specie të konsideruara veçanërisht të rralla apo të ndjeshme në Kosovë.	41
Përfshirja në Shtojcën ii b ose Shtojcën iv b të Direktivës 92/43/EEC të EU Habitat.	5
Përfshirja në Shtojcën 1 të Konventës së Bernës (Këshilli i Evropës).	3
Specie e rëndësishme ekonomikisht për Kosovën	6
Specie e rëndësishme kulturalisht për Kosovën	6

Lista e plotë e specieve të rëndësishme është dhënë në shtojcat e këtij dokumenti.

3.5.3. FAUNA

Nuk janë kryer regjistrime gjithëpërfshirëse të tërë faunës në të gjitha pjesët e Parkut Kombëtar, dhe ende ka shumë zbrazëtira në të dhëna. Numrat në vijim janë regjistruar për grupe të ndryshme taksonomike:

Gjitarë: 32 specie (pa lakuriqët).

Zogj: 200 specie.

Zvarranikë: 13 specie.

Ujëtokësorë: 10 specie.

Peshq: 7 species.

Flutura: 147 species.

Tabela 5 përmbledh numrat e specieve të Parkut Kombëtar të rëndësishme për konservim. Lista e detajuar e specieve të rëndësishme për konservim gjendet në Shtojcat e këtij dokumenti.

Tabela 5 Përmbledhje e specieve të faunës në Parkun Kombëtar Sharri

Statusi	Numri i specieve
Statusi në Listën e Kuqe të Kosovës (i sugjeruar).	1
Statusi në Listën e Kuqe Globale të IUCN	CR- 1;EN-14; VU – 19
Endemi kosovare.	0
Endemi regjionale (ballkanike).	5
Specie të konsideruara veçanërisht të rralla apo të ndjeshme në Kosovë.	30
Përfshirja në Shtojcën ii b ose Shtojcën iv b të Direktivës 92/43/EEC të EU Habitat.	26
Përfshirja në Shtojcën 1 të Konventës së Bernës (Këshilli i Evropës).	2

3.6. ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA ME TOKAT (PRONËSIA, TË DREJTAT)

3.6.1. TOKA PUBLIKE

Pronësia dhe çështjet pronësore në Kosovën vazhdojnë të mbesin një çështje komplekse dhe shpesh e pazgjidhur. Në të kaluarën burimet natyrore si pyjet, tokat pyjore, kullosat dhe tokat bujqësore menaxhoheshin nga të ashtuquajturat ndërmarrje shoqërore, në veçanti ndërmarrjet shoqërore pyjore, kooperativat bujqësore apo kombinatet bujqësore. Pyjet dhe tokat bujqësore juridikisht definohehin si 'burime për interes të përgjithshëm'. Menaxhimi i tokave të kullosave rregullohej ndryshe në komuna të ndryshme. Një pjesë e tokave për kullosa menaxhohej nga kooperativat bujqësore, siç ndodhte në Dragash (NSH Sharr-Prodhimi), ndërsa kishte raste tjera kur kullosat menaxhoheshin nga ndërmarrjet pyjore. Në regjistrat kadastralë (listat poseduese), këto resurse vazhdojnë të mbesin të regjistruara pranë këtyre ish-ndërmarrjeve si pasuri të tyre, duke krijuar kështu vështirës për caktimin e përgjegjësiave për menaxhim të tokave publike.

PYJET PUBLIKE

'Pronësia' mbi pyjet ndërlidhet nga ndarja aktuale juridike e përgjegjësiave mes MMPH dhe MBPZHR lidhur me administrimin dhe menaxhimin e pyjeve, tokës pyjore, botës shtazore dhe tokave të kullosave. Konfliktet dhe kontradiktat ligjore mes dy ministrive (MMPH dhe MBPZHR) dhe me nivelin lokal përbëjnë pengesa të mëdha për menaxhim të integruar të pyjeve. Aktualisht, duket fakt i pranuar se Drejtoria e Parkut Kombëtar është agjenci udhëheqëse për menaxhimin e pyjeve brenda Parkut, por ky qëndrim mund të sfidohet në të ardhmen.

KULLOSAT PUBLIKE

Zona e Parkut Kombëtar përfshin 25,288ha kullosa dhe 10,986ha në komunën e Shtërpçës.

TOKA PUBLIKE QË I NËNSHTROHET PRIVATIZIMIT DHE/OSE KONCESIONEVE

Bazuar në informatat nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, janë duke u zhvilluar procedurat për privatizimin e Qendrës së Skijimit në Brezovicë (shih nenin 3.11 (Turizmi dhe Rekreacioni)).

Në pjesë tjera të parkut janë propozuar zhvillime tjera turistike dhe për qëllime të skijimit, të cilat gjithashtu mund të privatizohen.

Aranzhimet aktuale ligjore për shfrytëzimin e gurëthyesëve që funksionojnë brenda Parkut janë të paqarta (p.sh. Rusenica), por do duhej siguruar që nxjerra e gurëve në Parqet Kombëtare dhe Rezerva Strikte Natyrore të jetë rreptësisht e ndaluar.

3.6.2. TOKA PRIVATE

Shtirja e përgjithshme e tokës private në Parkun Kombëtar nuk është përcaktuar saktësisht dhe kërkon vlerësim të detajuar. Rreth 15-20% të tërë territorit në fjalë është pronë private.

3.7. PALËT ME INTERES

Tabela 6 liston palët me interes primar në Parkun Kombëtar Sharri dhe identifikon rolet dhe përgjegjësitë e tyre kryesore.

Tabela 6. Palët me interes primar në Parkun Kombëtar Sharri

Pala me interes	Rolet dhe përgjegjësitë
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)	Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përcaktuar nga Rregulloret e UNMIK-ut 2002/5 dhe 2005/15. Sipas këtyre rregulloreve, përgjegjësitë e Ministrisë janë menaxhimi i sferave të mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Ministria ka kompetenca për të zhvilluar, rekomanduar dhe zbatuar politika në sektorët përkatës. Në pajtim me shtojcën 1 të Ligjit të Ndërtimit, Ministria do të ketë autoritet për të lëshuar leje të ndërtimit për punime të kategorisë III; Komunat do të lëshojnë lejet e ndërtimit për punime të kategorisë I dhe II.
Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës (AMMK, brenda MMPH)	Zhvillimi dhe bashkërendimi i sistemit informativ mbi mbrojtjen e mjedisit, në lidhje me gjendjen e mjedisit në Kosovë si dhe grumbullimi i të dhënave mjedisore. Përkrahja e organeve administrative në zhvillimin e formave të reja të politikave për mbrojtje mjedisore dhe monitorim të implementimit të planeve dhe programeve për mbrojtje të mjedisit.
Instituti për Planifikim Hapësinor	Hartimi i planeve hapësinore për zonat e veçanta dhe planifikimi dhe raportet relevante hapësinore. Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i bazës së të dhënave për planifikim hapësinor.
Drejtoria e Parkut Kombëtar Sharri	Menaxhimi, mbrojtja, mirëmbajtja dhe promovimi i zonës së mbrojtur, me qëllim të mbrojtjes dhe konservimit të autenticitetit të natyrës, ruajtjes dhe mospengimit të proceseve natyrore dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe kontrollimit të zbatimit të masave dhe kushteve për mbrojtje të natyrës.
IHMK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës	Matja sistematike hidrometeorologjike dhe vëzhgimi i lumenjve, ujërave tokësore dhe nëntokësore.
Instituti për Mbrojtje të Natyrës	Dokumentacioni dhe të dhënat mbi inventarin e të gjitha komponentave të diversitetit biologjik dhe të peziashit. Monitorimi i statusit të konservimit natyror, në veçanti të vlerave të mbrojtura natyrore.
Drejtoria për Ujëra	Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me çështje të ujit në Republikën e Kosovës. Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore të ndërlidhura me ujin. Përgatitja e planeve të menaxhimit të shtretërve të lumenjve, etj.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Departamenti i Pylltarisë (DP)	Bashkëpunimi me Drejtorinë e PK në mbrojtjen e ekosistemeve pyjore të PKSH.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Departamenti i Turizmit	Përcaktimi i bazës ligjore dhe kornizës institucionale, parimeve dhe rregullave për zhvillim dhe promovim të turizmit, përgatitja dhe zhvillimi i standardeve për shërbime për turistë.
Ministria e Punëve të Brendshme: Shërbimi policor, Policia kufitare	Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit shtetëror. Dhënia e ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave tjera. Zbatimi i ligjit.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Bashkëpunimi me Drejtorinë e PK në mbrojtjen e vlerave kulturore të PKSH.
Ministria e Infrastrukturës	Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rrugore në bashkëpunim me Drejtorinë e PKSH.
Komunat: Dragash, Prizren, Suharekë, Shtërpce, Kaçanik.	Bashkëpunim me Drejtorinë e PK në mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të PKSH. Kompetencat a) Lejet ndërtimore në bazë të pëlqimeve mjedisore të MMPH-së; b) Tatimi për biznesët (veprimtarive komerciale-ekonomike); c) Tatimi mbi pronë; d) Regjistrat kadastralë.
51 fshatrat	Bashkëpunimi në mbrojtjen e vlerave të PKSH. Mundësia e shfrytëzimit të resurseve natyrore (kullosave, frutave pyjore etj.) të komunitetit lokal në bazë të Planit të Menaxhimit dhe planeve tjera përkatëse.

Drejtoria e Hidroregjionit	Bashkëpunim me Drejtorinë e PK në mbrojtjen e resurseve ujore të PKSH.
Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Matematikës dhe shkencave natyrore	Parimet dhe objektivat që i kontribuojnë dukshëm zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, duke intensifikuar hulumtimet shkencore dhe duke përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shpërndarjes së të mirave që rrjedhin nga respektimi i vlerave sociale dhe mbrojtja e mjedisit.
Organizatat joqeveritare	OJQ-të kryesore që funksionojnë në këtë zonë janë 1. "Sharri" – Prizren. OJQ përgjithësisht mjedisore. 2. "Natural Fresh"- Reçan. Organizatë mjedisore e fokusuar në ujë. 3. "Ambienti" - Dragash. Organizatë mjedisore. 4. "Ardhmëria"- Suharekë. Mbrojtja e natyrës. 5. OJQ e bjeshkatarëve – Prizren. Organizatat e bjeshkatarëve. 6. OJQ " FINCHES" – Prizren. Ornitologji. 7. OJQ " Bletarët" – Prizren. Bletari. 8. OJQ " Spelologët" Prizren. Speleologji. 9. OJQ e vëzhguesve – Prizren. Ecje dhe mbrojtje e natyrës.
PTK dhe KEK	Shpërndarja dhe infrastruktura e energjisë elektrike. Zhvillimi dhe monitorimi i sistemit të telekomunikacionit.
Kompanitë turistike private (hotele, resorte, etj.).	Ofrimi i shërbimeve turistike të transportit, akomodimit, ciceronëve turistikë dhe shërbimet tjera.
Kompanitë për tregtimin (grumbullimin) e produkteve jopyjore.	Organizimi dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, barërave aromatike dhe frutave të malit, si dhe marketingu i tjera në bazë të lejes së MMPH-së. Kompanitë kryesore janë "HIT Flores"- Dragash, "N. T. "Besjana", Ferizaj, N.T. "Bolcan", Gjilan.

3.8. VENDBANIMET DHE POPULLATA

Brenda Parkut Kombëtar Sharri të vetmet vendbanime janë si në vijim:

- Disa shtëpi druri që shfrytëzohen nga barinjtë gjatë verës.
- Stabilimentet dhe objektet turistike në Prevallë dhe Brezovicë. Momentalisht ekzistojnë rreth 500 shtëpi.

Përgjatë kufijve të Parkut ekzistojnë 51 fshatra, të cilat bien në territore të pesë komunave: Dragash (22 fshatra), Prizren (13 fshatra); Suva Reka (4 fshatra); Shtërpce (9 fshatra) dhe Kaçaniku (3 fshatra) me numër të popullatës së regjistruar prej 61,426 banorësh. Shih tabelën 7.

Tabela 7. Regjistri i fshatrave që kufizohen me Parkun Kombëtar Sharri.

Nr	Dragash	Banorë	Prizren	Banorë	Suhareka	Banorë	Shtërpce	Banorë	Kaçanik	Banorë
1	Zaplluxhe/Zaplluxhe	1,273	Zhure	5,909	Grekoce	2,534	Berevce	287	Gllloboqica	1,287
2	Blaq	1,455	Struzhe	102	Mushtisht	3,394	Vrbestica	450	Biçeci	1,696
3	Bresane	2,839	Manasteric	1,107	Delloç	160	Sevce	176	Strazha	258
4	Kuklibeg	852	Lubinje e Poshtme	1,227	Maçiteve	424	Jazhince	162	Slatina	211
5	Kuke	1,658	Lubinje e Epërme	1,925			Brezovicë	68	Vata	1,675
6	Kosave	905	Drajçiq	151			Shtërpce	1,265	Dubrava	564
7	Pllajnik/Plajnik	405	Mushnikove	133			Gotovush	445		
8	Radesha	1,224	Gronjaselle	292			Drajkoce	106		
9	Leshtane	783	Sredske	69			Brod	1,680		
10	Dikance	124	Pllanjane	1,104						
11	Baçke	52	Reçane	951						
12	Brod	1,544	Skorobishte	1,128						
13	Zlipotok	610	Korishe	5,279						
14	Restelica	4,698								
15	Krusheve	857								
16	Globoçice	960								

17	Orqush	60							
18	Rapçe	853							
19	Krstece	420							
20	Pllave	1,000							
21	Buqe	645							
22	Brezne	1,990							
Gjithsej		25,207	19,377	6,512	4,639			5,691	
Total:								62,426	

3.9. PËRDORIMI I TOKAVE DHE RESURSEVE

3.9.1. STATISTIKA TË PËRGJITHSHME

Harta 9 paraqet përdorimin kryesor të tokave brenda Parkut Kombëtar. Statistikat përkatëse janë përmbledhur në tabelën 8. Të dhënat tregojnë se në zonë dominojnë pyjet dhe kullosat, të cilat mbulojnë rreth 82% të sipërfaqes së Parkut.

Tabela 8 Përdorimi i tokave dhe resurseve në Parkun Kombëtar Sharri

Lloji i përdorimit të tokave		Sipërfaqja (ha)	Përqindja e sipërfaqes së PKSH
1.	Shkëmbinj të zhveshur, gurë, shkrepë pa rendimente	1,355.33	2.53
2.	Pyje me fletë të gjera	9,446.03	17.67
3.	Tharqe të bagëtisë dhe instalime të barinjve (në zona malore)	10.05	0.02
4.	Kultivime komplekse me dru mbrojtëse	88.26	0.17
6.	Pyje gjethembajtëse	2,670.62	4.99
7.	Zabele	3,005.92	5.62
8.	Pyje të përziera	3,066.95	5.74
9.	Mbulesë e vazhduar urbane	5.70	0.01
10.	Mbulesë e ndërprerë urbane	9.30	0.02
11.	Njësi industriale apo komerciale	8.21	0.02
12.	Zona të mbuluara me ujë	24.14	0.05
13.	Vegjetacion shëndetësor, përfshirë kënetat	1,367.98	2.56
14.	Bari natyral	15,802.82	29.55
15.	Shtrirje natyrore ose artificiale të ujit	1.96	0.00
16.	Tokë e punueshme e paujitur	3.89	0.01
17.	Kullosë ekstensive me shkurre	1,108.53	2.07
18.	Kullosë intensive pa dru dhe shkurre	7,812.15	14.61
19.	Kullosë intensive me rrethojë	233.58	0.44
20.	Kullosë intensive me dru dhe shkurre	32.14	0.06
21.	Kullosë intensive pa rrethojë	71.82	0.13
22.	Kullosë intensive me dru dhe shkurre	358.50	0.67
23.	Pyll bregor	21.04	0.04
24.	Zonë me vegjetacion të pakët	4,088.58	7.65
25.	Pyje/shkurre transitore	1,419.15	2.65
26.	Ligatina	1,443.50	2.70
27.	Ngastra malore	15.33	0.03
GJITHSEJ		53,471.48	100

3.9.2. MONUMENTET KULTURORE

Në Park Kombëtar dhe përreth tij ekzistojnë një numër i madh monumentesh kulturore. Monumentet e shpallura të tilla zyrtarisht janë përgjegjësi e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Lista e monumenteve është përfshirë në Shtojcat e këtij dokumenti.

3.9.3. KULLOSAT

Kullosat e shumta në regjionin e PKSHT janë arsyeja për numrin e madh të bagëtive në këtë rajon, në krahasim me vise tjera të Kosovës. Numri i gjithmbarshëm i supozuar i bagëtive në këto 5 komuna arrin në 92,869 kokë, që përbën 21% të numrit të gjithmbarshëm të bagëtive në Kosovë (MBPZHR, 2010). Kullotja kryesisht zhvillohet në komunat e Dragashit dhe Prizrenit, ku kryesisht kultivohen delet. Në tabelën 9 është paraqitur shpërndarja dhe sasia e bagëtive në Kosovë dhe në pesë komunat relevante. Harta 11 paraqet zonat kryesore të kullotjes (aktuale dhe potenciale) në Parkun Kombëtar Sharri.

Tabela 9 Zonat e kullotjes dhe numri i deleve në nivel të Kosovës dhe të Parkut Kombëtar Sharri

	Kosovë	Kosovë	Kosovë	Kosovë	Parku Kombëtar Sharri
Viti	1955	1980	1988	2004	2010
Sipërfaqja e kullosës (ha)	193,000	189,000	175,500	153,000	25,288 ³
Dele për hektar	3.2	1.7	2.4	0.6	3.7
Dele	617,600	321,300	420,000	91,800	92,869 ⁴

Menaxhimi i shumicës së kullosave në Park nuk është e rregulluar dhe organizohet nga popullata lokale në bazë të traditave dhe aranzhimeve dhe marrëveshjeve lokale. Kjo mbetet një nga burimet më të rëndësishme të jetesës për shumë banorë të kësaj zone, por raportohet rënie e nivelit të këtij aktiviteti me vjetërsimin e popullatës së parkut. Kullotja normalisht realizohet mes majit dhe shtatorit. Në zonën origjinale të Parkut Kombëtar rreth 30% të fermerëve lokalë i kullotin kafshët e tyre në këtë zonë dhe Administrata e PKSHT ka lëshuar kontrata për 5 kontraktorë të kullotjes.

3.9.4. PYLLTARIA DHE SIPËRFAQET PYJORE

Sipërfaqet pyjore zënë rreth 34% të tërës sipërfaqes së PKSHT. Rritja vjetore pyjore është inkrementale me rreth 5m³ për hektar, duke arritur kështu shifrën prej 80,890 m³ për tërë sipërfaqen e pyllëzuar të Parkut. Në përgjithësi, cilësia e pyjeve brenda Parkut është më e lartë se sa norma mesatare e rritjes së pyjeve në nivel kombëtar.

Faktorët më sfidues që prekin sektorin pyjor në Kosovë ndërlidhen me menaxhimin e dobët, prerjen joligjore, degradimin e tokave pyjore si rrjedhojë e prerjes joligjore të druve, nxjerrjes së pakontrolluar të zhavorrit, ndikimit të kafshëve apo insekteve të dëmshme, sëmundjeve dhe zjarreve.

PRODHIMTARIA E DRURIT

Më parë kanë ekzistuar Plane për Menaxhimin e Pyjeve të të gjitha njësive përkatëse të Parkut Kombëtar Sharri. Që nga viti 2000 janë prodhuar vetëm dy plane të reja dhjetëvjeçare për menaxhimin e pyjeve, për menaxhimin e njësive Koritnik I dhe Koritnik II të zonës së Dragashit. Aktualisht, asnjëri nga këto plane nuk është duke u zbatuar.

Gjendja aktuale është si në vijim:

Prizren. Drejtoria e Parkut Kombëtar lejon pastrimin sanitar e rreth 300 m³ të drurit të vdekur dhe të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore (era dhe bora) në vit, që shfrytëzohen nga popullata lokale si dru për djegie.

Shtërpcë. Nuk ka të dhëna zyrtare në dispozicion për prerjet e pyjeve. Raportohet se në zonë nuk ka prodhimtari të drurit, por se sasi të mëdha shfrytëzohen si dru për djegie.

Koritniku I dhe II. Plani i menaxhimit specifikon korrjen e rreth 4000 m³ në këto dy zona pyjore gjatë vitit 2013.

Kaçanik. Nuk ka të dhëna në dispozicion.

Opojë. Nuk ka të dhëna në dispozicion.

Suharekë. Raportohet se nuk ka korrje fare.

Në disa zona rurale (Delloc, Maçitevë, Koritniku 1, Manastirica, Brodi-Gotovusha, etj.) të PKSHT paraqiten prerjet ilegale të pyjeve, të cilët janë pasojë e gjendjes së rëndë socio-ekonomike të popullatës rurale dhe faktorëve të tjerë.

³Burim: Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar Sharri

⁴Burim: Kontributi ekonomik i ekosistemeve në Parkun Kombëtar Sharri dhe përreth tij në ekonominë e Kosovës, qershor 2013.

DRURI PËR DJEGIE

Ekziston kërkesë e konsiderueshme për dru për djegie në Kosovë, por nuk ka në dispozicion shifra për kërkesën për dru apo saktësisht lidhur me sasinë e drurit për djegie që grumbullohet brenda territorit të Parkut Kombëtar (nga pyjet publike dhe private). Me gjasë, sasia aktuale e drurit të korrur është shumë më e lartë se sa ajo që parashikohet në Planet për Menaxhimin e Pyjeve. Tabela 10 paraqet kalkulimet e supozuara të kërkesës maksimale potenciale të komuniteteve përreth Parkut. Proporcioni i mbulueshmërisë së kërkesës së tillë nga vet Parku nuk dihet, por gjasat janë që të jetë i lartë.

Në teori, nëse supozojmë se 70% të rritjes vjetore do të mund të shfrytëzohej, prodhimtaria vjetore nga Parku do të mund të ishte rreth 63,000 m³. Studimet kanë treguar se konsumi minimal vjetor i drurit për ekonomi familjare është rreth 7.5 m³, që do të rezultonte se korja vjetore në dispozicion (63,663 m³) do të përmbushte nevojat e rreth 8,488 familjeve. Megjithatë, zonimi i parkut dhe fakti që shumë zona të tij janë të papërshtatshme për aktivitet të pylltarisë do të mund të rezultonte me prodhimtari shumë më të ulët vjetore.

Tabela 10 Parashikim teorik i kërkesës për dru për lëndë djegëse nga komunitetet përreth Parkut Kombëtar Sharri

Popullata përreth Parkut	Rreth 60,000
Mesatarisht persona për ekonomi familjare	Rreth 6
Gjithsej ekonomi familjare	Rreth 10,000
Konsumi mesatar për ekonomi familjare	7 m ³ në vit – 8.5 m ³ në vit
Gjithsej kërkesë	70,000 m ³ – 85,000 m ³ në vit.
Çmimi mesatar i druve për djegie	€45 - €55 për m ³
Gjithsej vlera e tregut e kërkesës për dru	€3,150,000 - €4,675,000 në vit.

3.9.5. PËRDORIMI I UJËRAVE

Komunat përreth Parkut varen në masë të gjerë nga ujërat nga burimet dhe ujërat sipërfaqësore të Parkut. Detajet mbi furnizimin e ujit në këto komuna janë përfshirë në Shtojcat e këtij dokumenti.

3.9.6. PRODUKTET JODRUNORE

Në komunën e Dragashit, do të thotë brenda Parkut Kombëtar, janë kryer studime për të identifikuar zona që shfrytëzohen për grumbullim të barërave shëndetësore, kërpudhave, frutave të egra dhe drurit për djegie. Nuk është bërë monitorimi sistematik i sasive të grumbulluara, vlerave të tyre, praktikave apo stinëve të grumbullimit. Informatat që kryesisht janë dhënë nga Drejtoritë e PKSHE janë përmbledhur në vijim.

- **Boronicat.** Ekziston një rendiment potencial prej 50 tonë në vjet në zonën e PKSHE. Ato grumbullohen nga popullata lokale dhe nga njerëz të tjerë dhe shpesh u shiten 'ndërmjetësuesve' të cilët paguajnë rreth 3 euro për kilogram. Çmimi i tregut është mbi 5 euro për kilogram. Ka dëshmi të shfrytëzimit të metodave mekanike dhe të dëmshme për grumbullimin e boronicave.
- **Mjalti.** Administrata e PKSHE do dëshironte ta shtojë numrin e hojeve të bletëve në PK.
- **Kërpudhat.** Raportohet se janë grumbulluar më shumë se që duhet në të kaluarën dhe se nuk janë të pranishme në sasi komerciale. Pretendohet se njerëzit me qëllim kanë ndezur zjarre në zonën e Koritnikut për të inkurajuar rritjen e disa llojeve të caktuara të kërpudhave.
- **Bimët mjekësore.** Janë të pranishme specie të ndryshme. Sasia e grumbullimit është e panjohur.
- **Grumbullimi shkencor.** Është raportuar se disa profesorë universitarë kanë kërkuar nga studentët e tyre që të grumbullojnë sasi të mëdha të specieve të rrezikuara.

3.9.7. GURËTHYESIT

Sipas ligjit, është rreptësisht e ndaluar që të nxirren gurë në Parqe Kombëtare. Një gurëthyes i gurit gëlqeror, ligjshmëria e veprimtarisë së të cilit është e kontestuar, vepron në zonën e Rusenicës (rezervat i maces së egër), ku ka shkaktuar dëm dhe pengesa të shumta. Një tjetër gurëthyes ekziston në Oshlak, në afërsi të fshatit Mushnikovë; ndërrimet e kufijve që janë bërë kohës së fundit kanë bërë që ky gurëthyes të mbetet jashtë Parkut. Në zonën e shkëmbinjeve serpentinë në Malet e Pashallores ekzistojnë minierat e vjetra dhe të pashfrytëzuara të kromit. Ngritja e çmimit global të metaleve mund të shtojë presionin për t'i riaktivizuar këto miniera në të ardhmen.

3.9.8. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar Sharri ofron detaje mbi infrastrukturën kryesore publike në dhe përreth Parkut Kombëtar sa u përket rrugëve, infrastrukturës ujore, energjisë elektrike dhe telekomunikacionit.

3.9.9. TURIZMI DHE REKREACIONI

VIZITUESIT DHE PËRDORIMET KRYESORE

Përdorimet kryesore turistike të parkut janë:

- Vizitat joformale për piknik gjatë fundjavave. Turistët janë kryesisht vendorë.
- Veprimtaritë e jashtme natyrore, siç janë ecja, bjeshkataria dhe vrojtimi i botës shtazore. Turistët janë kryesisht vendorë, ndërsa numri i turistëve të huaj është i vogël por në rritje, përfshirë këtu punonjësit e organizatave dhe agjencive të huaja që punojnë në Kosovë.
- Pushimet në vila dhe shtëpi pushimi. Turistët janë kryesisht vendorë.
- Skijimi dhe sportet tjera dimërore. Turistët kryesisht vendorë me një numër të vogël të turistëve të huaj, përfshirë këtu punonjësit e organizatave dhe agjencive të huaja që punojnë në Kosovë.

Harta 10 paraqet lokacionet e pikave të rëndësishme (aktualisht dhe potencialisht) për zhvillimin e turizmit në Parkun Kombëtar Sharri. Tabela 11 paraqet zonat kryesore turistike të Parkut dhe parashikimet mbi numrin e vizitorëve që kryejë veprimtari të ndryshme. Numri i vizitorëve është përcaktuar në bazë të të dhënave dhe informatave të grumbulluara nga rojet dhe mbikëqyrësit tjerë të PKSH.

Tabela 11 Vizitorët në Parkun Kombëtar Sharri

Zonat turistike		Numri maksimal i vizitorëve (fundjava dhe pushime)	Numri i parashikuar i vizitorëve për vit
Prevallë (Prizren)	Turizëm fundjave dhe pikniku (gjatë tërë vitit)	500	25000
	Turizëm rezidencial gjatë verës (qershor - gusht)	150	13500
Brezovicë (Shtërpce)	Turizëm fundjave dhe pikniku (dhjetor - shkurt)	3000	36000
	Turizëm rezidencial gjatë dimrit (dhjetor - shkurt)	100	9000
Ujërë e Gropuar (Prizren)	Turizëm fundjave dhe pikniku. (maj - shtator)	100	2000
Guri i Zi (Prizren)	Turizëm fundjave dhe pikniku.	50	1000
Gradancë (Suharekë)	Turizëm rezidencial gjatë verës (qershor - gusht)	100	9000
Kroni i Madh (Suharekë)	Turizëm rezidencial gjatë verës (qershor - gusht)	30	2700
Brod (Dragash)	Turizëm fundjave dhe pikniku (maj - tetor)	300	7200
			105,400

STABILIMENTET TURISTIKE

Stabilimentet kryesore turistike janë listuar në Tabelën 12.

Tabela 12 Infrastruktura dhe stabilimentet turistike në Parkun Kombëtar Sharri

Lokacioni	Lloji i ndërtesës	Numri i ndërtesave
Prevallë (komuna e Prizrenit)	Motel-restorant	5
	Restorant	4
	Ndërtesa private (shtëpi vikendi)	126
	Shtëpi malore	2
	Shitëse kontejner	6
	Ski-lift bazik	1
Ujërë e Gropuar (Prizren)	Shtëpi malore	1
Qendra e skijimit Brezovica (komuna e Shtërpçës)	Hotel	2
	Restorant	1
	Shtëpi malore	2
	Ski-lift bazik	7

Brezovicë, fshati turistik (resorti) (komuna e Shtërpcës)	Motel-restorant	2
	Ndërtesa private (shtëpi vikedi)	150
Brod (komuna e Dragashit)	Hotel	1
	Restorant	1
	Shtëpi malore	1
	Ski-lift bazik	1

ZONA E SKIJIMIT BREZOVICË

Master Plani për Qendrën Malore të Brezovicës është përgatitur (me përkrahje nga BE) për të planifikuar një zgjerim të theksuar të stabilimenteve në këtë zonë, duke mbuluar një sipërfaqe të gjithmbarshme prej 3,700 ha. Planifikohet një qendër skijimi i madhësisë së mesme, që ka për qëllim inkurajimin e qëndrimeve më të gjata, jo sikur qendra ekzistuese e skijimit. Përveç kësaj, mysafirët që nuk skijojnë dhe ata që duan ta vizitojnë zonën gjatë vitit do të kenë mundësi të rekreacionit alternativ. Në krahasim me zonën ekzistuese të skijimit, kapacitetet e pranimit të mysafirëve do të trefishohen. Pritet që zbatimi i Master Planit të propozuar të zgjasë së paku 10 apo 15 vite.

Ky Koncept Zhvillimor përbëhet nga dy pjesë themelore: Zhvillimi i zonave bazike (fshati, parkingu, qasja, zonat rekreative dhe stabilimentet e shtigjeve) dhe Zhvillimi malor (liftat, pistat, stabilimentet malore dhe aktivitetet tjera).

Parashihen zhvillimet në vijim:

- Baza e skitarëve ditorë dhe zona e parkimit.
- Fshati i qendrës malore me akomodim publik, hapësirë komerciale, hapësirë për konferenca dhe ilixhe, dhe akomodim privat rreth tij.
- Zhvillimi i pronave ekskluzive të paluajtshme në lartësi 1,850m lbd.
- Një zonë rekreative pranë liqenit.
- Qendra e skijimit, me 5 lifte të mëdhenj, 2 ski-lifte më të vegjël dhe disa lifte për fillestarë.
- Një qendër familjare me mbi 35 pista dhe 26.3km pista për të gjitha nivelet.
- Qendra malore me hapësirë komerciale, restorante dhe shërbime të ndryshme për mysafirë.
- Një restorant në majë të malit, në pikën më të lartë të qendrës.
- Aktivitete tjera rekreative, përfshirë mbi 30km shtigje shëtitjeje verore.

Master Plani nuk ngërthen vlerësimin e ndikimit mjedisor. Qeveria e Kosovës aktualisht është duke hulumtuar mundësitë e financimit dhe implementimit të Master Planit.

PROPOZIME TJERA PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT DHE SKITARISË

DRAGASH

Turizmi natyror planifikohet të zhvillohet në zonat e Opojës dhe Gorës, duke u fokusuar në ofrimin e akomodimit dhe informatave turistike dhe qasjes në shtigje të ecjes, shtigje të skitarisë, vendeve për piknik, peizazhe të mrekullueshme dhe trashëgimi kulturore. Vendbanimet e parapara që të shndërrohen në qendra turistike janë Zaplluzhë, Brod, Restelicë, ndërsa qyteza e Dragashit do të shndërrohet në 'kamp bazik'. Dokumenti i përkrahur nga UNDP "Plani Zhvillimor i Komunës së Dragashit 2012-2022" propozon krijimin e qendrave të skijimit në Zaplluzhë, Opojë, Brod dhe Pllajnik.

PROPOZIMET NË ZONËN E VJETËR TË PARKUT KOMBËTAR SHARRI

Prevallë. Ekziston një propozim për skijim në fushat me barë që shtrihen nga rruga Prizren - Shtërpcë deri në majë të Gurit të Pavlovit, e më tej në drejtim të verilindjes nga Toshovica.

Guri i Zi. Propozimi parasheh skijim në vegjetacionet barishtore mbi pyjet e ahut.

Gradancë: Zona që gjendet në rajonin e fsatit të Mushtishtit e përshtatshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.

Pllosh (Guri i Dellocit): Zona mbi fshatin Delloc e përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor.

Ujërat e Gropuar: Zona mbi fshatin Skorobisht e përshtatshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.

3.10. MENAXHIMI AKTUAL I PARKUT KOMBËTAR SHARRI


3.10.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE MENAXHMENTI

Parku Kombëtar Sharri menaxhohet nga Drejtoria e Parkut Kombëtar që ndodhet në Prizren, nën Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) të MMPH. Struktura e Drejtorisë është paraqitur në Figurën 1. Aktualisht, numri i punonjësve është 18, nga të cilët 9 janë staf profesional dhe 8 janë punonjës në terren (Tabela 13).

Tabela 13. Struktura ekzistuese organizative e menaxhmentit të Parkut

1. Drejtor i PK	1
2. Zyrtar për administratë dhe financa	1
3. Udhëheqësi i sektorit të pylltarisë	1
4. Zyrtar për mbrojtje të pyjeve	1
5. Zyrtar për kadastar dhe gjeodezi	1
6. Zyrtar i lartë për natyrë	1
7. Zyrtar për zona të veçanta	1
8. Zyrtar për ujë dhe klimë	1
9. Zyrtar për ruajtje të natyrës	1
10. Zyrtar për infrastruktur dhe GIS	1
11. Roje e parkut	8
GJITHSEJ	18

Figura 1 Struktura aktuale organizative (organogrami) i Drejtorisë së Parkut Kombëtar Sharri



Veprimtaria menaxhuese e Drejtorisë aktualisht ushtrohet në zonat e Parkut të cilat janë në komunat e Prizrenit dhe Suharekës, ndërsa në komunat e Dragashit, Kaçanikut dhe Shtërpçës, Drejtoria kryesisht luan rol kontrolli dhe monitorimi. Disa zona të Parkut Kombëtar në territorin e Dragashit, Kaçanikut dhe Shtërpçës ende mbesin nën menaxhimin e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, ndërsa menaxhimi i Parkut në Shtërpçë ndërlikohet nga prania e sistemit të mbetur paralel të menaxhimit. Është fakt i pranuar se zgjerimi i Parkut Kombëtar do duhet të përkrahet me shtim të theksuar të numrit të stafit.

3.10.2. INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET

Infrastruktura dhe pajisjet në dispozicion të Administratës së Parkut Kombëtar Sharri janë listuar në Tabelën 14.

Tabela 14 Infrastruktura dhe pajisjet kryesore në dispozicion të Administratës së Parkut Kombëtar Sharri

Infrastruktura/pajisjet	Numri/detajet
Ndërtesa e zyrës qendrore (Prizren)	1 (200 m ²)
Stacionet e rojeve	1. Ujërat e Gropuar (260 m ²). 2. Liqeni i Jazhincës (120 m ²). 3. Prevallë (100 m ²). Gjithsej: 3 shtëpi të rojeve = 480 m ²
Veturat	Gjithsej 4 vetura. 1 x KIA; 1 x Mitcubishi; 1 x Nisan Patrol; 1 x Tojota
Pajisjet e zyrës	Kompjuterë (7); Printerë (3); Printerë (3); Kopjues (1); Projektor (1), Ngrohës elektrik (6); Tavolina të zyrës (13); Karrige (20); Shirita mobilë (7); Dollapë metalik (5); Vitrina pune (8); Vitrina metalike (5); Telefonë (3) dhe Tavolina (1).
Pajisjet për terren	GPS (3); Kamera digjitale (12); Dylbi (2)
Veglat dhe pajisjet	Korrës bari (1); Pajisje për fikje zjarri (10); Fikës zjarri 25l (10); Pajisje për fikje zjarri P12 - 12 kg (2), Vegla të ndryshme të dorës.

4. VLERËSIMI (STATUSI AKTUAL DHE GJENDJA E SYNUAR)

Analizat në vijim bazohen në një sërë burimesh, përfshirë:

- Raporti i UNEP i vitit 2010 mbi arsyeshmërinë e themelimit të një zone ndërkufitare të mbrojtur në rajon⁵.
- Studimet e kryera nga Administrata e Parkut Kombëtar Sharri dhe partnerët e tyre.
- Draft-Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri (2013)
- Atllasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDA) dhe raportet e ndryshme dhe dokumentet përkrahëse të përgatitura nën projektin e UNDP "Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Përdorimit të Qëndrueshëm të Tokave në Dragash". SDA përmban një numër të madh vlerësimesh bazike, analizash dhe rekomandimesh, të cilat përkrahen me harta të detajuara të bazuara në GIS. Dokumenti në fjalë do duhej konsultuar bashkërisht me këtë plan të menaxhimit.
- Raport i gjendjes së vlerave natyrore të PK Sharri për vitin 2011.

4.1. TIPARET DHE VLERAT NATYRORE (SPECIET, HABITATET, EKOSISTEMET, PEIZAZHET)

Vlera më e rëndësishme e Parkut Kombëtar Sharri është fakti që ai ngërthen një sekuencë të tërë ekosistemesh në gjendje të mirë, në substrakte të ndryshme, nga malet e deri tek kodrinat. Të ndërlidhura me to janë flora dhe fauna pothuajse e paprekur, që përfshin edhe shumë specie të rralla dhe endemike. Ndikimet njerëzore ekzistojnë dhe janë në rritje, megjithëse ende janë të lokalizuara dhe sipërfaqja e Parkut ende nuk ka pësuar degradim apo fragmentim të theksuar apo të përhapur.

4.1.1. EKOSISTEMET

PYJET

Vlera e pyjeve në Park Kombëtar demonstron nga fakti se 97% të sipërfaqes pyjore të komunës së Dragashit është identifikuar se kualifikohet si 'Pyll me Vlerë të Lartë për Ruajtje' (në bazë të rëndësisë së biodiversitetit të tij dhe funksioneve tjera të ngjashme - shih Tabelën 15). Për zonat tjera të Parkut Kombëtar nuk është kryer vlerësimi i statusit të ruajtjes së pyllit.

Tabela 15 Vlerësimi funksional në sektorin e PKSH në Dragash sipas kritereve për vlerën e lartë për ruajtje të pyjeve

Funksioni	Shërbimi i ekosistemit/specifikimi	Shembull	Lloji i ndërlidhur i HCV
Prodhimi i drurit	Pjesa e prodhimit bruto që nxirret si lëndë e parë.	Prodhimi i lëndëve të drurit/drurit për ngrohje.	HCV 5 (dru për djegie)
Prodhimi i produkteve jodrunore	Pjesa e prodhimit primar që nxirret si lëndë e parë apo produkt primar.	Prodhimi i peshkut, kafshëve të egra, drithërave, arrave, gjuetisë, grumbullimit, fermave apo peshkatarisë.	HCV 5
Kontrolli i erozionit dhe ruajtja e sedimentit	Ruajtja e dheut brenda një ekosistemi.	Parandalimi i humbjes së dheut nga fryma, ikja apo proceset e largimit, ruajtja e lymit në liqene dhe ligatina.	HCV4
Mbrojtja nga rreziku	Mbrojtja nga orteku, rrëshqitja e dheut dhe rënia e gurëve.	Pyjet në pjerrtësi prej 20 shkallës e më tepër ofrojnë mbrojtje të mirë kundër ortekëve.	HCV4, HCV5
Biodiversiteti	Habitatet për specie të bimëve dhe shtazëve të rëndësishme në aspekt global, rajonal dhe lokal, habitatet e pasura me specie (apo komplekset e habitateve).	Fidanishtet, habitatet për speciet migruese, habitatet rajonale për specie lokale, apo zona për kalimin e dimrit.	HCV1, HCV2, HCV3

⁵UNEP-ISCC (2010) 'Studimi i fizibilitetit për krijimin e një zone tejkufitare të mbrojtur të maleve Sharr - Korab - Deshat. UNEP, Vjenë. http://www.unep.at/documents_unep/Balkan_Feasibility_Studies/Sharr_25-10-2010.pdf

Rregullimi i ujit dhe furnizimi i ujit	Rregulli i rrjedhave hidrologjike, ruajtja dhe mbajtja e ujit.	Sigurimi i ujit për konsum njerëzor, në sasi dhe cilësi të mirë.	HCV4
Kulturore (të pavlerësuara në SDA)	Ofrimi i mundësive për përdorim jokomercial.	Veprimtari estetike, artistike, arsimore, shkencore dhe shpirtërore.	HCV6

Ekosistemet pyjore që kërkojnë kujdes dhe mbrojtje të veçantë janë ato të lartësive më të mëdha, të cilat përfshijnë mbetjet e fundit të pyjeve të lashta me lloje endemike të pyjeve të pishave me *Pinus peuce* dhe *Pinus heldreichii* (*ssp. leucodermis*), të cilat janë të përziera në vise paksa më të ulëta me *Picea abies* dhe *Abies alba*. *Pinus mugho* në lartësi më të larta dhe në pyje që dominohen nga shkurret janë gjithashtu të rëndësishme. Një tipar i rëndësishëm i pyllit me gjethe të gjerë në lartësi më të ulëta është vazhdimësia dhe shtrirja e tyre në sipërfaqe të mëdha të Parkut Kombëtar dhe përbërja dhe gjendja pothuajse natyrore e sipërfaqeve gjegjëse. Lokacionet me rëndësi më specifike të Parkut Kombëtar janë paraqitur në Tabelën 16.

Tabela 16 Lokacionet e Parkut Kombëtar me rëndësi më specifike

Lokacioni	Komunitetet e rëndësishme pyjore
Prevallë	<i>Seslerio-Pinetum heldreichii</i> , <i>Fago-Pinetum heldreichii</i>
Pisha e Madhe	<i>Seslerio-Pinetum heldreichii</i> , <i>Fago-Pinetum heldreichii</i>
Ujërat e Humbur	<i>Ajugo-Pinetum peucis</i> , <i>Pineto-Pinetum peucis mixtum</i> , <i>Pinetum peucis heldreichii</i> , <i>Fago-Pinetum peucis</i> , <i>Rhododendro-Pinetum peucis</i>
Përroska e Durlës	<i>Rhododendro-Pinetum peucis</i> , <i>Acero heldreichii-Fagetum moesiaceae</i>
Jelovarnik	<i>Fago-Pinetum peucis</i> , <i>Vaccinio-Junipero-Pinetum peuceae</i>
Koxha Ballkan	<i>Fago-Pinetum heldreichii</i>
Gryka (Kokoshinje)	<i>Fageto - Taxetum baccata</i>
Koxha Ballkan	<i>Piceto-Pinetum heldreichii</i>
Pashallare (Ostrovicë)	<i>Ptilitricho-Bruckenthalio-Pinetum heldreichii</i> , <i>Ptilitricho-Bruckenthalio-Pinetum heldreichii mughetosum</i> , <i>Pinetum heldreichii peuces scardicum</i> , <i>Fagetum montanum serpentanicum</i> , <i>Ptilitricho-Bruckenthalio-Pinetum mughi</i>
Koritnik	<i>Abietum-alba koritniensis</i> , <i>Abietum borisii-regis</i> , <i>Pinetum heldreichii typicum</i> , <i>Lembotropo-Quercetum cerris</i> , <i>Quercetum trojanae dukagjini</i> .
Tociv	<i>Quercetum trojanae</i> , <i>Junipero-Quercetum trojanae</i>

KULLOSAT

Zonat më të larta të Parkut Kombëtar dominohen nga kullosat alpine dhe subalpine dhe nga vargjet e shkrepave, shkëmbinjve dhe rrëpirave të substrakteve të gurit gëlqeror ose silikateve. Këto zona diverse ofrojnë disa nga habitatet më të pasura me specie në Evropë, përfshirë edhe proporcionin e madh të specieve endemike. Livadhet ofrojnë habitate për komunitete të rëndësishme shtazore, në veçanti për insekte dhe zogj, si dhe për një faunë të pasur alpine, si për shembull të dhive të egra (*Rupicapra rupicapra*).

Disa nga zonat alpine dhe livadheve në substrakte shkëmbore kërkojnë fare pak menaxhim aktiv, përveç mbrojtjes së tyre: ato mund të jenë tejet të brishta dhe me afinitet për tu dëmtuar, qoftë nga bagëtia qoftë nga turistët. Shumë livadhe tjera subalpine janë ruajtur përgjatë shekujve falë kullotjes së bagëtive, që është menaxhuar nga barinj që kanë pasur dijeni tradicionale mbi mënyrën e mirëmbajtjes. Tejkullotja shpie tek erozioni dhe pushtimi i livadheve nga specie tjera konkurruese dhe të dëmshme, ndërsa nënkullotja rezulton me pushtim të shkurreve dhe humbje të produktivitetit. Migrimi njerëzor nga zona ka rezultuar me rënie të numrit të bagëtive gjatë dekadave të fundit dhe kjo mund të zvogëlojë vlerën ekologjike të livadheve alpine. Ballkani është një nga pikat e fundit ku mund të gjenden disa specie të rrezikuara të shqiponjave, por me zhdukjen e bagëtisë do të zhduken edhe zogjtë që pastrojnë kafshët që vdesin çdo vit.

HABITATET UJORE DHE LIGATINAT

Pjesa më e madhe e Parkut Kombëtar ofron shërbime të rëndësishme në kuptim të grumbullimit dhe depozitimit të ujit, e në lartësi më të mëdha uji është kryesisht shumë i mirë. Disa zona karakterizohen me numër të madh të burimeve që janë të rëndësishëm në aspektin ekologjik si burim i ujit për bagëti dhe për komunitetet që jetojnë në afërsi. Ka ndotje të lokalizuar, rreth vendeve për sigurimin e ujit për bagëti, dhe rreth zhvillimeve dhe vendbanimeve.

Në afërsi të rrjedhave gjenden habitate të ndryshme ligatinore, siç janë kënetat dhe moçalet. Parku gjithashtu përbëhet nga torfa e cila përkrah ekosisteme të caktuara dhe unike. Ato gjenden tek Moçali i Hoxhës në ish zonën ushtarake të Restelicës (0.3 ha), në Fushën e Donjallukës në Radikë (13 ha) dhe në Ujin e Qetë, që ndodhet prapa Liqenit të Shutmanit në drejtim të kufirit me Maqedoninë (12 ha).

Liqenet glaciale janë një nga asetet më të rëndësishme natyrore të Parkut Kombëtar. Në lartësi prej rreth 1,900m lmd, gjenden disa liqene të cilat janë karakteristike për bukurinë dhe madhësinë e tyre, përfshirë liqenet Livadica, Jazhinca, Gornjasela, Karanikola, Miskova dhe Bezdanka. Janë të nevojshme studime të mëtejme mbi ekologjinë e këtyre liqeneve.

SHPELLAT DHE EKOSISTEMET NËNTOKËSORE

Zonat e Parkut Kombëtar që përbëhen nga guri gëlqeror përfshijnë shumë zgavra, lumenj nëntokësor, burime dhe shpella nëntokësore disa prej të cilave kanë rëndësi kulturore. Pak ka njohuri mbi ekologjinë, florën dhe faunën e këtyre sistemeve, por ka gjasa që ato të jenë të rëndësishme.

AGROEKOSISTEMET

Zonat e përziera bujqësore në fusha të vogla, pemishte, zabele e shkurre të ultësirave përkrahin komunitete të rëndësishme të bimëve dhe kafshëve numri i të cilave është në rënie në pjesën më të madhe të Evropës, si rezultat i intensifikimit të veprimtarisë bujqësore.

PËRMBLEDHJE MBI EKOSISTEMIN

Tabela 17 liston ekosistemet dhe habitatet që kërkojnë kujdes dhe mbrojtje të veçantë.

Tabela 17 Asociacionet bimore, ekosistemet dhe habitatet që kërkojnë masa të posaçme të mbrojtjes

Asociacionet e bimëve specifike/komunitetet e vegjetacioneve	Lloji më i gjeri i habitatit/ekosistemet
<ul style="list-style-type: none">• <i>Asplenio cuneifolii-Ramondaetum nathaliae</i>• <i>Bornmuellera dieckii-Seslerietum latifoliae</i>• <i>Caricio-Nartheacetum scardici</i>• <i>Cetero-Achilleo aizoonis-Ramondaetum serbicae</i>• <i>Cynancho-Saponarietum intemediae</i>• <i>Empetro hermaphroditi-Vaccinietum uliginosum</i>• <i>Junipero nanae-Bruckenthalietum spicilifoliae</i>• <i>Luzulo maxime-Pinetum heldreichii</i>• <i>Pinetum heldreichii-peucis scardicum</i>• <i>Potentillo doerfleri-Juncetum trifidi</i>• <i>Ptilotricho-Bruckenthalio-Pinetum heldreichii</i>• <i>Rhododendro-Pinetum peucis</i>• <i>Seslerio korabensis-Juncetum trifidi</i>• <i>Seslerio-Pinetum heldreichii</i>• <i>Violo grisebachiana-Saxifragetum</i>	<ul style="list-style-type: none">• Pyje që përmbajnë <i>Pinus peuce</i>, <i>Pinus heldreichii</i> (<i>ssp.leucodermis</i>) ose <i>Pinus mugho</i>.• Livadhe kodrinore apo nënkondrinore, në veçanti në substrakte të gurit gëlqeror apo silokoze (veçanërisht serpentine).• Trakte të pafragmentuara të pyjeve gjethegjatë, mikse dhe me gjethe të gjerë në kushte natyrore apo gati natyrore• Burimet dhe pjesët e sipërme të rrjedhave të ujit dhe vegjetacionit të ndërlidhur me to.• Liqenet alpine dhe vegjetacioni përcjellës.• Shpellat dhe sistemet nëntokësore.• Grykat, shkrepat dhe zonat tjera të zhveshura shkëmbore.• Pjesët e baltës së butë.

4.1.2. PEIZAZHET

Vlerësimi vijues mbi peizazhin është marrë nga Plani Hapësinor i PKSH.

‘Hapësira e Parkut Nacional përmban tërësinë cilësore dhe tejet të rëndësishme peizazhore. Në vise më të larta peizazhi karakterizohet me bukuri të theksuara, sikur që janë malet e larta, kodrat, luginat, lumenjtë, ujëvarat, shkëmbinjtë shkreporet, thellimet e akullnajave, etj. Por, gjithësi tërësi më atraktive peizazhore janë sipërfaqet e mbuluara me pyje, barë, livadhet, kullosat dhe formacionet e tjera barishtore, të cilat zënë sipërfaqet ndërmjet lartësive mbidetare mbi 999 dhe 1,500 m. Këtu formacionet e pyjeve (të ahut, arnenit, molikës, bredhit, hormoqit, etj.) ndërrohen me formacionet e barishtoreve duke u paraqitur në të gjitha nuancat e ngjyrës së gjelbër që shkaktajnë përjetim jashtëzakonisht të bukur dhe vizual të bukurisë së virgjër natyrore. Ndërsa në viset më të ulëta të parkut – regjionin e Sredskës dhe Siriniqit, bazën e peizazhit e përbëjnë kulturat e bimëve bujqësore dhe kopshtore. Në këto vise më të ulëta, gjatë verës në livadhe lulëzojnë lulet malore me ngjyra të ndryshme duke i dhënë peizazhit atraksion dhe bukuri të jashtëzakonshme e hapësirës aromë dhe freski të posaçme të natyrës së pastër.’

Elementet e peizazhit të Parkut Kombëtar që janë paraqitur në Tabelën 18 kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse.

Tabela 18 Vlerat e peizazhit

Elementi i peizazhit	Faktorët që do zvogëlonin vlerën e peizazhit
Zonat e egra të maleve të larta mbi vargun e druve.	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtimet ndërhyrëse, në veçanti ndërtimet që dominojnë apo fragmentojnë peizazhin (p.sh. shtyllat elektrike, ski-liftet apo strukturat e larta, ndërtesat, rrugët).• Shenjat e erozionit të shkaktuara nga rrugë, shtigje skijimi, etj. të vendosura/dizajnuara keq.• Shenjat e tepërta të pranisë dhe veprimtarisë njerëzore.
Peizazhet pyjore gjysmënatyrore në lartësi të mesme	<ul style="list-style-type: none">• Menaxhimi dhe eksploatimi intensiv i pyllit• Shenjat e erozionit të shkaktuara nga rrugë, shtigje skijimi, etj. të vendosura/dizajnuara keq.• Pylltaria e plantacionit.• Zjarret në pyll.
Peizazhet kulturore të ekosistemeve në kodrina.	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtesat e dizajnuara apo vendosura jo mirë.• Ndryshimet në përdorimin tradicional të tokave (p.sh. zgjerim të fushave, intensifikim bujqësor).• Braktisja e tokave.

4.1.3. FAUNA

Fauna më e rëndësishme e Parkut Kombëtar mund të klasifikohet në katër grupe kryesore.

A. GJITARËT E MËDHENJ

Falë zonave të gjera me ekosisteme të paprekura dhe me pak ndikim nga faktori njeri, Parku Kombëtar është vend ku gjenden disa specie të rrezikuara me rëndësi në nivel evropian. Në këtë grup përfshihen gjitarët e mëdhenj si ariu i murrmë, ujku, macja e egër, dhia e egër dhe çakalli i artë. Speciet të cilat përbëjnë gjah parësor të mishngrënësve më të mëdhenj janë po ashtu me rëndësi, në veçanti dreri, i cili po ashtu përbën specien e preferuar për gjah nga gjuetarët dhe gjuetarët joligjorë. Kjo vlerë shtohet për shkak të pranisë së ekosistemeve të ngjashme dhe popullatave të ndërlidhura me shtetet fqinje - Shqipërinë dhe Maqedoninë.

B. SPECIET E LISTUARA SI TË RREZIKUARA SIPAS VLERËSIMEVE NDËRKOMBËTARE

Të njëjtat janë listuar në Shtojcat e këtij dokumenti.

C. SPECIET E BRISHTA, ENDEMIKE DHE TË KUFIZUARA

Disa specie që nuk janë përfshirë në listën zyrtare të specieve të rrezikuara janë poashtu të rëndësishme. Të tilla janë:

- Speciet që mund të jenë të përhapura gjetiu në nivel global, por të cilat janë të rralla në Kosovë ose Ballkan.
- Speciet që nuk janë vlerësuar për përfshirje në listat evropiane apo të kuqe.
- Speciet populata e të cilave mund të jetë stabile, por të cilat kufizohen në hapësira të vogla dhe rrjedhimisht janë të kërcënuara nga shumë lloje rreziqesh.

D. SPECIET ME RËNDËSI KULTURORE APO EKONOMIKE

Përfshijnë parimisht bimët e egra mjekësore dhe për gatim të cilat përbëjnë një tipar të rëndësishëm ekonomik dhe kulturor të parkut. Ruajtja e popullatave të tyre është thelbësore edhe për aspektin ekologjik edhe për sigurimin e jetesës për shumë banorë lokalë.

PËRMBLEDHJE

Bazuar në këto grupe, dhe në pajtim me formë e paraqitur në analizën e UNEP (2010) dhe në Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm, speciet e kafshëve në Tabelën 19 duhet të trajtohen me prioritet për mbrojtje në Parkun Kombëtar. Zonat më të rëndësishme të Parkut Kombëtar për faunën janë paraqitur në hartën 12.

Tabela 19 Speciet e gjitarëve prioritarë në Parkun Kombëtar Sharri

Grupi	Emri shkencor	Emri në shqip	Justifikimi
Gjitarët	<i>Canis lupus</i>	Ujku	Me status të mbrojtur
	<i>Capreolus capreolus</i>	Dreri	Specie për gjah
	<i>Dinaromys bogdanovi</i>	Miu i fushës Martino	Me status të mbrojtur
	<i>Felis silvestris</i>	Macja e egër evropiane	Me status të mbrojtur
	<i>Lynx lynx martinoi</i>	Macja e egër ballkanike	Me status të mbrojtur
	<i>Lutra lutra</i>	Vidra e lumenjve	Me status të mbrojtur
	<i>Martes martes</i>	Kunadhja e pishave	I rrallë në nivel kombëtar
	<i>Meles meles</i>	Vjedulla evroaziatike	I rrallë në nivel kombëtar
	<i>Rupicapra rupicapra balcanica</i>	Dhia e egër (specie ballkanike)	Me status të mbrojtur
	<i>Ursus arctos</i>	Ariu i murrmë	Me status të mbrojtur
	<i>All bat species (Chiroptera)</i>	Lakuriqët	Me status të mbrojtur
Zvarranikët	<i>Ablepharus kitaibelli</i>	Kërmilli i dëllinjave	Me status të mbrojtur
	<i>Vipera ammodytes</i>	Gjarri bullgar	Me status të mbrojtur
	<i>Vipera ursini</i>	Gjarri i Orsinit	Me status të mbrojtur
Ujëtokësorët	<i>Bombina variegata</i>	Zhaba barkverdhë	Me status të mbrojtur
	<i>Rana graeca</i>	Bretkosa ballkanike	Me status të mbrojtur
	<i>Triturus cristatus carnifex</i>	Zhapini me kreshtë	Me status të mbrojtur
Zogjtë	<i>Alectoris graeca</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Aquila chrysaetos</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Bubo bubo</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Falco peregrinus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Gyps fulvus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Montifringilla nivalis</i>		I rrallë në nivel kombëtar
	<i>Neophron percnopterus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Picus canus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Prunella collaris</i>		I rrallë në nivel kombëtar
	<i>Pyrrhocorax graculus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Pyrrhocorax pyrrhocorax</i>		I rrallë në nivel kombëtar
Fluturat	<i>Tetrao urogallus</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Tichodroma muraria</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Maculinea arion</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Parnassius apollo</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Pyrgus andromedae</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Plebeius optilete</i>		Me status të mbrojtur
	<i>Ereba cassioides</i>		Me status të mbrojtur
<i>Ereba pronoe</i>		Me status të mbrojtur	
<i>Ereba oeme</i>		Me status të mbrojtur	

Shpallja e Malit Sharri si Zonë e Rëndësishme për Zogjtë ofron të dhëna të supozuara mbi speciet kryesore, të cilat janë paraqitur në Tabelën 20.

Tabela 20 Popullata e specieve kryesore të zogjve në Zonën e Rëndësishme për Zogjtë në Malin Sharri

Speciet	Stina	Periudha	Popullata e supozuar	Cilësia e supozimit	Kriteret e IBA	Kategoria e IUCN
<i>Alectoris graeca</i>	rezident	1996	150-250 qifte për shumim	Mesatare	B2	Gati e kërcënuar
<i>Falco peregrinus</i>	rezident	1997	4-5 qifte për shumim	E mirë	B2	Shqetësimi i fundit
<i>Aquila chrysaetos</i>	rezident	1997	5-6 qifte për shumim	E mirë	B2	Shqetësimi i fundit
<i>Crex crex</i>	Shumim	1996	10-30 qifte për shumim	Mesatare	A1,B2	Shqetësimi i fundit
<i>Bubo bubo</i>	rezident	1996	7-8 qifte për shumim	E mirë	B2	Shqetësimi i fundit
<i>Pyrrhocorax pyrrhocorax</i>	rezident	1997	25-35 qifte për shumim	E mirë	B2	Shqetësimi i fundit

<i>Pyrrhocorax graculus</i>	Rezident	1997	100-150 qifte për shumim	E mirë	A3	Shqetësimi i fundit
<i>Alauda arvensis</i>	Shumim	1996	2,000-3,000 qifte për shumim	Mesatare	B2	Shqetësimi i fundit
<i>Tichodroma muraria</i>	rezident	1997	6-10 qifte për shumim	E mirë	A3	Shqetësimi i fundit
<i>Montifringilla nivalis</i>	Rezident	1996	15-25 qifte për shumim	E mirë	A3	Shqetësimi i fundit
<i>Prunella collaris</i>	Rezident	1997	50-70 qifte për shumim	E mirë	A3	Shqetësimi i fundit

Të gjitha llojet e fuanës dhe ornitofaunës kanë mbrojtje në PKS, ndërsa në veçanti llojet e mbrojtura me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar.

4.1.4. FLORA

Shtojcat e këtij dokumenti përfshijnë një listë të plotë të specieve bimore me rëndësi të konservimit. Bazuar kryesisht në speciet endemike dhe relike, UNEP (2010) ka identifikuar pesë grupe kryesore të bimëve të pranishme në Malet e Sharrit të cilave duhet t'u kushtohet prioritet i veçantë i konservimit (Tabela 21).

Tabela 21. Grupet dhe speciet e bimëve prioritare për konservim

Orofitet steno-endemike me prejardhje terciare apo speciet relike glaciale:	Speciet relike endemike terciare:	Speciet relike nën-endemike terciare:	Speciet relike alpine terciare:	Speciet relike glaciale me shpërndarje të ngushtë arkto-alpine:
<i>Achillea alexandri-regis</i>	<i>Acer heldreichii</i>	<i>Gymnadenia</i>	<i>Linaria alpina</i>	<i>Carex foetida</i>
<i>Bornmullera dieckii</i>	<i>Anthyllis aurea</i>	<i>friwaldskyana</i>	<i>Rhododendron</i>	<i>Cryptogramma crispa</i>
<i>Crocus scardicus</i>	<i>Heracleum orphanidis</i>	<i>Pinus heldreichii</i>	<i>ferrugineum.</i>	<i>Diphasium alpinum</i>
<i>Dianthus scardicus</i>	<i>Hesperis dinarica</i>	<i>Ptilotrichum</i>		<i>Epilobium anagallidifolium</i>
<i>Draba corabensis</i>	<i>Iberis sempervirens</i>	<i>rupestre</i>		<i>Erigeron uniflorus</i>
<i>Potentilla doerfleri</i>	<i>Lilium albanicum</i>	<i>Saxifraga glabella</i>		<i>Geum reptans</i>
<i>Oxytropis korabensis</i>	<i>Narthecium scardicum</i>	<i>Shieveckia doerfleri</i>		<i>Loisleuria procumbens</i>
<i>Sedum flexuosum</i>	<i>Oreohertzogia pumila</i>	<i>eri</i>		<i>Pedicularis oederi</i>
<i>Silene schumuckeri</i>	<i>Pinus peuce</i>	<i>Silene</i>		<i>Rhodiola rosea</i>
<i>Verbascum scardicum</i>	<i>Potentilla montenegrina</i>	<i>larchefeldiana.</i>		<i>Rumex nivalis</i>
<i>Hieracleum kobilicanum</i>	<i>Ramonda serbica</i>			<i>Salix herbacea</i>
<i>Cerastium scardicum</i>	<i>Ranunculus ingrassialis</i>			<i>Salix reticulata</i>
	<i>Silene asterias</i>			<i>Saussurea alpina</i>
	<i>Silene waldsteinii</i>			<i>Saxifraga bryoides</i>
	<i>Soldanella dimonieii</i>			<i>Saxifraga androsacea</i>
	<i>Tozzia alpina</i>			<i>Selaginella selaginoides</i>
	<i>Veronica satyroides</i>			<i>Silene rupestris</i>
	<i>Viola grisebachiana.</i>			<i>Veronica alpina</i>
				<i>Veronica aphylla.</i>

Përveç llojeve në tabelën e lartëcur nr. 21, prioritet për mbrojtje dhe konservim kanë edhe llojet e mbrojtura me legjislacionin, listat dhe librat e kuqe vendore dhe ndërkombëtare.

4.2. KARAKTERISTIKAT DHE VLERAT E KOMUNITETIT DHE KULTURORE

Një vlerësim i hollësishëm i trashëgimisë kulturore është kryer për komunën e Dragashit⁶ në vitin 2012/2013. Kjo vlen për shumicën e mbetur të Parkut Kombëtar, por është me rëndësi të ceket se zona fillestare e Parkut Kombëtar përfshin një varg shumë më të gjerë të kulturave dhe traditave që kërkojnë hulumtim dhe konsideratë shtesë.

4.2.1. TRASHËGIMIA E PALUAJTSHME (LOKACIONET ARKEOLOGJIKE, MONUMENTET HISTORIKE, KARAKTERISTIKAT ARKITEKTONIKE, ETJ.)

Raporti i Whitaker (2013) identifikon dhe vlerëson karakteristikat kryesore historike të Komunës së Dragashit, por nuk saktëson cilat janë brenda apo jashtë kufirit të PKS (Tabela 22).

⁶ Whitaker, C. (2013) Studim i asetëve të trashëgimisë kulturore në Dragash. Projekti – Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokës në Dragash. UNDP, Prishtinë.

Tabela 22. Trashëgimia kryesore e paluajtshme e komunës së Dragashit

Kategoria e asetit		Lista e asetëve kryesore				Notat e rrezikut				
Gjendja	Cenushmëria	Trendi	Okupimi	Gjendja	Cenushmëria	Trendi	Okupimi	Nota e rrezikut		
1: Shkëlqyeshëm 2: Shumë mirë 3: Mirë 4: Dobët 5: Shumë dobët	1: Menaxhues mirë 2: Nuk ka rrezik 3: Disa rreziqet të lokalizuara 4: Rreziqet të qarta për tërë lokacionin 5: Rreziqet të rënda	1: Në përmirësim 2: Stabil 3 Stabil por me probleme të lokalizuara 4: Përkeqësues apo me gjasë të përkeqësimit 5: Përkeqësim i shpejtë	1: I plotë 2: Kryesisht i plotë 3: I pjesshëm 4: I fragmentuar 5: I lirë							
Kategoria: Trashëgimia arkeologjike										
Nënkategoria: Rezervat arkeologjik /Objekte të paluajtshme arkeologjike (Lokacione).		Lokacion arkeologjik në Brrut. Lokacione potenciale në Restelicë, Kërstec, Kosovë, Zaplluxhe, Brrut. Rezervat arkeologjik në Krushevë Hisarisht.		5	3	3	5	16		
Nënkategoria: Monument. Lloji: Xhami.		Xhami në Bresanë*, Mlikë*, Kapre*, Baçkë, Brod.		4	3	2	2	11		
Nënkategoria: Monument. Lloji: Objekte fetare.		Buzet Namazxhah & Kapre sallatash (dhe lokacionet përreth); varrezat dhe veçoritë natyrore përreth (p.sh. dru, spastrimet).		3	3	2	3	11		
Nënkategoria: Monument Lloji: Varreza.		Varrezat në Orçushë, Pllajnik, Pllavë (x2), Rapçë, Restelicë, Dragash.		3	3	4	4	14		
Nënkategoria: Monument. Lloji: Ndërtesa bujqësore.		Ndërtesa e mullirit (monumente): Bellobrad, Dragash (territori Shajnë). Ndërtesa e mullirit e klasifikuar sipas peizazhit kulturor në bazë të të dhënave: Bresanë, Krushevë, Kuk, Radeshë, Mlike. Tërësitë e ndërtesave bujqësore: Pllajnik, Pllavë, Zlipotok, Zym.		4	3	4	5	16		
Nënkategoria: Monument. Lloji: Infrastrukturë.		Burimi Kuklibeg; gur i gdhendur në burimin në Blaç		4	2	2	2	10		
Nënkategoria: Tërësitë e ndërtesave. Lloji: Banesor /Vendbanime/ndërtesa bujqësore.		Zonat banesore /bujqësore: Baçkë, Brod, Bresanë, Kërstec, Leshtan, Pllajnik, Pllavë, Zlipotok, Zym. Vendbanime: Territori Buçe, Orçushë, Rapçë, Vranisht, Brezne.		3	3	4	4	14		
Kategoria: Peizazhi kulturor Nënkategoria: Peizazhi i vazhduar me evoluim organik Lloji: Mulli.		Mullinj: Bresanë, Krushevë, Kuk, Radeshë, Mlikë Mullinj (po ashtu monumente): Bellobrad; Shajne (Dragash)		3	3	4	5	15		

Pjesa veriore e Parkut Kombëtar gjithashtu përfshin të paktën një lokacion të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore ortodokse, manastirin në afërsi të fshatit Mushtisht, në komunën e Suharekës, që është një zonë me mbrojtje të posaçme. Lokacionet tjera të ngjashme mund të zbulohen me anë të hulumtimeve të mëtejshme.

Përveç këtyre lokacioneve, zona e Parkut Kombëtar gjithashtu përfshin një numër të karakteristikave natyrore që kanë rëndësi kulturore dhe/ose shpirtërore. Këto përfshijnë shpellat si Shpella Matos dhe shpella 'Dhoma e Rusenicës' në Rusenicë dhe shpella 'Dëgjimi i pëshpëritjes' në Opojë. Kërkimet e mëtejme janë të nevojshme për t'i identifikuar vendet të tjera natyrore të shenjta, shpirtërore ose me vlerë kulturore. Vendasit në disa fshatra i mbrojnë disa pemë, duke përfshirë pemë të vjetra *Fagus* me degë të varura dhe një *Ulmus glabra*.

4.2.2. TRASHËGIMIA E LUAJTSHME

Trashëgimia e luajtshme përfshin objekte arkeologjike, objekte etnologjike, objektet të artit, objekte historike, materiale bibliotekare, materiale arkivore, objekte teknike, lëndën arkivore, materiale audio-vizuale, tinguj të regjistruar (fonografik) materiale arkiv. Ende nuk është realizuar asnjë vlerësim i detajuar për këtë qëllim.

4.2.3. TRASHËGIMIA E PAPERKESHME (SHPIRTËRORE)

'Trashëgimia shpirtërore (kulturore)' përkufizohet me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës si 'format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike'. Brenda territorit të Parkut Kombëtar disa nga shprehjet më të forta të trashëgimisë së veçantë kulturore janë gjetur në zonat e Opojës dhe Gorës. Etnografia e kësaj zone karakterizohet nga stilet e gjallërishme dhe origjinale të veshjes që vazhdojnë të përdoren edhe sot (për pushime, fejesa, martesat, etj.). Këto kostume janë të unike për secilën pjesë të rajonit. Identiteti shpirtëror i Opojës reflektohet edhe në traditat e ruajtura muzikore-folklorike, duke përfshirë ninullat, këngë të lindjes, këngë të dasmës, këngë të dyfishta, valle dhe lojëra të ndryshme. Raporti i Whitaker (2013 jep këtë vlerësim të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore jomateriale të zonës së Dragashit (Tabela 23).

Tabela 23. Vlerësim i rëndësisë së trashëgimisë së paprekshme kulturore të Dragashit

VLERA	DEKLARATA E PËRGJITHSHME E RËNDËSISË
Rëndësia historike dhe estetike	Traditat në Dragash janë kryesisht unike për komunitetet dhe vendosjen e peizazhit të komunës dhe rajonit më të gjerë malor që shtrihet deri në kufijtë e Maqedonisë dhe Shqipërisë. Ato kanë lindur, janë zhvilluar dhe transformuar nëpër breza të tërë si reagim ndaj faktorëve tejet të lokalizuar (si klima, gjeografia, ndikimet fetare dhe gjuhësore, sistemet e besimit, karakteristikat natyrore, migrimi, etj.), dhe ka një vazhdimësi të realizueshme sot që i jep një kuptim të vendit dhe identitetit komuniteteve lokale brenda vetes, por edhe një veçanti brenda Kosovës dhe në rajon më gjerë. Trashëgimia ëshpirtërore e paprekshme e Dragashit është unike, dhe kryesisht e ruajtur në traditë ndonëse duke kaluar nëpër disa transformime bashkëkohore. Megjithatë, është gjithashtu një formë e trashëgimisë që është në rrezik të madh të zhdukjes përmes ndikimit të ndryshimit të normave dhe pritjeve të jetës bashkëkohore.
Rëndësia sociale dhe shpirtërore	Si karakteristikë e brendshme e komuniteteve në Dragash, traditat e trashëgimisë së paprekshme ëshpirtërore kanë rëndësi të madhe sociale dhe shpirtërore, si shprehje e identitetit dhe vendit, farsnisë dhe besimeve. Këto tradita shfaqin vazhdimësi të madhe që shënon lidhje të forta me këto kultura të trashëguara. Ringjallja e veçantë e traditave të tilla gjatë muajve të verës, kur kthehet diaspora në vend është dëshmi e kësaj.
Rëndësia shkencore dhe hulumtuese	Vazhdimësia e aktiviteteve ritualeve, dhe traditave orale është resurs i vlefshëm për hulumtime të mëtejme etnografike, etnologjike, antropologjike, sociale dhe kulturore të komuniteteve në Dragash. Është i nevojshëm grumbullimi i shënimeve dhe hulumtimeve për të zhvilluar narrativa historike dhe kulturore që përcjellin, shpjegojnë dhe regjistrojnë karakteristikat e komuniteteve për vete, dhe i mundësojnë ato të kuptohen dhe të paraqiten tek një audiencë e gjerë.

Duhet të theksohet se ky vlerësim nuk përfshin zonën fillestare të Parkut Kombëtar, që mbështetë një spektër më të gjerë të kulturave. Këto vlera kërkojnë hulumtime shtesë.

4.2.4. PËRMBLEDHJE

Parku Kombëtar Sharri përfshin një spektër të gjerë të trashëgimisë kulturore të rëndësishme në aspektin e strukturave fizike, traditave, besimeve dhe njohurive. Këto janë studiuar në hollësi më të madhe në zonën e Dragashit, dhe vlerësime të mëtejshme janë të nevojshme për pjesën tjetër të Parkut Kombëtar. Ekziston një potencial i konsiderueshëm për Drejtorinë e Parkut Kombëtar për të punuar me komunitetet lokale dhe autoritetet kombëtare për ta ruajtur këtë trashëgimi të pasur dhe për të ndërtuar mbi lidhjet tradicionale midis njerëzve dhe peizazhit në mënyrë që të ruhen vlerat e Parkut. Përveç kësaj, këto vlera gjithashtu rrisin vlerën turistike të Parkut Kombëtar dhe ofrojnë mundësi për tërheqjen dhe edukimin e vizitorëve.

4.3. KARAKTERISTIKAT, VLERAT DHE MUNDËSITË TURISTIKE DHE REKREATIVE

4.3.1. FUSHËVEPRIMI I VLERËSIMIT

Ky vlerësim është përshtatur pjesërisht nga vlerësimi i hollësishëm i turizmit dhe strategjia e përgatitur për komunën e Dragashit në vitin 2012, e cila është pjesërisht relevante për tërësinë e Parkut Kombëtar⁷. Megjithatë kur konsiderohet zona e plotë e Parkut Kombëtar, duhet t'i kushtohet vëmendje kushteve specifike në zonën fillestare të parkut, që përfshin zonat e turizmit intensiv dhe përdorimin rekreative. (në veçanti për sportet dimërore dhe akomodim në pushime). Për më tepër, një vlerësim i turizmit nuk mund të bëhet pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë të zhvillimit të turizmit në Kosovë. Çdo zhvillim i turizmit në Parkun Kombëtar duhet të bëhet në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe lokale dhe me sektorin privat, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, sigurimin e infrastrukturës esenciale, menaxhimin e vizitorëve dhe marketing.

⁷ Wassel, T (2012) *Strategjia e turizmit të bazuar në natyrë për komunën e Dragashit*. Projekti – Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokës në Dragash. UNDP, Prishtinë.

4.3.2. ASETET KRYESORE TË PARKUT KOMBËTAR SHARRI NË KUPTIM TË TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE REKREATIVE

Në përgjithësi, asetet kryesore të Parkut për sa i përket rekreacionit dhe turizmit mund të përmbliken si në vijim:

- Bukuria natyrore (malet, pyjet, peizazhet e shumëllojshme natyrore dhe kulturore, biodiversiteti). Shih Kapitullin 3.1.
- Kultura dhe trashëgimia (kultura të ndryshme, mënyrat malore të jetesës). Shih Kapitullin 3.2.
- Mikpritja dhe kuzhina (ushqim vendor; mikpritja e fshatit).
- Topografia dhe klima, që siguron kushte të mira për sporte dimërore.

4.3.3. SHTYTËSIT E RITJES SË TURIZMIT DHE REKREACIONIT

Faktorët kryesorë që kanë potencial të rrisin interesimin në Parkun Kombëtar përfshijnë si në vijim:

- Sistemi rrugor është duke u avancuar dhe zgjeruar, duke mundësuar qasje më të lehtë dhe më të gjerë në zonë.
- Kjo pjesë e Ballkanit është 'kënd i pazbuluar i Evropës' që tani tërheqë turistë aventuristë ndërkombëtarë . shtetet fqinje tanimë kanë filluar ta shfrytëzojnë këtë treg. Kosova është destinacioni i ardhshëm dhe mund të tërheqë turistë kureshtarë dhe aventuristë ndërkombëtarë.
- Një pjesë gjithnjë më e madhe e popullatës së pasur të Kosovës është duke kërkuar shtëpi të dyta në Malet e Sharrit.
- Ekziston një kërkesë kombëtare dhe rajonale për turizëm malor të përbalueshëm me fokus në sportet dimërore.
- Ekziston një kërkesë në rritje vendore dhe rajonale për turizëm vikendi, i promovuar nga qasja më e mirë në Park.

4.3.4. GRUPET POTENCIALE FOKALE PËR TURIZËM DHE REKREACION TË SHTUAR

Grupet kryesore potenciale të përdoruesve për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit në Parkun Kombëtar janë si në vijim.

1. Ekskursionistët vendorë dhe turistët e interesuar të përjetojnë dhe mësojnë për natyrën, kulturën dhe jetesën e shëndetshme.
2. Diaspora kthehet gjatë muajve të verës.
3. Punonjësit ndërkombëtarë që jetojnë në Kosovë janë të interesuar në aventurë, natyrë dhe kulturë.
4. Turistët ndërkombëtarë që kërkojnë përvoja të veçanta kulturore dhe natyrore.

4.3.5. MUNDËSITË PËR REKREACION

Mundësitë kryesore për rekreacion që mund t'i ofrojë Parku janë treguar në Tabela 24.

Tabela 24. Mundësitë rekreative në Parkun Kombëtar Sharri

Mundësitë	Potenciali	Rreziqet dhe kufizimet
Hiking dhe alpinizmi dhe aktivitetet tjera të jashtme	Ekzistojnë mundësi të konsiderueshme për hiking në shkallë të ndryshme të vështirësisë dhe në distancës; disa grupe tashmë vizitojnë zonën për hiking. Drejtorja e Parkut Kombëtar ka publikuar një udhërrëfyes të shtigjeve dhe tani planifikon të krijojë një rrjet të gjerë të shtigjeve. Ky potencial është rritur me mundësinë e krijimit të shtigjeve ndërkufitare në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Potenciali ekziston edhe për aktivitete të tjera në natyrë si çiklizmi malor dhe kalërimi në pranverë dhe verë, dhe skijimi nordik edhe ecja dimërore.	Këto aktivitete ofrojnë potencial të mirë që banorët lokal të sigurojnë mbështetje të drejtpërdrejtë të jetesës përmes ofrimit të shërbimeve lokale dhe të udhërrëfyesve për hiking. Megjithatë, në periudhën afatmesme kjo me gjasë nuk do të gjenerojë të hyra të mjaftueshme. Vëllimet do të jenë të ulëta dhe tregu ndërkombëtar është mjaft konkurrues dhe i ndjeshëm ndaj problemeve të sigurisë në nivel rajonal (jo vetëm kombëtar).
Turizmi rural dhe kulturor	Kulturat tradicionale, mjetet e jetesës dhe ekonomitë e zonës sigurojnë potencial për turizëm në bazë të aktiviteteve vizituese dhe kulturore, duke përdorur hotele dhe bujtina lokale dhe akomodim. Aktivitetet specifike mund të përfshijnë vizitat e trashëgimisë dhe historike, fetare, vizita të kafshëve të egra dhe peizazhit, vizita lokale të kulturës (ushqim, veshje, festivale, etj.).	Këto mundësi duhet të shihen si një shans për t'i plotësuar të ardhurat e disa familjeve në ekonominë lokale, jo si zgjidhje për të gjitha problemet ekonomike lokale.

Vëzhgimi i specializuar i kafshëve të egra	Zona ka potencial për turizëm të grupeve të vogla me udhërrëfyes të kafshëve të egra me fokus në florën endemike dhe fluturat. Disa kompani në Evropën Perëndimore ofrojnë këtë lloj vizitash.	Udhëtimet ajror në Kosovë aktualisht është shumë e shtrenjtë, që po ashtu do të kufizojë kërkesën. Mund të ketë kërkesë për të krijuar një shërbim të koordinuar të shpëtimit malor.
Sporte të organizuara dimërore	Në kuptim të vëllimit dhe gjenerimit të të ardhurave, ky lloj turizmi ka potencialin më të madh, një fakt që është njohur nga zgjerimi i planifikuar në Bellobrad i qendrës skitare në Brezovicë dhe krijimi i zonave të tjera sportive dimërore. Zhvillimet mund të sigurojnë shumë mundësi të reja të punësimit lokal dhe të ndihmojnë në nxitjen e ekonomisë lokale dhe kombëtare. Ka mundësi të zhvillohet në Parkun Kombëtar një model për zhvillimin e qëndrueshëm skitar.	Nëse zhvillimi është i planifikuar, ekzekutuar dhe menaxhuar dobët, rezultati do të jetë dëme në vlerat natyrore të PKSH.
Shtëpitë e pushimit	Rritja e ndërtimeve të ligjshme dhe të paligjshme në Parkun Kombëtar është rezultat i rritjes së kërkesës për shtëpi pushimi në zonat atraktive nga shtresat më të pasura të shoqërisë së Kosovës. Kjo kërkesë me gjasë do të vazhdojë të rritet.	Zhvillimi pjesë-pjesë dhe kaotik ka ndikime të mëdha në peizazh dhe mjedisin e parkut
Piknikët dhe udhëtimet ditore	Zona e parkut kombëtar është tashmë i njohur nga vizitorët e fundjavës dhe ditë nga Prishtina dhe vende të tjera në Kosovë. Shumica e vizitorëve kërkojnë një vend tërheqës, të qashtë dhe me mjete themelore për piknikë joformalë dhe shëtitje të shkurtra dhe aktiviteteve familjare. Këto aktivitete kanë potencial të rrisin popullsinë e Parkut dhe të nxisin një pjesë të madhe të popullsisë të mbështetur PKSH.	Rreziqet kryesore që lidhen me këtë aktivitet janë mbipopullimi në vende të njohura dhe ndotja, sidomos me mbeturina. Përdorimet e tilla shtrajnë kërkesa të larta për personelin e Drejtorisë së Parkut Kombëtar sidomos në fundjavë dhe në festa.

4.3.6. PËRFITIMET DHE RREZIQET

Tabela 25 përmbledh përfitimet e mundshme të turizmit të rritur në Parkun Kombëtar dhe rreziqet e lidhura

Tabela 25. Përmbledhje e përfitimeve dhe rreziqeve të lidhura me turizmin në Parkun Kombëtar Sharri

Përfitimet	Rreziqet
<p>Popullata</p> <ul style="list-style-type: none"> Më shumë vende pune, në larmi sektorësh (drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi të lidhur me turizmin). Të ardhura më të larta dhe diversifikim i rrjedhave të të ardhurave Mundësi më të mëdha për trajnim dhe edukim Mbrojtje dhe ruajtje e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Infrastrukturë më e mirë. Përmirësim i cilësisë së mjedisit Përmirësim i objekteve për argëtim/aktivitete. Atraksionet mbesin në komunë (mund të ulin emigrimin/shpopullimin). 	<ul style="list-style-type: none"> Rritje e ndotjes, mbeturinave, degradimit të mjedisit dhe humbjes së trashëgimisë kulturore për shkak të vëllimit të vizitorëve, aktiviteteve të papërgjegjshme apo mbi-zhvillimit . Rritja e numrit të përdoruesve /vizitorëve kërkon më shumë planifikim, mbikëqyrje dhe fonde për mirëmbajtje dhe përmirësim të shërbimeve, pajisje dhe infrastrukturë për të përballuar kërkesën (p.sh. rrugë, ujë/ sisteme elektrike, menaxhim të mbeturinave, etj.) . Rritja e kërkesës për qasje në tokë dhe mundësi të biznesit mund të çojë në ndërtime joligjore dhe sfida për zonimin dhe rregulloret e Parkut Kombëtar. Objektivizimi apo eksploatimi i kulturës tradicionale

- Vetëdijesim më i madh i nevojës dhe praktikave të konservimit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.

Sektori shtetëror/publik

- Punësim më i madh
- Të hyrat krijohen përmes tatimit.
- Tërheqje e investimeve.
- Gjenerimi i fondeve për masa për konservim dhe mbrojtje të mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.

Sektori i kompanive /privat

- Përmirësim i mundësive për biznes dhe investime.
- Përfitime të drejtpërdrejta të lidhura me gjenerimin e punësimit dhe investime.
- Përfitime nga investimet

për përmbushjen e kërkesave turistike, duke rezultuar në humbje të autenticitetit dhe vlerave dhe kuptimit kulturor.

- 'Rrjedhja'; rrjedha e të ardhurave të gjeneruara përmes turizmit jashtë zonës (p.sh. për operatorët ose bizneset e jashtme turistike), pa përfitime për Parkun apo komunitetet lokale.
- Rreziku i eksploatimit të komuniteteve lokale .
- Destinacionet që varen vetëm nga turizmi janë në rrezik të humbjes së një bazë të madhe ekonomike në rast të fatkeqësive natyrore, recesioneve, konflikteve, etj.
- Mbipopullimi dhe kongjestioni, që ndikojnë në mjedis, banorët lokalë dhe vendbanime.
- Dyqane dhe pajisje mund të merren vetëm me kërkesat turistike në vend të nevojave të banorëve vendas. Rritja e çmimeve mund të ndikojë në banorët lokalë.

4.3.7. KAPACITETI I DREJTORISË SË PARKUT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E TURIZMIT DHE REKREACIONIT

Drejtoria e PKSH nuk ka kapacitet të veprjohë si ofrues i plotë i infrastrukturës së turizmit dhe shërbimeve në Parkun Kombëtar. Shumica e infrastrukturës dhe shërbimeve të kërkuara duhet të sigurohen nga komunat dhe komunitetet jashtë territorit të parkut dhe nga operatorët e sektorit privat të objekteve në fusha të caktuara të Zonës 3 (në veçanti qendrat skitare). Roli i Drejtorisë së Parkut Kombëtar me gjasë do të jetë planifikimi, mundësimi, rregullimi dhe kontrolli i turizmit dhe rekreacionit brenda kornizës së përcaktuar me Planin Hapësinor dhe Planin e Menaxhimit. Aktualisht, Drejtoria e Parkut Kombëtar nuk ka kapacitet për ta kryer këtë detyrë, dhe me gjasë Qeveria e Kosovës nuk do ta financojë atë drejtpërsëdrejti me resurset për t'i kryer këto detyra në mënyrë adekuate. Prandaj, çdo strategji për zhvillimin e turizmit në Parkun Kombëtar duhet të përfshijë masa për gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme për Administratën e Drejtorisë për t'i kryer funksionet e veta dhe për t'i ruajtur vlerat mjedisore dhe kulturore të Parkut.

4.3.8. PËRMBLEDHJE

PKSH ka potencial të konsiderueshëm për kënaqësi publike, turizëm joformal dhe formal dhe gjenerim të të hyrave për biznese, banorët lokalë dhe qeveritë lokale dhe qendrore. Megjithatë, zhvillimet e vazhdueshme kaotike dhe të parregulluara mund të kufizojnë përfitimet në një pakicë të vogël dhe mund të zvogëlojnë në masë të madhe vlerat që e bëjnë PKSH-në zonë atraktive për turizëm. Drejtoria e Parkut Kombëtar ka nevojë për kompetenca dhe kapacitet për të siguruar se turizmi nuk lëndon parkun dhe se është në të mirë të komuniteteve lokale.

4.4. VLERAT DHE MUNDËSITË EKONOMIKE DHE ZHVILLIMORE

4.4.1. PËRCAKTIMI I VLERËS EKONOMIKE TË PARKUT KOMBËTAR

Në vitin 2013, projekti i UNDP-së ka kontraktuar një studim të titulluar 'Kontributi Ekonomik i Ekosistemeve brenda dhe përreth Parkut Kombëtar Mali i Sharrit në Ekonominë e Kosovës'⁸. konkluzat dhe rekomandimet e këtij studimi janë përmbledhur në Tabelën 26.

⁸ Flores, M. dhe Selimi, E. (2013) *Kontributi Ekonomik i Ekosistemeve brenda dhe përreth Parkut Kombëtar të Malit të Sharrit në Ekonominë e Kosovës*. Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i përdorimit të tokës në Projektin e Dragashit. UNDP, Prishtina.

Tabela 26. Konkluzat e studimit të përcaktimit të vlerës së ekosistemit të Flores dhe Selimi (2013)

Përkundër sfidave të informatave të kufizuara në dispozicion për studimin, dëshmitë ekzistuese të gjetura për vlerën ekonomike të shërbimeve të ekosistemeve të ofruara nga Parku Kombëtar Sharri tregojnë se PKSHE siguron kontribut të konsiderueshëm për ekonominë në nivel komunal (në pesë komuna) dhe gjithashtu në nivel qendror.

Megjithatë, sikurse në vendet tjera në rajon, degradimi i resurseve sipas skenarit të Gjendjes Ekzistuese (GJE), në mënyrë tipike, ofron kthim të menjëhershëm në formë të produkteve të tregtueshme siç janë energjia elektrike, lëndë drunore, si dhe furnizim të lirë apo falas të ujit, NTFP, shërbime të biodiversitetit, mes tjerash; dhe ndikimi në shfrytëzimin e ekosistemit sipas praktikave GJE mund të mos jetë i dukshëm në periudhën afatgjatë. Megjithatë, në Kosovë, pas viteve të lënies pas dore, ndikimet negative në ekosisteme janë të dukshme në disa sektorë, si në pyje, hidroenergjia dhe bujqësi. Studimi nxjerrë përfundimin se aktualisht ka humbje të konsiderueshme si pasojë e praktikave GJE dhe se kalimi në Menaxhim të Qëndrueshëm të Ekosistemit (MQE) do të rrisin në masë të madhe përfitimet ekonomike në nivel sektorial. Për shembull:

- Turizmi i bazuar në natyrë ende është i pazhvilluar në PKSHE dhe në Kosovë. PKSHE pjesërisht mund t'i mbështesë përfitimet e mundshme ekonomike të turizmit klasik dhe turizmit të bazuar në natyrë në të ardhmen e afërme në Kosovë. Me investime adekuate, turizmi dhe turizmi i bazuar në natyrë mund të bëhen nënsektori me koeficientin më të madh të ndikimit. Por, investimet në turizmin e bazuar në natyrë për MQE janë duke ngecur; dhe nuk ka strategji për turizëm të qëndrueshëm në Kosovë.
- Lumenjtë dhe përroskat që burojnë në PKSHE dhe ekosistemet fqinje luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sektorit të bujqësisë në Kosovë.
- Shërbimet e ekosistemit të ujërave të ëmbla janë të domosdoshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm të ujit të pijshëm. Megjithatë, pa investime adekuate, mbulimi aktual i kufizuar mund të zvogëlohet edhe më shumë.
- Ujëmbledhësit e menaxhuar mirë në ZM janë pjesë e zgjidhjes për mungesat e ujit dhe për të shmangur sedimentimin e rezervuarëve që përdoren për të prodhuar energji nga burimet e ujit, dhe për të mbështetur përfitimet ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike.
- Kalimi nga GJE në MQE në menaxhimin e ekosistemeve të ujërave të ëmbla është i domosdoshëm për të siguruar rrjedhë të ujit dhe kursime (nga ikja e kostove për zëvendësim).
- Shërbimet e polenizimit janë input i domosdoshëm në bujqësi dhe mjetet rurale të jetesës.
- Ekosistemet e kullsave janë të domosdoshme për të mbështetur prodhimin e bagëtive dhe prodhimet e qumështit, por përfitimet ekonomike nga blegtoaria nuk vijnë pa dëme ekologjike, siç është rasti i erozionit dhe mbikullotjes në PKSHE.
- NTFP-të në PKSHE janë të domosdoshme për të mbështetur të ardhurat për popullatën rurale; lëndë djegëse druri dhe lëndë drunore të domosdoshme për jetesën e banorëve lokalë.
- Menaxhimi i pyjeve sipas GJE rritë rrezikun e rrëshqitjeve të dheut dhe rreziqet tjera.

Duke pasur parasysh kufizimet e studimit, menaxhimi i qëndrueshëm i ekosistemit është i domosdoshëm për të mbajtur rreth 171 milionë euro të prodhimit vjetor sektorial në nivel rajonal në pesë komunat e synuara.

4.4.2. POTENCIALI PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK

Projekti i UNDP-së ka ndihmuar në hartimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal Ekonomik për Komunën e Dragashit, konkluzat e të cilit mund të shtrihen në tërë Parkun Kombëtar. Kjo përkufizon objektivat në vijim:

- Themelimi i qeverisjes së shëndoshë të sistemit ekonomik, përmes lehtësimit të rrjeteve shumë-nivelëshe në nivel të qeverisë (tek drejtoritë komunale të ekonomisë, bujqësisë, arsimit, etj.), në nivel të shoqërisë civile (përmes asociacioneve), në nivel lokal (tek shoqëria civile dhe institucionet publike), në nivel ndërkomunal (tek komunat fqinje), në nivel vertikal (koordinimi me qeverinë qendrore).
- Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrueshmërisë së zinxhirit të vlerës me potencial të ndikimit të lartë në zhvillimin afatgjatë, siç janë bletët, qumështi, mishi, erëzat, produktet e pyllit, fruta pylli dhe kërpudha, si dhe sistemi kulturor dhe turistik.
- Krijimi i një sistemi për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për ndërmarrës, prodhues, popullatën, organizatat e shoqërisë civile, dhe institucionet publike, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë socio-ekonomik.
- Realizimi i dizajnit, zbatimit dhe financimit të projekteve prioritare infrastrukture.
- Realizimi dhe zbatimi i marketingut territorial efektiv për promovimin e imazhit territorial në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe për të tërhequr burime të jashtme që do të përdoren në mënyrë koherente me udhëzime të përbashkëta strategjike.
- Përmirësimi i kapaciteteve për planifikimin e zhvillimit ekonomik.

Megjithatë, kur të merret parasysh e tërë zona e Parkut Kombëtar, përfshirja e investitorëve dhe operatorëve madhorë të sektorit privat duhet të gëzojë konsideratë më të madhe. Për sa i përket zhvillimit dhe funksionimit të qendrave skitare, qasja duhet të shtrihet përtej ofrimit të mallrave dhe shërbimeve të bazuara në komunitet.

4.4.3. PËRMBLEDHJE

Parku Kombëtar Sharri ofron një varg shërbimesh të rëndësishme për ekonominë lokale dhe kombëtare. Këto shërbime mbështesin mijëra mjete të jetesës, por mund të kërcënohen nga praktikat e menaxhimit të paplanifikuar dhe të paqëndrueshëm. Humbja e këtyre shërbimeve do të kishte ndikim madhor në mjetet lokale të jetesës dhe ekonominë në përgjithësi, por me zhvillim dhe menaxhim të përmirësuar dhe më racional vlera e këtyre shërbimeve mund të mbahet dhe rritet në masë të madhe. Në të njëjtën kohë, shfrytëzimi i vlerave dhe shërbimeve të ofruara nga parku përmes ndërtimit dhe zhvillimit të qendrave turistike ose mund të sjellë të mira të konsiderueshme për Parkun ose mund t'i zvogëlojë vlerat e saj dhe rrisë kostot e menaxhimit duke ofruar vetëm disa përfitime të prekshme, qoftë për Drejtorinë e Parkut Kombëtar qoftë për komunitetet lokale.

5. ANALIZË E ÇËSHTJEVE DHE PROBLEMEVE

5.1. RREZIQET DHE PRESIONET

Vlerësimi i hollësishëm i rreziqeve në Administratën e PKSH ka identifikuar rreziqet dhe presionet vijuese që mund të kenë ndikim në vlerat e Parkut.

5.1.1. NDËRTIMI DHE SHNDËRRIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS

Rreziqet kryesore

Infrastruktura e turizmit

- Ndërtimi i më shumë se 500 vilave dhe shtëpive të pushimit me pak rregullim apo kontroll.
- Zhvillimi i zonave të skijimit.
- Përhapja e fshatrave në park.

Ndërtimi i rrugëve

Disa propozime/projekte madhore rrugore janë specifikuar në Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar. Ato përfshijnë rrugët për qasje në objekte brenda Parkut dhe ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Linjat e shërbimeve komunale

Shërbimet komunale (energji elektrike, etj.) janë të nevojshme për qendrat e reja skitare dhe zgjerimin e zonave të vilave. (Ka propozime në Projektplanin Hapësinor).

Mihjet dhe nxjerrja e mineraleve

- Një gurore ilegale gëlqerore është e pranishme në zonën e rreptë të mbrojtjes në Rusenicë (rezervat i rrëqebujve) dhe një gurore gjysmëligjore është në Oshlak afër Fshatit Mushnikovë.
- Dy gurore të vjetra (por tani jashtë përdorimit) kanë pasur ndikim të madh në peizazh. Minerat e pashfrytëzueshme të kromit në Zonën e Shkëmbinjve të Serpentinit në Malin Pashallara mund të riaktivizohen me rritjen globale të çmimeve të metalit.

Ndikimet

- Shkatërrimi dhe fragmentimi i habitatit
- Dëmtim i trashëgimisë kulturore
- Ndërhyrja dhe ndikime të drejtpërdrejta në faunë për shkak të humbjes së habitatit dhe vdekjeve të shtazëve në rrugë (faktorë i rëndësishëm me rrëqebullin).
- Erozioni në shpatet e pjerrëta dhe tokat/gjeologjinë e brishtë.
- Ulje e vlerave të peizazhit
- Zhvillimi çon në nevojën për shërbime infrastrukturore shitesë
- Rritje e trafikut, zhurmës dhe pluhurit
- Përshkallëzim i kërkesës për tokë.
- Ndotja.
- Humbja e habitatit, fragmentimi dhe shpyjëzimi.

Shkaqet

- Mungesa e planeve hapësinore apo urbanistike për vendbanime dhe zhvillime.
- Respektim joadekuat i ligjeve ekzistuese për zhvillimin dhe urbanizmin.
- Rregullim dhe kontroll joadekuat.
- Spekulum nga interesat individuale dhe komerciale.
- Mungesë e vlerësimit për vlerat e parkut kombëtar dhe vetëdijesimit për ndikimet
- Interesat ekonomike të zhvilluesve individualë dhe spekuluesve
- Nevoja për punësim lokal
- Kërkesa kombëtare për infrastrukturë të transportit dhe komunikimit si pjesë e zhvillimit ekonomik
- Nevoja për qasje në vila dhe zhvillime turistike
- Projektplanin hapësinor për PKSH përfshin shumë aktivitete të lidhura me ndërtimin e rrugëve

5.1.2. BAGËTIA, FERMAT BUJQËSORE, KULLOSAT, ETJ.

Rreziqet kryesore

Mbikullosa: Rezultoni nga tejkalimi i bartjes së kapaciteteve dhe çon në dëme dhe ulje të produktivitetit.

Nënkullosa: Çon në humbje të habitateve të rëndësishme që më herët mirëmbaheshin nga barngrënësit e egër.

Rreziqet dytësore: Rezultojnë nga rrugët e qasjes, kampet e kullosjes dhe mosrespektimi i zonave të mbrojtjes së rreptë. Zjarret e ndezur nga barinjët për t'i mbajtur në kontroll/shkatërruar dëllinjët.

Ndikimet	Shkaqet
<p>Mbikulllosja mund të shkaktojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Humbje të diversitetit të specieve dhe dominim të kullosave nga specie të pakëndshme. Konkurrencë ndërmjet bagëtisë dhe barngrënësve të rrallë të egër Çrregullim të faunës së egër dhe përhapje të mundshme të sëmundjeve Ndotje dhe erozion në kampe të kullosave, përgjatë shtigjeve dhe vendeve të ujitjes Rritje të konfliktit me arinjtë dhe ujqit Humbje të produktivitetit dhe kapacitetit bartës të livadheve <p>Nënkulloja mund të shkaktojë</p> <ul style="list-style-type: none"> Rikthim të habitateve të rëndësishme të livadheve në zona shkurreve dhe zona pyjore. Rritje të përdorimit të zjarreve për të rikthyer zonat kullosëse 	<p>Mbikulllosja</p> <p>Rregullim joadekuat i kullosave në kuptim të zonimit, densitetit të kafshëve, etj.</p> <p>Nënkulloja</p> <p>Ulje e realizueshmërisë ekonomike të fermave të bagëtive për shkak të qasjes së dobët në tregje, çmimeve të larta të ushqimit dimëror të kafshëve, dhe migrimit</p>

5.1.3. GJUEITIA DHE GJUEITIA ILEGALE

Rreziqet kryesore	
<ul style="list-style-type: none"> Gjuetia është e ndaluar në Parkun Sharri, por vazhdon në Dragash përmes klubeve të gjuetisë Speciet e mbrojtura në vijim gjuhen: Dhia e egër (10-15 në vit në Territorin e PK nga një popullatë prej 2-300); Arinjtë (1-2 në vit); rrëqebulli (çdo disa vite), drerët dhe derrat e egër. Zogjtë janë gjithashtu pre e gjuetisë, duke përfshirë shqiponjat për balsamim. Kryesisht përmes qitjes, në disa raste me kurthe. Nuk ka dëshmi të përdorimit të helmeve. Gjuetarët janë nga fshatrat (gjuetia për qëllime personale dhe komerciale, duke përfshirë për shitje në restorante), dhe VIP ('gjuetarë sportivë') nga qytetet (posaçërisht në Dragash). 	
Ndikimet	Shkaqet
<ul style="list-style-type: none"> Humbja e specieve të rralla dhe të rrezikuara Humbja e specieve pre e mishngrënësve të rrallë. Çrregullim Konflikt ndërmjet njerëzve lokalë dhe Drejtorisë së PK 	<ul style="list-style-type: none"> Interesa individuale ekonomike Varfëri tek banorët lokalë Kërkesa për mish të dhisë së egër në restorante Numri i pamjaftueshëm i inspektorëve Kërkesa nga gjuetarët 'sportivë' Pronësi e përhapur e armëve

5.1.4. MBLEDHJA E BIMËVE DHE PRODUKTEVE TË TJERA TË EGRA

Rreziqet kryesore	
<ul style="list-style-type: none"> Produktet më të rëndësishme janë boronicat, mjalti, kërpudhat dhe bimët mjekësore Ka dëshmi të përdorimit të metodave mekanike dhe të dëmshme për vjeljen e boronicave Ekziston edhe mbledhja intensive e një shume të caktuar të mostrave shkencore 	
Ndikimet	Shkaqet
<p>Boronicat</p> <ul style="list-style-type: none"> Dëmtim dhe rënie e produktivitetit të fushave të boronicave për shkak të vjeljes së tepërt dhe keqmenaxhimit Prishja e qetësisë së faunës së egër. Bimë të rralla endemike rrezikohen nga mbledhja ilegale e boronicave 	<ul style="list-style-type: none"> Çmimet e ulëta të paguara nga ndërmjetësit nxisin vjeljen e tepërt Mungesa e mjeteve për t'i shtuar vlerë lokale vjeljes Shpërfillja e ndikimit të praktikave të këqija të vjeljes Mungesa e rregullimit të praktikave dhe lokacioneve të vjeljes

Mjalti

- Kontaminim gjenetik i racave vendore të bletëve me racat komerciale
- Sulme të shtuara ndaj zgjojeve të bletëve nga arinjtë

Të përgjithshme

- Rrezik më i madh nga erozioni, zjarri dhe ndotja
- Ulje drastike e popullatave

5.1.5. PRERJA E DRUVE

Rreziqet kryesore

- Menaxhimi joadekuate ekonomik i zonave në menaxhim të pyjeve (Koritnik (Dragash), Kaçanik (Sharr) dhe Shterpçë).
- Prerje e përhapur ilegale e prerjes së druve për dru zjarri, posaçërisht rreth fshatrave. Janë ngritur mbi 500 padi kundër prerësve ilegalë të druve gjatë 10 viteve të fundit. Drejtoria e PK ka raportuar se ky problem është më në kontroll tani se që ishte më parë

Ndikimet

- Humbja/degradimi i ekosistemeve të rralla dhe të rëndësishme të pyjeve
- Humbja e strukturës natyrore të pyjeve dhe proceseve ekologjike.
- Ndikimet e tokës nga qasja dhe prerja: ngjeshja dhe erozioni
- Çrregullimi i faunës.

Shkaqet

- Mosmarrëveshjet mbi juridiksionin mbi resurset pyjore në PK
- Mungesë e të kuptuarit të teknikave të menaxhimit për ruajtjen natyrore dhe të lartë të pyjeve
- Kërkesa e lartë për dry zjarri
- Grupe të organizuara mirë ilegale të prerjes së druve
- Staf i pamjaftueshëm i AP për kontrollimin e prerjes ilegale

5.1.6. NDËRHYRJA DHE ÇRREGULLIMI NJERËZORE

Rreziqet kryesore

Prishja e lokalizuar e rendit përreth zonave turistike, për shembull ngasja e automjeteve jashtë rrugëve kryesore, skijimi, përdorimi intensiv i lokacioneve të njohura, sjelljet e pahijshme, vandalizmi, muzika e lartë

Ndikimet

- Shkatërrimi i ekosistemeve, habitateve dhe specieve të rëndësishme
- Shkatërrimi dhe degradimi i trashëgimisë kulturore
- Erozioni, rrëshqitjet e dheut dhe vërshimet
- Prishja e qetësisë së specieve të rralla dhe të ndjeshme inkurajimi i specieve të huaja pushtuese
- Ndikimi në peizazh dhe humbja e vlerës së kënaqësisë
- Ndryshimet në mikroklimë dhe zvogëlim i kapaciteteve të mbajtjes së ujit

Shkaqet

- Përdorimi më i madh publik i PK, posaçërisht përbrenda dhe afër fshatit turistik dhe resurseve rekreative
- Mungesa e planit të zonimit.
- Staf i pamjaftueshëm për të mbikëqyrur përdorimin rekreativ
- Vlerësim i ulët i vlerave të parkut kombëtar
- Staf i pamjaftueshëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur qasjen dhe përdorimin

5.1.7. ZJARRET

Rreziqet kryesore

- Mesatarisht 200-300 ha livadhe (shkurre) digjen secilin vit në 5-10 incidente në PKSH.
- Deri tani shumë zjarre janë mbajtur larg pyjeve, por rreziku është shumë i lartë
- Zjarre të mëdha së fundi kanë ndodhur në Koritnik dhe në një zonë të madhe afër Prevallës

Ndikimet

- Shkatërrimi i ekosistemeve të rëndësishme, habitateve dhe specieve.
- Ndryshimet në mikroklimë dhe kapacitetet e mbajtjes së ujit
- Erozioni, rrëshqitjet e tokës dhe përmbytjet.

Shkaqet

- 80% përmes pakujdesisë dhe shpërfilljes
- 20% të qëllimta si rezultat i:
 - Nënkulllosja që çon në përhapje të shkurreve në kulllosa. Zjarret përdoren për t'i pastruar ato.
 - Kërkesa për tokë për zhvillim

- Ndryshimet në përbërjen e specieve dhe inkurajimi i specieve pushtuese.
 - Ndikimi i peizazhit dhe humbja e vlerës së kënaqësisë së PK.
 - Ndotja nga tymi dhe hiri.
- Zjarrëvënia e qëllimtë.
- Ky rrezik do të rritet më zhvillimin e turizmit

5.1.8. PENDAT, MENAXHIMI HIDROLOGJIK DHE MENAXHIMI I UJIT

Reziqet kryesore

- Rritja nxjerrjes së paligjshme të ujit nga lumenjtë dhe burimet për të furnizuar zhvillimet e turizmit dhe shtëpitë e pushimit.
- Ka propozime për të krijuar liqene, rezervuare në Park (p.sh. në Brezovicë 2).
- Një fermë peshku ka devijuar rrjedhën e lumit Lubinje e Epërme.
- Ekzistojnë disa propozime për hidrocentrale, por këto janë jashtë parkut.
- Ka plane për hidrocentrale të vogla që mund të prekin rrjedhat ujore brenda parkut. (Brod dhe Restelica, shih propozimet në Zonën 3 në draft hartën e zonimit të dorëzuar nga SDA.

Ndikimet

Shkaqet

- Mungesa e të dhënave nënkupton që është vështirë të përcaktohet sasia e ndikimeve të sakta.
- Tharja e ekosistemeve dhe degradimi i habitateve dhe specieve ujore, ligatinore dhe bregore.
 - Qasje më e vogël në ujë nga shtazët e egra
 - Furnizim më i vogël me ujë për komunitetet
 - Zvogëlim i potencialit dhe kapacitetit të hidroenergjisë
- Kërkesë më e madhe për ujë
 - Mungesa e menaxhimit dhe rregulloreve të duhura të resurseve dhe menaxhimit të ujit
 - Mungesa e respektimit për vlerat dhe rregullimet e PA.

5.1.9. SPECIET DHE GJENET PUSHTUESE DHE TË TJERA PROBLEMATIKE

Reziqet kryesore

Pushtuese

Disa ferma peshqish jashtë Parkut rrisin troftë kaliforniane

Disa insekte dëmtuese pyjore janë specie të huaja pushtuese

Patogjenët. Shpërthime sporadike të sëmundjeve në specie të caktuara të pemëve

Speciet problematike. Reziqet kryesore lidhen me speciet në vijim (nuk ka resurse për të kompensuar bujqit e prekur.)

- Arinjtë. Sulmojnë zgjojet e bletëve, vlerësohet rreth 4-5 herë në vit
- Ujqit. Sulmojnë kafshët shtëpiake, 3-5 incidente në vit
- Derrat e egër. Sulmojnë të korrurat bujqësore.

Ndikimet

Shkaqet

- Troftat e ikura Kaliforni mund të eliminojnë speciet autoktone të troftës
 - Speciet problematike kanë ndikim ekonomik tek bujqit.
 - Gjuetia ilegale, kurthet apo helmimet e specieve problematike.
 - Planet për të rritur numrin e zgjojeve të bletëve dhe bagëtinë në Park do të rritnin në masë të madhe rrezikun nga arinjtë
 - Konfliktet e kafshëve të egra mund të çojnë në marrëdhënie të këqija me banorët lokalë
- Shpërfillja e ndikimeve të specieve të huaja pushtuese
 - Sëmundjet e bimëve janë fenomen natyror, por përhapja e tyre mund të rritet nga zjarret dhe presioni në sistemet pyjore
 - Përhapja e aktivitetit ekonomik në Park
 - Humbja e njohurisë tradicionale e trajtimit me speciet problematike
 - Arinjtë mund të joshen nga zonat me sasi më të madhe të mbeturinave

5.1.10. NDOTJA: KANALIZIMI DHE UJËRAT E ZEZA; PLEHRAT DHE MBETURINAT E NGURTA

Rreziqet kryesore	
<ul style="list-style-type: none"> Vilat/shtëpitë e pushimit dhe objektet turistike supozohet se kanë cisterna septike, por shumë prej tyre nuk kanë. Sasi të mëdha të ujërave të zeza dhe kanalizimit rrjedhin në tokë dhe rrjedha ujore. Ndikimi më i madh është në sezonin dimëror të skijimit Hedhja e përhapur e mbeturinave nga shtëpitë dhe hotelet (disa hotele kanë aranzhuar largimin e mbeturinave të tyre). Hedhja e përgjithshme përgjatë rrugëve dhe posaçërisht në lokacionet të njohura për piknikë dhe rekreative, disa prej të cilave janë tejet të kontaminuara. 	
Ndikimet	Shkaqet
<ul style="list-style-type: none"> Ndotje dhe rrezik i shëndetit të njeriut dhe kafshëve të egra Ndotje të tokës dhe ujit Dëmtim fizik i kafshëve të egra dhe njerëzve Tërheqje e brejtësve (p.sh. minjve) dhe sëmundjeve Humbja e tërheqjes dhe vlerës së Parkut 	<ul style="list-style-type: none"> Dëshira për t'i ulur kostot e ndërtimit/maksimizuar fitimet Mungesa e pajtueshmërisë me rregulloret e menaxhimit të mbeturinave Mungesa e monitorimit dhe zbatimit. Mungesa e respektimit të vlerave të PK-së Nuk ka sistem të përgjithshëm të grumbullimit Mungesa e përgjigjes zyrtare ndaj këtij rreziku përkundër raportimeve të vazhdueshme nga administrata e PK. Nuk ka deponi të përcaktuara të mbeturinave

5.1.11. EROZIONI DHE DEGRADIMI I TOKËS

Rreziqet kryesore	
<ul style="list-style-type: none"> Rreziqet kryesore ndodhin në toka të degraduara, shpyjzuar dhe të djegura, në spate të pjerrëta, përgjatë prerjeve të rrugëve dhe vendeve të ndërtimit në shpate dhe në lloje të brishta të tokës, posaçërisht në shpate të sipërme. Projektplani Hapësinor dhe Atlasi për zhvillim të qëndrueshëm kanë harta për potencialin e erozionit 	
Ndikimet	Shkaqet
<ul style="list-style-type: none"> Shkatërrimi i ekosistemeve në nënshtresa dhe shpate të brishta Ndikimi në vlerat e peizazhit Rrëshqitjet e tokës shkaktojnë dëme ekonomike dhe ekologjike. Ndotja e lumenjve. 	<ul style="list-style-type: none"> Cenueshmëria natyrore e llojeve të caktuara të tokës dhe tipareve gjeologjike. Shpyjzimi dhe mbikullësia. Dizajni i dobët i rrugëve dhe vendeve të ndërtimit. Zhvillimi i planifikimit nuk merr parasysh rreziqet nga erozioni.

5.1.12. NDRYSHIMI KLIMATIK DHE MOTI EKSTREM

Rreziqet kryesore	
<ul style="list-style-type: none"> Lëvizja dhe ndërrimi i habitatit; thatësitat; ekstremet e temperaturave; stuhitë dhe përmytjet 	
Ndikimet	Shkaqet
<ul style="list-style-type: none"> Zhdukja e specieve dhe ekosistemeve të lartësive të mëdha Prishja e furnizimeve me ujë Presioni në popullatat e florës dhe faunës së egër Ndikimi në mjetet e jetesës që varen në resurse Zvogëlimi në potencialin hidroenergjik 	<ul style="list-style-type: none"> Me siguri ndryshimi global klimatik Keqmenaxhimi i resurseve ujore

Rreziqet kryesore

- Disa banorë vendore mund të kenë kaluar gjatë viteve të fundit në praktika të reja, të paqëndrueshme dhe të dëmshme të përdorimit të resurseve.
- Largimi nga toka dhe praktikat që mbështesin biodiversitetin.
- Humbja e traditave vendore.

Ndikimet

Shkaqet

- | Ndikimet | Shkaqet |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Ndikim në specie, habitate dhe ekosisteme të PA. • Ndikim në qëndrueshmërinë e rrjedhës së resurseve nga PA. • Humbja e marrëdhënies mbështetëse reciproke ndërmjet natyrës dhe kulturës. | <ul style="list-style-type: none"> • Ndikimet negative të shtyra nga gjendja e dobët ekonomike. • <i>'Njerëzit shtyhen të bëjnë gjëra që nuk dëshirojnë t'i bëjnë'.</i> |

5.2. VLERËSIMI I AFTËSIVE TË MENAXHIMIT

5.2.1. ANALIZA SWOT

Në tetor 2013, Drejtoria e Parkut Kombëtar Sharri ka përgatitur një analizë SWOT për menaxhimin e Parkut Kombëtar (Tabela 27)

Tabela 27. Analiza SWOT për menaxhimin e Parkut Kombëtar Sharri

Përparësitë	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Përvoja e mirë e stafit të Drejtorisë së Parkut Kombëtar Sharri. • Prania e strukturës themelore administrative dhe menaxhuese të Drejtorisë së Parkut Kombëtar Sharri. • Objektet themelore dhe pajisjet për zyra dhe të terrenit ekzistojnë. • Kushtet e favorshme dhe atraktive natyrore për zhvillimin e turizmit. • Pozita gjeografike e favorshme e PK. • Vendbanime të pakta në territorin e PKS. • Kryesisht pronësi publike. • Qasje relativisht e mirë rrugore në PK. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e strukturës së përshtatshme organizative dhe të menaxhimit. • Mungesa e menaxhimit institucional në të gjithë territorin e PK (pjesë e komunës Shtërpce menaxhohet nga institucioni paralel i Serbisë, ndërsa në Kaçanik ajo menaxhohet nga APK dhe Njësia Komunale e Pyjeve). • Mungesa e buxhetit dhe investimeve për menaxhimin e PK. • Mungesa e kushteve adekuate për punë (pagat e ulëta, zyra është larg nga territori i PK dhe Prizren, mungesë e pajisjeve dhe mjeteve të punës, automjete etj.) • Shfrytëzim joracional i resurseve natyrore. • Mungesa e infrastrukturës ligjore, planit hapësinor dhe planit të menaxhimit. • Mungesa e infrastrukturës për zhvillim të turizmit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e vazhdueshme e kërkesave për vizita në PK. • Kërkesat për resurse natyrore (dru dhe produkte jodrunore). • Interesim i kompanive vendore dhe ndërkombëtare për investime në zhvillimin e turizmit. • Përkrahja nga institucionet ndërkombëtare qeveritare dhe OJQ-të. 	<ul style="list-style-type: none"> • Dështimi për të ngritur padi para gjykatës për veprime të paligjshme. • Gjendja e vështirë socio-ekonomike, veçanërisht në zonat rurale të PK. • Mungesa e bashkëpunimit të duhur ndërmjet institucioneve qeveritare qendrore dhe komunale. • Zhvillimi i turizmit në kundërshtim me funksionimin e mbrojtjes së vlerave natyrore të PK. • Interesat e ndryshme ndaj PK nga grupe të ndryshme. • Mospërfshirja e PK në organizatat ndërkombëtare (IUCN, Europark, etj.). • Shtetet fqinje janë më atraktive për investime për investitorët ndërkombëtarë.

5.2.2. VLERËSIMI I MJETEVE PËR PËRCJELLJEN E EFEKTIVITETIT TË MENAXHIMIT (METT)

Vlerësimi i mjeteve për përcjelljen e efektivitetit të menaxhimit (METT) është realizuar për Parkun Kombëtar në vitin 2013. Rezultatet janë paraqitur në Shtojcat e këtij dokumenti. Nota vlerësuese e efektivitetit të përgjithshëm është 36%, që është shumë e ulët dhe tregon që ka nevojë të madhe për përmirësim.

5.2.3. VLERËSIMI FINANCIAR

Vlerësimi financiar në vijim është nxjerrë nga raporti i Flores dhe Selimi (2013)

Financimi i qëndrueshëm i PKS mbetet sfidë themelore për arritjen e synimeve të konservimit në të ardhmen. Historikisht, PKS ka qenë tejet i varur në financimin e kufizuar qeveritar, dhe pa mbështetje të ndonjë fondi të mirëbesimit dhe projekteve ndërkombëtare. Sfidat kryesore në financimin e qëndrueshëm për PKS përfshijnë kapacitetet e pamjaftueshme në terren për të vlerësuar në mënyrë reale nevojat dhe zbrazëtitrat për financim, zhvillimin dhe zbatimin e planeve kosto-efektive financiare dhe strategjive të burimeve të ndryshme të prodhimit të të hyrave. Prandaj, të kuptuarit e nevojave financiare të sistemeve të zonave të mbrojtura, si dhe pengesave për financim të qëndrueshëm, është parakusht për hartimin e planeve të biznesit dhe strategjive të financimit të qëndrueshëm në nivel sistemi.

Sipas Vlerësimit të Qëndrueshmërisë Financiare (FSSC) të PKSH të aplikuar në maj 2013, buxheti aktual vjetor operativ i PKSH vlerësohet të jetë në 69.135 euro, duke përfshirë 58.135 euro nga financimi qendrorë dhe 11.000 euro shtesë nga burime të tjera, duke përfshirë përkrahjen e donatorëve ndërkombëtarë. Nevojat financiare të PKSH janë vlerësuar në 196.000 euro dhe 462.200 euro për nivelin bazik dhe optimal përkatësisht. Prandaj, zbrazëtirat e vlerësuara janë 126.864 euro dhe 392.864 euro për nivelin bazik dhe optimal të konservimit përkatësisht. Në bazë të FSSC, financimi aktual i PKSH jep rreth 35% të asaj që është e nevojshme për të arritur konservimin themelor.

5.2.4. PËRMBLEDHJE

Administrata e Parkut Kombëtar Sharri përballet me sfida të konsiderueshme në përmbushjen e kërkesave të mbrojtjes dhe menaxhimit të Parkut Kombëtar të zgjeruar dhe multifunksional, balancimin e interesave dhe nevojave të gjera, nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe sigurimit të resurseve të nevojshme për zbatim efektiv të planit të menaxhimit. Kjo do të kërkojë kapacitete të reja përtej atyre që aktualisht ekzistojnë për mbrojtje dhe monitorim. Këto do të përfshijnë ndërtimin e partneritetit (me komunitetin, autoritetet lokale dhe sektorin privat), zhvillimin ekonomik, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve, negociata dhe zgjidhje të konflikteve. Mbi të gjitha, duhet të zhvillohen mekanizma për realizimin e mbështetjes së rritur dhe afatgjate financiare për Administratën.

6. KORNIZA STRATEGJIKE (VIZIONI, SYNIMET DHE OBJEKTIVAT PËR DHJETË VITE)

6.1. VIZIONI I PËRGJITHSHËM

Plani hapësinor për Parkun Kombëtar Sharri përkufizon vizionin vijues.

Parku Kombëtar Sharri

- Park i menaxhuar me kujdes për gjeneratat e ardhshme, me llojlojshmëri biologjike, veçori peizazhore, vendbanimet përreth dhe mënyrën e jetesës tradicionale, që vlerësohen, mbrohen dhe zhvillohen.
- Park, ku përfitimet nga aktivitetet ekonomike, do të jenë në favor të mbrojtjes së mjedisit dhe të komunitetit.
- Park me qasje të mirë, që vizitorëve në çdo kohë u krijon kënaqësi dhe mundësi për aktivitete rekreative, sportive, kulturore dhe hulumtuese-shkencore.

6.2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT DHE GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

Janë identifikuar pesë programet dhe qëllimet kryesore të punës, secili me një varg objektivash specifike.

PROGRAMI 1 BIODIVERSITETI, MJEDISI DHE PEIZAZHI

QËLLIMI: TË MBAHET NJË PEIZAZHI I LIDHUR I EKOSISTEMEVE TË PACENUARA BRENDA DHE PËRTEJ PARKUT KOMBËTAR DHE PËR TË SIGURUAR KONSERVIMIN E SPECIEVE QË MBËSHTESIN KËTO EKOSISTEME

GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

SHËNIM: Mungesa e të dhënave të hollësishme bazë dhe vështirësive në monitorimin e specieve kyçe e vështirëson përkufizimin e caqeve të kuantifikuara.

1. Nuk ka zvogëlim në hapësirën apo cilësinë e ekosistemeve kritike të identifikuar në pjesën 4.1.1.
2. Popullata stabile, të qëndrueshme të specieve kyçe të identifikuar në pjesët 4.1.2 dhe 4.1.3.
3. Mbajtje e lidhjeve ndërmjet ekosistemeve brenda PKS dhe me shtetet fqinje.
4. Cilësia e ujit të mbetet brenda normave evropiane.
5. Furnizimi me ujë të mbetet adekuat për kafshët e egra, bagëtinë, komunitetet lokale.
6. Sistemi i grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave është funksional në tërë Parkun.
7. Proceset e VNS dhe VNM aplikohen për të gjitha strategjitë dhe planet zhvillimore.
8. Janë larguar të gjitha ndërtimet joligjore.
9. Rënie e incidenteve vjetore të zjarreve dhe hapësirave të djegur.
10. Nuk ka incidente madhore të erozionit apo rrëshqitje të tokës të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore.
11. Masat e aplikuar për rivegjetacion/restaurim të të gjitha tokave të degraduara.

QASJA STRATEGJIKE (POLITIKA)

MENAXHIMI I BIODIVERSITETIT

Qasjet kryesore të nevojshme për ta arritur qëllimin kërkojnë intervenime në disa shkalë:

Qasja e bazuar në zona: Instrumenti kryesor për ruajtjen e specieve dhe habitateve është sistemi i zonimit, që mban mban një përqindje të konsiderueshme të territorit të Parkut Kombëtar në zonën e mbrojtjes të rreptë, e cila do të mbetet në gjendje të papënguar, duke lejuar që proceset natyrore të vazhdojnë pa pengesa. Duke pasur parasysh resurset për të mbrojtur dhe monitoruar këto zona në mënyrë efektive, kjo do të duhej të siguronte që një pjesë e madhe e specieve dhe habitateve të Parkut Kombëtar të mbrohen në mënyrë adekuate.

Megjithatë, Zona e Mbrojtjes Të rreptë nuk është zona e vetme me rëndësi të biodiversitetit në Parkun Kombëtar; i tërë territori është i rëndësishëm dhe zonat 2 dhe 3 përfshijnë ekosisteme, habitate dhe specie ruajtja e të cilëve është thelbësore. Prandaj, nevojiten masa të veçanta për t'i mbrojtur këto asete përmes themelimit të "nënzonave" të përhershme, të përkohshme ose të ndryshueshme, nëpërmjet zbatimit të rregulloreve dhe përmes aktiviteteve të vetëdijesimit që ndikojnë në sjelljen e përdoruesve.

Qasja e shkallës së peizazhit: Vetëm qasja e bazuar në zona nuk është adekuate për të arritur qëllimin e konservimit. Disa specie të mëdha, të lëvizshme dhe shtegtare kërkojnë zona që shtrihen përtej zonave me mbrojtje të rreptë. Këto përfshijnë, në veçanti, gjitarët e mëdhenj dhe speciet që bëjnë shtegtime dhe shpërndarje sezonale. Ndryshimet në klimën lokale dhe trendet e motit gjithashtu mund të shkaktojnë lëvizje në shpërndarjet e ekosistemeve dhe në shkallën dhe lëvizjet sezonale të llojeve. Këta faktorë, me kalimin e kohës, mund të ndikojnë në vlefshmërinë e sistemit aktual të zonimit. Koordinimi i menaxhimit me zonat në vendet fqinje gjithashtu kërkon një qasje të shkallës së peizazhit për planifikim dhe menaxhim.

Qasja e bazuar në specie/habitat: Disa specie dhe habitatat e tyre mund të kërkojnë masa të veçanta për të siguruar konservimin e tyre. Këto mund të përfshijnë mbrojtjen e veçantë nga gjuetia joligjore e mishngrënësve dhe specieve tjera që janë gjah i tyre, masa të veçanta për mbrojtjen e vendeve të mbarështimit (posaçërisht të zogjve me fole në shkëmbinj) ose vendet e letargjisë (për shembull të arinjve ose lakuriqëve), ushqim shtesë për specie të caktuara, masa të veçanta të menaxhimit për 'specie problematike' dhe masa të veçanta për të shtuar ose menaxhuar popullatat e specieve shumë të rralla.

Qasja e bazuar në përdorim të qëndrueshëm: Shumë nga vlerat natyrore të Parkut Kombëtar mund të konservohen përmes përdorimit të qëndrueshëm të menaxhuar mirë, që mund të sjellë përfitime për banorët lokalë, të ofrojë mbrojtje direkte për specie, habitate dhe ekosisteme, të aplikojë forma të menaxhimit të favorshme për natyrën dhe të ndërtojë mbështetje lokale për menaxhimin e Parkut.

HULUMTIMI DHE MONITORIMI

Mungesa e informatave kufizon aftësinë për të përshkruar veprimet e hollësishme të menaxhimit për specie dhe ekosisteme të caktuara. Ka nevojë për hulumtime primare të specieve kryesore dhe për hulumtim të bazuar në menaxhim aplikativ të qasjeve adekuate të menaxhimit që do të ndërmerren. Me kalimin e kohës, mund të jetë e mundur që të prodhohen vlerësime më specifike të popullatave dhe caqe të konservimit për këto specie.

Gjendja e habitateve të specieve dhe ekosistemeve gjithashtu kërkon monitorim sistematik për identifikimin e trendeve dhe vlerësimin e efikasitetit të masave të menaxhimit që janë duke u zbatuar.

CILËSIA MJEDISORE

Mbajtja e peizazhit të cilësisë së lartë dhe mjedisit fizik është thelbësore, jo vetëm për t'i konservuar vlerat natyrore të Parkut Kombëtar, por edhe për themelimin dhe mirëmbajtjen e tij si atraksion turistik, për të siguruar mirëqenie njerëzore dhe për të siguruar vazhdimin e ofrimit të shërbimeve të ekosistemit (gjithsej vlerë prej €171.5 milionë në vit). Futja e masave për ruajtjen e mjedisit nuk mund të bëhet vetëm nga Administrata e Parkut Kombëtar. Idealisht, Parku Kombëtar duhet të jetë model për zbatim dhe respektim të plotë dhe efektiv të legjisllacionit ekzistues, sipas standardeve më të larta. Kjo do të kërkojë një kombinim të veprimeve nga stafi i administratës (posaçërisht në monitorimin e pajtueshmërisë), bashkëpunim të gjerë me autoritetet përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal dhe përpjekje të koordinuara për të ngritur vetëdijesimin për nevojën për standarde të larta të mbrojtjes mjedisore tek vendimmarrësit, hisedarët lokalë, përdoruesit dhe investitorët.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

1.1 SIGURIMI I MBROJTJES SË SPECIEVE DHE EKOSISTEMEVE KRYESORE

1.2 VLERËSIMI DHE MONITORIMI I EKOSISTEMEVE, FLORËS DHE FAUNËS PRIORITARE

1.3 TË SIGUROHET SE TË GJITHA ZHVILLIMET NË PKSH I NËNSHTROHEN KONTROLLEVE TË RREPTA MJEDISORE

1.4 TË MBROHEN DHE MIRËMBAHEN RESURSET UJORE TË PARKUT KOMBËTAR SHARRI

1.5 THEMELIMI I NJË SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE TË NGURTA NË PARKUN KOMBËTAR

1.6 FUTJA E NJË SISTEMI EFEKTIV TË PARANDALIMIT TË ZJARRIT, KONTROLLIT DHE MENAXHIMIT NË TËRË POKSH

PROGRAMI 2 KOMUNITETET, KULTURA DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM

QËLLIMI: TË MBAHEN VLERAT KULTURORE TË PARKUT KOMBËTAR SI PJESË E TRASHËGIMISË KOMBËTARE TË KOSOVËS DHE SI MUNDËSI PËR NDËRTIMIN E KRENARISË SË KOMUNITETIT DHE AVANCIMIT TË TURIZMIT DHE REKREACIONIT

GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

SHËNIM: Mungesa e të dhënave të hollësishme bazë kufizon aftësinë e përkufizimit të caqeve sasiore.

- Nuk ka përqendrim të mëtijmë të objekteve me rëndësi kulturore në Parkun Kombëtar.
- Vazhdojnë dhe ku është mundur ringjallen traditat lokale brenda dhe përreth Parkut Kombëtar.
- Kultura dhe traditat lokale ofrojnë mundësi për komunitetet lokale për të përfituar nga turizmi.
- Nuk ka konflikte ndërmjet traditave dhe kulturës lokale dhe aktiviteteve të turistëve.
- Numër më i madh i pjesëtarëve të komunitetit lokal të punësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në aktivitetet që kanë të bëjnë me Parkun Kombëtar.
- Treguesit standardë ekonomikë në komuna që përbëjnë Parkun Kombëtar përmirësohen së paku në mesatare në nivel vendi.
- Aplikohen masa për të mundësuar Drejtorinë e Parkut Kombëtar për të mobilizuar një pjesë të vlerës në shërbimet e ekosistemit të ofruara nga Parku Kombëtar.
- Aplikohen masa për të siguruar ndarjen e përfitimeve të të ardhurave nga shërbimet e ekosistemit të ofruara nga Parku Kombëtar me komunitetet që i mbrojnë ato.
- Ka marrëveshje me komunitetet lokale për kullasje dhe vjelje të produkteve natyrore nga Parku Kombëtar në zona të caktuara dhe sipas kushteve dhe rregullore të rëna dakord.
- Furnizimi i qëndrueshëm dhe i përbalueshëm i druve për zjarr sigurohet nga Parku Kombëtar për komunitetet lokale.
- Kontratat ligjore apo marrëveshjet e menaxhimit aplikohen me të gjithë përdoruesit e resurseve të Parkut, ofruesit e shërbimeve brenda parkut, si dhe bartësit e qiramarrjeve dhe koncesioneve.

QASJA STRATEGJIKE (POLITIKA)

TRASHËGIMIA KULTURORE

Qasja në menaxhimin e trashëgimisë kulturore kërkon tri qasje kryesore:

Sigurimi i mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore brenda Parkut Kombëtar. Mbrojtja e monumenteve kulturore nuk është fusha e specializuar dhe as përgjegjësia e Drejtorisë së Parkut Kombëtar. Administrata do të duhej të punonte me autoritetet përkatëse për të siguruar se këto vende kontrollohen, përcaktohen zyrtarisht nëse është e nevojshme, dhe i nënshtrohen masave tjera të duhur për mbrojtje apo restaurim.

Ndërtimi dhe avancimi i lidhjeve ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe objektivave tjera të konservimit të Parkut Kombëtar. Drejtoria e Parkut Kombëtar duhet t'i ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mësuar për traditat lokale, për të inkurajuar vazhdimin e tyre dhe për t'i identifikuar besimet dhe aktivitetet tradicionale, të cilat mund të mbështesin objektivat e konservimit të Parkut. Kjo jo vetëm që do të ndihmojë në mbajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore të Parkut, por edhe do të fuqizojë kapacitetin dhe mbështetjen për menaxhmentin. Është me rëndësi që Administrata të aplikojë një qasje neutrale dhe të njëtrajtshme ndaj të gjitha kulturave të përfaqësuara brenda dhe përreth Parkut.

Të punohet me komunitetet lokale për të ngritur kulturën dhe traditat lokale në mundësi për turizëm dhe aktivitete rekreative në mënyra që janë të pranueshme nga aspekti kulturor vendor.

Drejtoria e Parkut Kombëtar duhet të mbështesë komunitetet lokale në zhvillimin e përvojave të turizmit dhe produkteve që pasqyrojnë kulturën dhe trashëgiminë e tyre. Ato duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme turizmit kulturor dhe të sigurojnë se ai nuk përfshin aktivitete që shfrytëzojnë njerëzit lokalë apo që çojnë në ndikime apo sjellje të papranueshme.

PËRDORIMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Duke pasur parasysh se PKSHE aktualisht furnizon shërbime të ekosistemit në vlerë prej së paku 175 milionë euro në vit, janë të nevojshme masa për të siguruar se ky furnizim është i qëndrueshëm dhe që kurdoherë që është e mundur rritet. Për më tepër, është e rëndësishme që të sigurohet se një pjesë e konsiderueshme e kësaj shume është në dispozicion në para të gatshme për të mbështetur menaxhmentin e Parkut Kombëtar, për t'i ndarë me komunitetet lokale që mbrojnë parkun, si dhe për të kompensuar ata interesat e të cilëve preken negativisht nga rregulloret e Parkut.

Zona të mëdha të PKSHE janë të përshtatshme për përdorim të qëndrueshëm, kryesisht mbledhje të produkteve të egra siç janë bimët mjekësore, boronicat, kërpudhat, për prodhim të mjaltit dhe për kullotje tradicionale. Politika duhet të jetë që këto aktivitete të mundësohen, por të sigurohet se ato në radhë të parë janë në të mirë të interesave të komuniteteve lokale (jo interesave të jashtme) dhe se ky grumbullim është i qëndrueshëm dhe shkakton ndikime minimale mjedisore. Janë në zhvillim e sipër nisma të ndryshme kombëtare për të koordinuar dhe rregulluar mbledhjen e produkteve jodrunore pyjore, menaxhimin e kullotave dhe livadheve. Drejtoria e Parkut duhet të bashkëpunojë me këto nisma, duke zbatuar testime pilot në zonat e përshtatshme të parkut, duke shtuar kushte të veçanta për të siguruar se këto aktivitete janë në përputhje me objektivat tjera.

Menaxhimi i pyjeve është shqetësim i veçantë, kryesisht për shkak të varësisë së lartë lokale në dru zjarri nga komunitetet lokale. Përpjekjet për të ndaluar tërë prerjen e druve në Parkun Kombëtar do të ishin të porealizueshme dhe do të mund të shkaktonte konflikte. Drejtoria e Parkut, prandaj, duhet të aplikojë një strategji për furnizimin me dru zjarri. Kjo do të duhej të përfshinte.

- a) Sigurimin e furnizimit me dru nga Parku;
- b) Inkurajimi i masave të pyjëzimit të tokave të degraduara jashtë Parkut si vende rezerve për lëndë djegëse; dhe
- c) Promovimi i efikasitetit të lëndëve djegëse dhe alternativave të drurit të zjarrit.

Këto masa duhet të jenë në të mirë të komuniteteve lokale; shitja dytësore e druve të zjarrit dhe furnizimi te tregtarët nuk duhet të lejohet për drutë nga Parku.

Administrata Kosovare e Pyjeve tani ka hequr dorë nga e drejta e saj në vazhdim të shfrytëzimit të pyjeve në Parkun Kombëtar dhe prandaj nuk parashihet prerja komerciale e druve. Megjithatë, disa aktivitete të menaxhimit të pyjeve mund të jenë të nevojshme për të zvogëluar rreziqet nga zjarri dhe në raste ekstreme për të kontrolluar shpërthimet e brejtësve dhe sëmundjeve. Me gjasë do të jetë vazhdim të kërkesës lokale për lëndë druri teknik. Nuk është e qartë nëse Drejtoria e Parkut Kombëtar mund ta përmbushë një pjesë të kësaj kërkesë nga Parku.

Për të zhvilluar një imazh të njohur dhe promovuese për Parkun Kombëtar, duhet të krijohet një brend i veçantë për t'u përdorur në marketing për Parkun dhe që nje produktet dhe shërbimet e cilësisë së lartë të shoqëruar me Parkun Kombëtar.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

2.1 MBAJTJA E VLERAVE KULTURORE TË PARKUT KOMBËTAR SHARRI

2.2 MBAJTJA E KULLOSAVE TË RREGULLUARA NË ZONA TË CAKTUARA TË PKSHE

2.3. RREGULLIMI I GRUMBULLIMIT TË BORONICAVE DHE BIMËVE MJEKËSORE

2.4 TË SIGUROHET SE ËSHTË NË DISPOZICION FURNIZIMI I QËNDRUESHËM ME DRU ZJARRI PËR KOMUNITETET LOKALE

2.5 TË INKURAJOHEN NDËRMARRJET E QËNDRUESHME QË MBËSHTESIN PKSHE DHE JANË NË TË MIRË TË KOMUNITETIT LOKAL

QËLLIMI: TË ZHVILLOHEN MUNDËSITË QË PUBLIKU TA GËZOHË PARKUN KOMBËTAR I CILI MBAN VLERAT E TIJ NATYRALE DHE KULTURORE DHE OFRON MBËSHTETJE PËR MENAXHIMIN E TIJ

GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

- Të gjitha aktivitetet turistike dhe rekreative janë në pajtim me Qëllimin 1 dhe 2.
- Numrat nuk tejkalojnë kapacitetet e bartjes (do të përcaktohet).
- Ndikimet e turizmit nuk tejkalojnë parametrat e saktësuar (do të përcaktohet).
- Pjesë të konsiderueshme të të hyrave nga zhvillimet turistike në Zonën 3 janë vënë në dispozicion për Drejtorinë e Parkut Kombëtar për zbatim të planit të menaxhmentit për investime në zhvillimin e komunitetit lokal.

SHËNIM: Aktualisht nuk mund të përcaktohen qëllimet specifike sasiore për numrin e vizitorëve dhe krijimin e të hyrave.

QASJA STRATEGJIKE (POLITIKA)

Roli kryesor i Drejtorisë së Parkut Kombëtar do të jetë si lehtësues dhe rregullator i turizmit dhe rekreacionit në Parkun Kombëtar dhe si ofrues i informatave, edukimit dhe vetëdijesimit për vizitorët. Përveç kësaj, Drejtoria e Parkut Kombëtar duhet të luaj një rol udhëheqës në promovimin dhe reklamimin e Parkut Kombëtar si destinacion turistik.

Për të përmbushur këtë rol, Drejtoria do të funksionojë në disa mënyra:

- Përcaktimi i fushëveprimit dhe lokacionit të mundësive dhe vendeve të ndryshme rekreative në Parkun Kombëtar.
- Ofrimi i qasjes adekuate bazike dhe lehtësirave rekreative dhe infrastrukturës për vizitorët në park (p.sh. shtigje, vende për piknik, infrastrukturë bazike për vizitë, sinjalistikë bazike dhe tabela informuese).
- Koordinimi i ofrimit të mundësive për turizëm dhe infrastrukturë në Zonën 3, për të siguruar se zhvillimi dhe aktivitetet janë në shkallë të duhur dhe nuk cenojnë vlerat mjedisore dhe kulturore të Parkut Kombëtar.
- Të punuarit me ofruesit e shërbimeve për zhvilluar mundësi dhe pako për vizitorët në Parkun Kombëtar.
- Ofrimi i udhëzimeve dhe informatave për vizitorët në Parkun Kombëtar.
- Menaxhimi dhe monitorimi i vizitorëve dhe aktiviteteve të vizitorëve për të siguruar se sjellja e vizitorëve është adekuate dhe se vizitat janë të sigurta, të menaxhuara mirë, të këndshme dhe edukative.
- Sigurohet se një pjesë e të hyrave nga përfitimet turistike janë në të mirë të komuniteteve lokale që kontribuon në mbajtjen dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtar.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

3.1 THEMELIMI I INFRASTRUKTURËS THELBËSORE PËR VIZITA DHE AKTIVITETE TË JASHTME NË PKSH

3.2 ZHVILLIMI I DISA SHËRBIMEVE PËR VIZITORË DHE MUNDËSI PËR TURIZËM TË QËNDRUESHËM NË PKSH

3.3 TË SIGUROHEN PËRVOJA TË SIGURTA, TË CILËSISË SË LARTË DHE TË PËRGJEGJSHME MJEDISORE PËR VIZITORËT

3.4 TË REKLAMOHET PKSH SI DESTINACION I TURIZMIT DHE REKREACIONIT TË JASHTËM

QËLLIMI: NGRITJA E VETËDIJESIMIT, KUPTIMIT DHE MBËSHTETJES PËR TË GJITHË NIVELET PËR MBROJTJEN DHE MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË PARKUT KOMBËTAR SHARRI

GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

- Të gjitha palët lokale të interesit janë në dijeni për ekzistimin dhe qëllimin kryesor të Parkut Kombëtar.
- Të gjithë vendimmarrësit e rëndësishëm janë në dijeni të funksioneve dhe synimeve të Parkut Kombëtar dhe kufijve dhe sistemit të qeverisjes, si dhe zonave dhe rregullimeve të tij.
- Të gjitha autoritetet dhe agjencitë me veprime të planifikuara në territorin e Parkut Kombëtar koordinohen me Drejtorinë në fazë të hershme.
- Të gjithë vizitorët e Parkut Kombëtar kanë qasje në informata për vlerat e tij, mundësitë për vizitorë dhe rregullimet e parkut.

QASJA STRATEGJIKE (POLITIKA)

Mungesa e vetëdijesimit është identifikuar në përgjithësi si faktor kufizues në sigurimin e të ardhmes së qëndrueshme të Parkut Kombëtar. Ka nevojë për të shpjeguar zgjerimin e Parkut Kombëtar dhe për të nisur një program të vetëdijesimit intensiv për të shpjeguar dhe për të ngritur mbështetje për zbatimin e planit të menaxhimit, kufizimet që ai imponon për përdorimin e territorit të Parkut si dhe mundësitë që i ofron. Vizitorët në Parkun Kombëtar gjithashtu duhet të jetë të vëmendshëm për vlerat e tij, mundësitë rekreative që ai ofron, si dhe rregullimeve në fuqi.

Vetëdijesimi nuk duhet të kufizohet vetëm në komunitetet lokale dhe vizitorët. Është e rëndësishme për vlerat dhe qëllimet e Parkut të jenë të vetëdijshëm një varg i gjerë agjencish, autoritete dhe ndërmarrje që do të përfshihen në partneritetet për menaxhimin e Parkut Kombëtar.

Qasjet dhe porositë kryesore të nevojshme për ta përmirësuar vetëdijesimin dhe kapacitetin për grupe të ndryshme janë paraqitur në Tabela 28.

Tabela 28. Pasqyrë e programit për vetëdijesim dhe zhvillim të kapacitetit

Grupi përkatës	Objektivat kryesorë të zhvillimit të vetëdijesimit dhe kapacitetit	Mediumet kryesorë që me gjasë do të përdoren
Pjesëtarët e komunitetit lokal	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptuarit e vlerave aktuale dhe potenciale të Parkut Kombëtar Sharri dhe programi i menaxhimit. • Vetëdijesimi për mundësitë për të marrë pjesë në menaxhimin dhe përfitimin nga parku. • Shkathtësitë për menaxhim të bazuar në komunitet monitorim dhe për udhëzim të vizitorëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantime në takime dhe shkolla. • Tabela informuese. • Vizita në shkolla dhe në komunitet nga Drejtoria e Parkut Kombëtar. • Prezantime për grupet specialiste të përdoruesve. • Programe të trajnimeve për vullnetarë. • Shpërndarja e versionit të shkurtuar të lehtë për lexim të planit të menaxhimit. • Faqja e internetit dhe Facebook. • Mbulimi medial.
Autoritetet e menaxhimit të resurseve natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptuarit e vlerave aktuale dhe potenciale të Parkut Kombëtar dhe arsytet për caktimin e tij. • Informimi për kufizimet, rregullimet dhe mundësitë që aplikohen për Parkun Kombëtar. • Vetëdijesim për mënyrën e ndërtimit të partneriteteve me Drejtorinë e Parkut Kombëtar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantime në takime të bordit dhe eventet e lansimit të planit të menaxhimit. • Takime dhe seanca planifikimi. • Shpërndarja e planit të plotë të menaxhimit dhe versionit të shkurtuar më të lehtë për lexim.

<p>Autoritetet vendimmarrëse (Qeveritë kombëtare dhe komunale)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerat aktuale dhe potenciale të Parkut Kombëtar. • Mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm lokal, gjenerim të të hyrave dhe ndarje të përfitimeve. • Vlera e shërbimeve të ofruara nga ekosistemet e Parkut Kombëtar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantime • Evenimenti i lansimit të planit të menaxhimit. • Shpërndarja e planit të plotë të menaxhimit dhe versionit të shkurtuar më të lehtë për lexim. • Takime dhe seanca të planifikimit.
<p>Vizitorët në Parkun Kombëtar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rëndësia e Parkut Kombëtar. • Mundësitë për turizëm dhe rekreacion. • Rregulloret dhe kodet e mirësjelljes për vizitorë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tabelat informuese. • Afishe dhe fletëpalosje. • Qendrat për informimin e vizitorëve. • Mbulimi medial. • Facebook dhe faqet e internetit. • Udhërrëfyes të trajnuar.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

4.1 PËRGATITJA E MATERIALEVE TË VETËDIJESIMIT PËR PARKUN KOMBËTAR SHARRI

4.2 NGRITJA E VETËDIJESIMIT, INFORMIMIT DHE MBËSHTETJES SË KOMUNITETEVE PËR PARKUN KOMBËTAR SHARRI

4.3 RRYTJA E TË KUPTUARIT DHE MOBILIZIMI I SHKALLËS SË LARTË TË MBËSHTETJES DHE INVESTIME NË KONSERVIMIN DHE MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË PARKUT KOMBËTAR.

QËLLIMI: KRIJIMI I NJË SISTEMI EFEKTIV, Pjesëmarrës dhe të pajisur mirë të qeverisjes dhe administrimit për Parkun Kombëtar Sharri.

GJENDJA E DËSHIRUAR E VEÇORIVE TË SYNUARA

- Të gjitha pozitat në strukturën e planifikuar të stafit janë plotësuar me njerëz të kualifikuar dhe të aftësuar si duhet.
- Është në funksion një sistem operativ për bashkëmenaxhim me pjesëmarrje me palët kryesore të interesit.
- Është përlogaritur buxheti adekuat për zbatimin e planit të menaxhimit.
- Janë në funksion mekanizma për gjenerimin e financimit adekuat për menaxhimin e Parkut Kombëtar.

QASJA STRATEGJIKE (POLITIKA)

Qasje bashkëpunuese për qeverisje dhe menaxhim është e domosdoshme që Parku të funksionojë në mënyrë efektive. Stafi dhe resurset e PKSHE nuk do të jenë të mjaftueshme për të siguruar zbatim të plotë të planit të menaxhimit dhe sigurimin e mbrojtjes dhe monitorimit adekuat. Roli kryesor i Drejtorisë me gjasë do të jetë me fokus në sigurimin e infrastrukturës bazike, ofrimin e informatave, mbrojtjen, monitorim dhe menaxhimin aktiv të vlerave më të rëndësishme natyrore të Parkut (në veçanti të Zonës 1). Funksione të tjera të Parkut do të duhet të kryhen përmes një qasjeje bashkëpunuese, duke punuar me komunat lokale, agjencitë qeveritare përgjegjëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, autoritetet e planifikimit, komunitetet lokale, investitorët dhe bartësit e licencave të koncesionit. Drejtoria e PKSHE duhet të aplikojë një qasje me fokus në të ardhmen, sipërmarrëse dhe e bazuar në partneritet, dhe kjo duhet të pasqyrohet në mekanizmat dhe strukturat për planifikim dhe vendimmarrje me pjesëmarrje.

Sigurimi i resurseve adekuate për menaxhimin e PKSHE do të jetë sfidues. Financimi i drejtpërdrejtë nga qeveria e Kosovës vështirë se do të sigurojë të gjitha burimet e nevojshme. Drejtoria duhet të aplikojë një qasje sipërmarrëse për ta mbuluar buxhetin. Masat që duhet të hulumtohen për të rritur financimin e drejtpërdrejtë (p.sh. pagesë për hyrje, aplikimi i pagesës për bartësit e koncesionit dhe futjen e pagesave për shërbime të ekosistemit). Megjithatë shumë nga objektivat e planit të menaxhimit mund të plotësohen përmes ndërtimit të partneriteteve të financimit me komunat, agjencitë qeveritare dhe donatorët ndërkombëtarë. Për shembull, futja e mekanizmave për kontrollin e kullosave dhe mbledhjen e produkteve jodrunore pyjore mund të integrohet me projektet ekzistuese kombëtare. Përveç kësaj, fakti që Parkut Kombëtar ekziston bashkë me një plan të menaxhimit të miratuar mund të shërbejë për të tërhequr donatorët për projekte të reja.

Në zona të mëdha, komplekse dhe multifunksionale të mbrojtura si Parku Kombëtar Sharri, kushtet sociale, ekonomike, mjedisore dhe politike me gjasë do të ndryshohen në periudhën afatshkurtër deri në atë afatmesme. Prandaj, qasja në menaxhim duhet të jetë dinamike dhe e përshtatur dhe Drejtoria e PKSHE duhet të jetë e informuar me të gjitha trendet dhe ndryshimet për të qenë në gjendje të mbajë funksionet e Parkut Kombëtar dhe të sigurojë se përfaqësohen interesat e saj.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

5.1 APLIKIMI I MENAXHIMIT BASHKËPUNUES PËR PKSHE

5.2 ARRITJA E STAFIT TË PËRHERSHËM PROFESIONAL DHE TË TRAJNUAR, TË MBËSHTETUR NGA PARTNERË DHE VULLNETARË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT

5.3 SIGURIMI I RESURSEVE FIZIKE TË NEVOJSHME PËR ZBATIM PËR MENAXHIMIN E ZONAVE TË MBROJTURA DHE ZBATIMIN E PLANIT MENAXHUES


5.4 KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR FINANCIMIN DHE MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TRANSPARENT FINANCIAR PËR ZBATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT. (SHIH EDHE PLANIN E BIZNESIT TË PKSHE)

5.5 SIGURIMI I ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE PËRSHTATJES SË PLANIT TË MENAXHIMIT

7. ZONIMI (ZONAT, PËRSHKRIMI DHE KUFIZIMET E PËRDORIMIT TË PRANUESHËM)

Plani hapësinor siguron funksione dhe rregullime të përgjithshme për zonat menaxhuese të Parkut Kombëtar, dhe thekson se këto do të shtjellohen më në hollësi në Planin e Menaxhimit. Rregullimet specifike në vijim do të aplikohen në zonat e Parkut (Harta 2).

Harta 2 Zonat funksionale të Parkut Kombëtar Sharri



7.1. ZONAT E MBROJTJES STRIKTE (ZONA MBROJTËSE E NIVELIT TË PARË)

PËRKUFIZIMI SIPAS PLANIT HAPËSINOR

Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar Sharri me karakteristika të jashtëzakonshme natyrore, me specie të rralla, bimë dhe kafshë të rrezikuara dhe llojet të habitateve në kushte të egra të natyrës.

REGULLIMET E POSAÇME

1. Kufiri i zonës do të shënohet me shënjes të përshtatshëm në intervale të rregullta e të dukshme në terren.
2. Të gjitha format e gjuetisë dhe peshkimit, vënies së kurtheve dhe ndjekjes së kafshëve janë të ndaluara.
3. Kullotja, mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike, kërpudhave, organizmave të për ushqim, janë rreptësisht të ndaluara.
4. Ndalohen të gjitha format e shfrytëzimit të pyjeve, apo ndërhyrjet tjera që pengojnë proceset natyrore të ekosistemeve
5. Futja e specieve apo varieteteve aloktone është e ndaluar.
6. Ndalohet çdo qasje në zonën e ndaluar me përjashtimet në vijim: a. Stafi dhe pylltarët e Drejtorisë së Parkut Kombëtar Sharri që kryejnë mbrojtje thelbësore, monitorim dhe aktivitete të menaxhimit ; b) Huluntuesit e autorizuar, c) Grupet e vogla të shoqëruara prej jo më shumë se 12 vizitorëve të specializuar (Alpinistë, roje të kafshëve të egra) që bëjnë vizitë në shtigje dhe zona të parapërcaktuara.

7. Qasje e motorizuar është e ndaluar dhe e kufizuar për vizita esenciale për qëllime të mbrojtjes, menaxhimit dhe monitorimit.
8. Të gjitha format e ndërtimit janë të ndaluara.
9. Aktivitetet e hulumtimit dhe monitorimit shkencor që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe mbrojtjen e zonës i nënshtrohen lejeve të nevojshme të cilat duhet të lëshohen nga Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit. Për mbledhjen e mostrave të florës, kërpudhave dhe faunës së egër ekskluzivisht për qëllime shkencore duhet të nxirret leje e veçantë dhe specifike paraprakisht.

7.2. ZONA E MENAXHIMIT AKTIV

PËRKUFIZIMI SIPAS PLANIT HAPËSINOR

Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar Sharri që karakterizohen nga ekosistemet, vlera të peizazhit dhe vlera të tjera ku mund të ushtrohet ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe aktivitete që nuk janë në mospërputhje me qëllimet e mbrojtjes.

RREGULLIMET SPECIALE

1. Kufijtë e zonës së menaxhimit aktiv duhet të shënjohen në të gjitha pikat potenciale të qasjes së publikut.
2. Drejtoria e Parkut Kombëtar mund të caktojë nënzona brenda kësaj zone për të siguruar mbrojtje adekuatë të karakteristikave të një rëndësie të veçantë. Këto nënzona mund të jenë të përhershme, të përkohshme apo sezonale. Shembujt përfshijnë zona të mbyllura për të lejuar rimëkëmbjen e vegjetacionit nga dëmet e shkaktuara nga kullosjet apo aktivitetet rekreative, zonat mbrojtjes sezonale përreth lokacioneve të foleve të zogjve të rrallë, zonat e vegjetacionit veçanërisht të brishtë, që nuk mund të përballojë shkeljen apo kullotjen, zonat që i nënshtrohen programeve të monitorimit dhe hulumtuese, zonat me rrezik të lartë të zjarrit. Informatat rreth nënzonave duhet të shënjohet në tabelat informuese dhe në tokë dhe duhet t'i komunikohen rritësve të bagëtive dhe korrësve.
3. Qasja e përgjithshme në zonë është e ndaluar përveç si në vijim:
 - a. Stafi i autorizuar nga Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit për qëllime të aktiviteteve të hulumtimit, monitorimit, menaxhimit dhe mbrojtjes. Për grumbullimin e mostrave nevojitet leje specifike paraprake.
 - b. Stafi që kryen detyra zyrtare në emër të agjencive dhe organizatave me mandate që prekin territorin e Parkut. Për këto vizita në Parkun Kombëtar nevojitet njoftim paraprak.
 - c. Vizitorët që kryejnë aktivitete rekreative siç janë alpinizmi, trekingu, vëzhgimi i kafshëve të egra. Qasja nga vizitorët rekreativë lejohet sipas kushteve në vijim.
 - i. Vizitorëve u ndalohet që të shënjohin shtigjet zyrtare, lokacionet dhe vendet e shënuara rekreative në këtë zonë.
 - ii. Vizitorët në nënzona të caktuara tejet të ndjeshme duhet të shoqërohen nga një udhëzues i autorizuar nga Drejtoria e PKSH.
 - iii. Të gjitha qasjet rekreative do të jenë të pamotorizuara (përveç nga qasja në rrugët zyrtare publike).
 - iv. Kampingu dhe qëndrimet që kalojnë natën në zonë janë të ndaluara.
 - v. Ndezja e zjarreve në zonë është e ndaluar.
 - vi. Të gjitha mbeturinat dhe plehrat duhet të largohen.
 - d. Barinj të autorizuar me kafshët e tyre në zonat e caktuara në periudha të caktuara.
 - e. Vjelësit e autorizuar të produkteve të egra në zonat e caktuara në periudha të caktuara.
 - f. Banorët lokalë që merren me veprimtari zakonore.
4. Të gjithë shfrytëzuesit e zonës duhet të jenë të vetëdijshëm për rregullat që prekin ata (me anë të fletëpalosjeve, tabelave informuese dhe informacioneve të ofruara nga udhërrëfyesit)
5. Aktivitetet në vijim nuk janë të lejuara në këtë zonë:
 - a. Ndërtimet, rrugët, shtigjet dhe modifikimet fizike të peizazhit përveç infrastrukturës bazike të nevojshme për qasje dhe siguri të vizitorëve, pajisje për shuarje të zjarreve dhe për nevoja të përdorimit të resurseve, duke përdorur kurdoherë të jetë e mundur materiale natyrore dhe me efekt minimal në ekosisteme dhe peizazhe.
 - b. Aktivitetet komerciale me pakicë (p.sh. shitja e ushqimit, pijeve freskuese, suvenireve, etj.). Këto shitje lejohen vetëm në zonën e përdorimit të qëndrueshëm.
 - c. Punimi i tokave të bujqësore dhe plantacioneve (përveç në toka private).
 - d. Futja e specieve apo varieteteve aloktone.
 - e. Mihjet dhe nxjerrja e mineraleve.

6. Aktivitetet e menaxhimit të pyjeve duhet të respektojnë udhëzimet në vijim
 - a. Sa më shumë të jetë e mundur, pyjet duhet t'i mbesin në procese natyrore, duke lejuar zhvillimin e pyjeve natyrale, të përziera me moshë të përzier
 - b. Prerjet komerciale nuk lejohen. Prerjet e kufizuara të druve të zjarrit lejohen, me kusht që është marrë aprovimi i planeve të menaxhimit të pyjeve nga Drejtoria e Parkut Kombëtar.
 - c. Operacionet higjienike të pyjeve (që i nënshtrohen Ligjit) duhet të kufizohen në metodat jokimike (menaxhim fizik, përdorim i kontrollit biologjik, kurthe feromone, etj).
 - d. Duhet të hartohen rregulla të veçanta për pyjet në toka private.
7. Nuk lejohet asnjë modifikim i shpellave (zgjerimi i hyrjeve, krijimi i hyrjeve të reja, krijimi i tuneleve të reja, zgjerimi i tuneleve ekzistuese).
8. Të gjitha format e gjuetisë janë të ndaluara, me përjashtim të masave të sanksionuara zyrtarisht për të kontrolluar speciet problematike apo pushtuese.
9. Aktivitetet e blegtorisë i nënshtrohen rregullave në vijim.
 - a. Kapacitetet e kullsave duhet të përcaktohen, për të shmangur rrezikun e kullotjes së tepërt dhe erozionit.
 - b. Kullotjet duhet t'i nënshtrohen marrëveshjeve kontraktuese që përcaktojnë zonat, periudhat e kullotjes, numrin e kafshëve dhe qenve, zonat e grumbullimit të deleve dhe kampet e barinjve, furnizimi me ujë dhe mjetet për largimin e mbeturinave.
 - c. Blegtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se ata nuk janë të lejuar të gjuajnë kafshë mishngrënëse dhe se është përgjegjësia e tyre që të përdorin mënyra tradicionale, të padëmshme, për t'i mbrojtur kafshët e tyre (p.sh. qentë roje, ruajtjen e deleve, grumbullimin e deleve).
 - d. Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit ka të drejtë të pezullojë kullotjet në rast të mosrespektimit të kontratave dhe në raste të ngjarjeve të paparashikuara, si shpërthimet e sëmundjeve, që mund të përhapen tek kafshët e egra, ose kushtet ekstreme klimatike, si thatësitrat që mund të çojnë në mbikullotje dhe erozion.
10. Aktiviteti i grumbullimit të produkteve jodrunore pyjore i nënshtrohet rregullimeve në vijim
 - a. Duhet të përcaktohen kufizimet për grumbullim, që të shmangët rreziku i vjeljes së tepërt dhe erozionit.
 - b. E tërë vjelja duhet t'i nënshtrohet marrëveshjeve kontraktuese që përcaktojnë speciet që mund të vilen, zonat, periudhat e grumbullimit, limitet dhe mjetet për largimin e mbeturinave.
 - c. Grumbulluesit duhet të jenë të vetëdijshëm se atyre nuk u lejohet që të prishin qetësinë apo të gjuajnë kafshët e egra.
 - d. Drejtoria e Parkut Kombëtar Sharri ka të drejtë të pezullojë grumbullimin në rast të mosrespektimit të kontratave dhe rasteve të paparashikuara siç janë sëmundjet apo kushtet ekstreme klimatike.
11. Të gjitha aktivitetet e pashmangshme të zhvillimit dhe ndërtimit në interes kombëtar (p.sh. ndërtimi i rrugëve dhe instalimi i linjave të shërbimeve siç janë kabllot dhe linjat e energjisë) duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe masave për zbutje që janë në pajtim me vlerat dhe objektivat e Parkut Kombëtar.

7.3. ZONA E PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM

PËRKUFIZIMI SIPAS PLANIT HAPËSINOR

Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar të Sharri të caktuar për: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreative, turizëm dhe nevojat e banorëve në territorin e Parkut Kombëtar, si dhe përdorim për kullosa dhe përdorim ekonomik të resurseve natyrore në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe në pajtim me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri përdorimi i kufizuar dhe selektiv i resurseve natyrore.

RREGULLIMET E POSAÇME

1. Në këtë zonë dhe jashtë të gjitha nënzonave për zhvillim special (shih nenin 2 më poshtë), do të vlejnjë të gjitha rregullimet e Zonës 2.
2. Drejtoria e Parkut Kombëtar do të përcaktojë nënzonat për zhvillim të posaçëm brenda kësaj zone për qëllimet e mëposhtme
 - a. Ndërtimin e strukturave komerciale, të banimit dhe turistike.
 - b. Zonat për përdorim intensiv rekreativ, në veçanti për sporte dimërore.
 - c. Ndërtimi i infrastrukturës themelore publike.
3. Të gjitha nënzonat për zhvillim të special do t'i nënshtrohen planeve të urbanizimit që përcaktojnë shtrirjen, dizajnin, masat e mbrojtjes mjedisore dhe rregullimet tjera që zbatohen për zhvillimin.
4. Të gjitha zhvillimet i nënshtrohen vlerësimeve të ndikimit në mjedis që përfshijnë masat zbutëse në përputhje me vlerat dhe objektivat e Parkut Kombëtar.
5. Koncesionet territoriale brenda zonës do të jetë subjekt i marrëveshjeve ligjore që përcaktojnë kufijtë dhe kërkesat e ndërtimit, përdorimit, aktivitetet dhe kushtet mjedisore.

7.4. ZONA BUFER

PËRKUFIZIMI SIPAS PLANIT HAPËSINOR

Një zonë prej pesëdhjetë (50) metrash nga kufiri i Parkut Kombëtar Sharri që shërben për të parandaluar ndikimet negative në Parkun Kombëtar.

RREGULLIMET E POSAÇME

Funksioni i zonës buferike është që të zvogëlohen ndikimet negative në ekosistemet natyrore në Parkun Kombëtar dhe të krijohet një zonë ku komunitetet lokale mund të bashkëveprojnë dhe të përfitojnë nga Parku Kombëtar. Drejtoria e Parkut Kombëtar nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë të menaxhimit mbi këtë zonë dhe për këtë arsye nuk mund të aplikojë rregulla për të; ajo duhet të punojë me komunat lokale dhe agjencitë e tjera për të përmbushur kushtet e mëposhtme në zonën buferike.

1. Të gjitha format e përdorimit dhe menaxhimi të tokës dhe burimeve duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit dhe nevojave të Parkut Kombëtar Sharri.
2. Gjuetia komerciale, peshkimi, pylltaria dhe bujqësia në zonën buferike duhet të harmonizohet me planet, qëllimet e konservimit dhe zonat e Parkut Kombëtar. Në veçanti, aktivitetet e dëmshme ose të rrezikshme nuk duhet të bëhet drejtpërsëdrejti në kufirin e Parkut Kombëtar, veçanërisht në zonat pranë për Zonës së mbrojtjes së rreptë.
3. Përgatitja dhe miratimi i planeve të menaxhimit të resurseve, zhvillimit dhe urbanizimit në zonën buferike (p.sh. planet e urbanizimit, planet për zonat e pabanuara, menaxhimi i pyjeve, menaxhimi i ujit, projektet e energjisë, nxjerrja e mineraleve, ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i infrastrukturës tjetër) duhet të mundësojë pjesëmarrjen aktive të administratës së Parkut Kombëtar. Të gjitha planet e tilla duhet t'i nënshtrohen i Procesit VNM dhe masave zbutëse.
4. Është e dëshirueshme që objektet e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve (p.sh. hotele, vendpushime, etj.) për Parkun Kombëtar të planifikohen të ndërtohen në zonën buferike .
5. Drejtoria e Parkut Kombëtar duhet të punojë me komunitetet lokale dhe qeverinë për të krijuar një varg mundësish për turizëm dhe shërbime turistike në zonën buferike. Për shembull, renovimi i objekteve dhe shtëpive për akomodim, shitja e mallrave dhe shërbimeve, vizitat në monumente kulturore dhe vende historike, aktivitetet edukative dhe të vetëdijesimit.

Faqet në vijim përmbajnë plane të hollësishme për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të përkufizuara.

Prioritetet vijuese janë përdorur në tabela.

Prioriteti 1: Aktivitetet thelbësore që duhet të ndërmerren gjatë periudhës së aplikimit të planit. Përdoret për veprimet që janë thelbësore nëse do të përmbushen funksionet dhe obligimet kryesore të AP.

Prioriteti 2: Aktivitete të rëndësishme që do të duhej të realizoheshin dhe për të cilat duhet të kërkohen në mënyrë specifike resurset. Nëse këto aktivitete nuk realizohen, duhet të ketë arsye të mirë për këtë.

Prioriteti 3: Aktivitetet e dëshirueshme që mund të ndërmerren nëse lejon koha dhe ka resurse. Nuk duhet të largohen resurse nga prioritetit 1 apo 2 për t'i realizuar këto veprime.

Qëllimi: të mbahet një peizazhi i lidhur i ekosistemeve të pacenuara brenda dhe përtej parkut kombëtar dhe për të siguruar konservimin e specieve që mbështesin këto ekosisteme

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1 SIGURIMI I MBROJTJES SË SPECIEVE DHE EKOSISTEMEVE KRYESORE

Veprimet	Treguesi i matshëm i përbushjes	Prioriteti	V1	V2	V3	V4	V5	Përgjegjësia kryesore për zbatim
1.1.1 Demarkacioni i kufijve të jashtëm të Zonës 1 në të gjitha pikat e qasjes (rrugë, pista, shtigje, etj.).	Deri në 100 shënjes janë vendosur në terren.	1	X	X				Drejtorja e PKSH.
1.1.2. Përcaktimi i një programi të patrullimeve dhe kontrolleve të rregullta të Zonës dhe zonave të ndjeshme të Zonave 2 dhe 3.	Së paku patrullime mujore për t'i kontrolluar të gjitha lokacionet kryesore.	1	X	X	X	X	X	Drejtorja e PKSH.
1.1.3. Identifikimi dhe demarkacioni i nënzonave të veçanta të konservimit (të përhershme apo sezonale gjatë periudhave të mbarështimit) në Zonat 2 dhe 3 ku zhvillimet dhe prishjet e qetësisë do të mbahen në minimum.	Nënzonat janë identifikuar dhe vënë në hartë.	2		X	X			Drejtorja e PKSH, Institutet e Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të.
1.1.4 Zhvillimi i planeve të veprimit për speciet kryesore dhe të rrezikuara të florës dhe fanës të Parkut	Një plan i veprimit në vit.	2			X	X	X	Drejtorja e PKSH, Institutet e Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të.
1.1.5 Të punohet me komunitetin lokal (barinjtë, grumbulluesit e produkteve jodrunore pyjore, pronarët e pyjeve e tokave bujqësore, bletarët, etj.) për t'i identifikuar speciet problematike dhe lokacionet dhe për të zhvilluar masa të migrimit.	2 X punëtori njëditore X 15 njerëz. Raport	2			X	X		Drejtorja e PKSH, komunitetet lokale.
1.1.6 Themelimi i një komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga kafshët e egra në pronat e popullatës lokale dhe kompensimin e dëmeve.	Komisioni është themeluar. Është gati Udhëzimi Administrativ për kompensimin e dëmeve.	3					X	Drejtorja e PKSH, bujqit, komunitat.
1.1.7 Zhvillimi i Programit për mbrojtjen e ekosistemeve pyjore dhe Planit Vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve.	Së paku 3 plane të veprimit në vit	1	X	X	X	X	X	Drejtorja e PKSH

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2 VLERËSIMI DHE MONITORIMI I EKOSISTEMEVE, FLORËS DHE FAUNËS PRIORITARE

Veprimet	Treguesi i matshëm i përmbushjes	Prioriteti	V1	V2	V3	V4	V5	Përgjegjësia kryesore për zbatim
1.2.2 Themelimi dhe kontrollimi vjetor i parcelave të përhershme monitoruese dhe lokacioneve të fotografimit në pika fikse në të gjithë ekosistemet kryesore.	20 lokacione të fotografimit në pika fikse. 20 parcela të shënuara të monitorimit.	1		X	X	X	X	Drejtorja e PKSH, Instituti i Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të.
1.2.1. Krijimi i një sistemi të informatave të biodiversitetit për Parkun.	Sistemi themelor GIS dhe bazat e të dhënave janë krijuar në Selinë e Parkut.	2	X	X				Drejtorja e PKSH.
1.2.3 Kryerja e studimeve dhe anketave të habitateve dhe ekosistemeve prioritare.	Një studim në vit.	2		X	X	X	X	Drejtorja e PKSH, Instituti i Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të
1.2.4 Kryerja e studimeve dhe anketave të specieve prioritare të shtazëve.	Një studim në vit	2		X	X	X	X	Drejtorja e PKSH, Instituti i Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të.
1.2.5 Krijimi i një programi për monitorimin e gjendjes së kullosave, grumbullimit të produkteve jodrunore pyjore dhe zonave të prerjes së druve për zjarr.	Monitorim vjetor me vizita në kullosa dhe zona të grumbullimit. Krijimi i parcelave të përhershme të monitorimit. Raport vjetor.	2			X	X	X	Drejtorja e PKSH, Instituti i Mbrojtjes së Natyrës, Universitetet, OJQ-të.
1.2.6 Krijimi i një programi për monitorimin e ndikimit ekologjik të shtigjeve turistike për hiking dhe zonave për kamping.	Monitorim vjetor me vizita në zonat me përdorim të rënduar. Raport vjetor.	2			X	X	X	Drejtorja e PKSH, Instituti i Mbrojtjes së Natyrës Universitetet, OJQ-të.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3 TË SIGUROHET SE TË GJITHA ZHVILLIMET NË PKSH I NËNSHTROHEN KONTROLLEVE TË RREPTA MJEDISORE.

Veprimet	Treguesi i përmbushjes	Prioriteti	V1	V2	V3	V4	V5	Përgjegjësia kryesore për zbatim
1.3.1 Monitorimi dhe rregullimi i ndërtimeve dhe zhvillimeve në Parkun Kombëtar në pajtim me Rregullimet e PKSH, Planin Hapësinor të PKSH, Planet Rregullative për zonat e treta dhe kërkesat për VNM.	Programi i rregullt i inspektimeve dhe veprimeve	1	X	X	X	X	X	Drejtorja e PKSH, komunat përgjegjëse, Inspektorati i MMPH.
